

Gusht... e dasmë,
komunat
shqiptare i lënë
pas të tjerat

Fq.4



PUNA
SEZONALE
Mundësi
për mbijetesë

Fq.5



Juventusi
mbyll
nënshk-
rimin me
Emre Xhan

Fq.21



Koha

www.koha.mk



20 vjet me
Avokatin e
Popullit

Fq.12-13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3368 · E premte, 18 maj 2018

11°C | 24°C

15 DEN

EDITORIAL

Gaza dhe
ndërgjegjja
e ngatërruar
e mediave



Shtatëdhjetë vite më parë, George Orwell kishte shkruar që gjuha moderne politike "është e dizajnuar që gënjeshtret të tingëllojnë si të vërteta dhe vrasja të respektohet". Pamjet që u transmetuan ditën e hënë nga Gaza, ku të paktën 60 protestues palestinezë u vranë nga trupat izraelite në shenjë mospajtimi me dislokimin e...

Fq.2

FEJTON

U masakruan
150 burra!

Fq.17

GLOBI

Irani përplas
SHBA-të me
Europën

Fq.15

RAJON

BE nuk ka
nxitim për
zgjerim

Fq.14



OFROHEN QËNDRIMET, NDËRHYN MERKELI DHE MAKRONI

GJENDET OPSIONI I MUNDSHËM PËR EMRIN



Kryeministri Zaev theksoi se me Ciprasin kanë biseduar në mënyrë thelbësore për disa opsione, me ç'rast kanë vërtetuar një opsion, e cila mund të jetë e pranueshme për dy palët. Ai nuk precizoi për çfarë zgjidhje bëhet fjalë, as nuk u përgjigj drejtpërdrejtë nëse në takim është bërë fjalë për ndryshim të Kushtetutës së Maqedonisë

Fq.3

Kompanitë shqiptare, skeptike

Shkup, 17 maj - Në kuadër të planit për rritje ekonomike dhe investime, nga dita e mërkurë (16 maj) për të gjitha kompanitë makro, të mesme dhe të vogla në Maqedoni ka filluar aplikimi për marrjen e mjeteve financiare për investime. Siç bëri të ditur edhe zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev, të gjitha kompanitë vendore makro, të mesme dhe të vogla që do të aplikojnë për mbështetje

financiare nga Qeveria, të hollat do t'i kenë në llogarinë e tyre bankare brenda 60 ditëve. "Ligji ka hyrë në fuqi nga 16 maji dhe të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të aplikojnë për marrjen e mbështetjes financiare. Ekonomia e Maqedonisë duhet patjetër të orientohet nga eksporti dhe të jetë sa ma konkurrense në tregjet e treta. Prandaj dhe ideja e Qeverisë aktuale..."

Fq.7



EDITORIAL

GAZA DHE
NDËRGJEGJJA
E NGATËRRUAR
E MEDIAVE

Emin AZEMI

Shtatëdhjetë vite më parë, George Orwell kishte shkruar që gjuha moderne politike "është e dizajnuar që gënjeshtër të tingëllojnë si të vërteta dhe vrasja të respektohet". Pamjet që u transmetuan ditën e hënë nga Gaza, ku të paktën 60 protestues palestinezë u vranë nga trupat izraelite në shenjë mospajtimi me dislokimin e ambasadës amerikane nga Tel Avivi në Jerusalem, la gojëhapur shumë analistë të mediave për mënyrën e raportimit dhe plasimin e lajmeve e kronikave në gazeta dhe televizion. Palestinezët gjithmonë janë fajësuar në mënyrë sistematike edhe atëherë kur janë vrarë nga izraelitët. Por vrasja ka ndodhur edhe atëherë kur raportimi mediatik ka vuajtur pasojat e njëanshmërisë dhe joobjektivitetit.

Përshkrimi i ngjarjeve nga Gaza nuk e ka pasur metodologjinë e njëjtë të punës si në zonat tjera të konfliktit. Në Gaza gazetarët e disa mediave botërore kanë vërejtur vetëm grumbuj protestuesish që pop provokonin ushtrinë izraelite dhe për rrjedhojë konflikti kishte degraduar në trajta të përgjakshme. Edhe pse të hënë dhuna e shkaktuar ishte e njëanshme - asnjë izraelit nuk është vrarë - mediat megjithatë raportuan sikur të ishte ndonjë aksident trafiku. Mediat u bënë sikur po shohin një shfaqje me një perde në mes të skenës, ku viktimat shtoheshin dhe ato nuk dihej se si shkaktoheshin. Kështu, bie fjala, New York Times njoftoi përmes një statusi në Twitter: "Dhjetëra palestinezë kanë vdekur në protestat pasi Shtetet e Bashkuara po bëjnë hapjen zyrtare të ambasadës në Jerusalem". Ata që lexojnë këtë status, nuk e kanë të qartë se kush i vrau këta protestues dhe fitohet përshtypja sikur këtë krim e kanë kryer alienët.

Kjo fshehje e qëllimshme e të gjithë pjesëmarrësve në këtë ngjarje dramatike, e bën më të diskutueshëm rolin arbitrar të redaktorëve në disa media botërore. Për të vërtetuar këtë mjafton të citojmë "The Washington Post": "Gaza varros të vdekurit e saj, ku numri i të vdekurve në protestën në kufi me Izraelin shënon të paktën prej 60 personave", por, pa e saktësuar se cilët janë vrasësit e të vdekurve në Gaza? Ngjashëm vepron edhe "The Wall Street Journal" që kishte publikuar një video në uebsajtin e tyre me titull "Përballja mbi ambasadën e re të SHBA-së në Jerusalem la dhjetëra të vdekur".

Tragjeditë njerëzore bëhen edhe më të llahtarshme kur ato vëzhgohen me pasivitet. Mediat do të duhej të jenë të fundit që të jenë në këtë linjë veprimi. Sidomos në ngjarjet që janë transparente, ku publiku ka mundësi të krijoj imazh të drejtpërdrejt mbi zhvillimet në terren, është e tepërt kjo sjellje e dyfishtë e mediave, duke lënë nën hije ato detaje që janë më të rëndësishme. Gjithkund dhe gjithmonë kur raportohet për një ngjarje që prodhon vdekje, është e palogjikshme të mos jepen edhe autorët e vdekjeve.

Disa media botërore këtë të hënë kishin pa vetëm protestues të revoltuar në Gaza, por nuk kishin arritur të regjistrojnë vrasës. Gjuha e përdorur në këto media nuk përmban etikën e domosdoshme të raportimit, kurse përgjegjësia ndaj publikut mbetet e ngatërruar në labirintet e ndërgjegjes profesionale.

SHQIPTARI LËSHON PE PREJ TUTES

"Popull interesant jemi. Në nivel nacional jemi shumë tuca. Shumica nuk guxojne publikisht asnje fjale me tha kundër nje kryetari komune a nje ministri. Ka shume raste qe ankohen qe dikush i fortë ia ka uzurpu pronen.



Nuk guxon shqiptari as syte me ia leshu prones së tij prej tutes. Per gjithçka leshon udhe shqiptari. Kuptohet, prej tutes.

Por, kur të vjen puna per sene të vogla, si për parking, shqiptari është në gjendje me i shku fyt a fyt dej në fund.

Me ba dekën qaty në parking. Edhe pse ma llogari ka me u rrehë per tokën e tij. Nuk e di njeri çka thotë. Ndoshta, sociologet munden me na dha ndonje shpjegim ma te detajuar", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, gazetari Parim Olluri.

ÇËSHTJA PALESTINEZE, PËRCAKTORJA E TË ARDHMES SË NJERËZIMIT!

"Nesër në Stamboll do të mblidhet urgjentisht Organizata për Bashkëpunim Islamik (OBI) e cila do të shqyrtojë gjendjen tepër të rëndë në Gaza të Palestinës.

Sipas njohësve të Lindjes së Mesme, nesër priten të merren vendime me rëndësi historike karshi masakrave izraelite mbi popullatën e pafajshme palestineze.



Që nga 30 marsi i këtij viti, Izraeli ka vra mbi 100 pleq, gra e fëmijë palestinez.

Vetëm para 3 dite cionistët izraelitë masakruan 60 palestinezë të pafajshëm të cilët kishin dalë në protesta për të kundërshtuar dëbimin e myslimanëve nga tokat e tyre.

Takimi i nesërm i OBI-t është përpjekja e fundit e paqes para një kaosi të madh që po e pret rajonin dhe botën", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, teologu Mustafë Bajrami.

KATUNDARË HAJNA SI KËTU SI NË BE

"Vjen macja e te prishë ditën!!! Po rrija me kënaqësi këtu duke shijuar një ditë të bukur, po shihja Putinin që i jepte kamionit pa vënë rripin, dhe po mendoja se sa plehra nga paria e jonë i ka blerë ai, dhe ja tani mësoj se po na dalin holandezët që thonë se nuk do të na pranojnë në BE, pikërisht ashtu siç kam 20 e ca vjet që e them, se me demok jemi vend që nuk plotësojmë kushtet dhe se jemi të kriminalizuar!!!! Kësaj i thonë me të prishë ditën... edhe mua edhe katundarëve tanë europianedashës, që edhe pse të krimbur më para, nuk duan që nuk duan të bëhen shqiptare... por duan të jenë katundarë hajna si këtu si në BE...", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, profesori Shenasi Rama.



MEDIACitate

BE PËRCAKTON
FUSHAT E
PRIORITETEVE
NË BALLKAN

Zyrtarët e lartë të mbi 30 vendeve europiane, u mbledhën në Sofje të Bullgarisë në takimin e lartë ndërmjet Bashkimit Europian dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Samiti i pari i këtij lloji në 15 vjet, synon të rikonfirmojë ardhmërinë europiane të vendeve të rajonit.

Ajo që bie në sy në deklaratën e përbashkët të samitit të Sofjes, është se të gjitha vendeve të Ballkanit u referohen me emrin e përbashkët të Ballkanit Perëndimor dhe përcaktimi i Axhendë së Prioriteteve të Sofjes e përbërë prej gjashtë pikash.

E para dhe një nga më të rëndësishmet, ka të bëjë me forcimin e mbështetjes për sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë. Përmirësimi i mbështetjes për reformën gjyqësore dhe përpjekjet për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve për parandalimin e korrupsionit. Shtrirja e misionëve këshillues juridike me mbështetje të rritur nga shtetet anëtare dhe nga BE Rritje e monitorimit të reformave përmes misionëve sistematike, të bazuara rast pas rasti. Vendosija e monitorimit në fushën e rasteve të rënda të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Bashkëpunim për një matje më të mirë të rezultateve në reformën në drejtësi.

Hartimi i mbështetjes për Ballkanin Perëndimor përmes Fondacionit Europian për Demokraci në fushën e medias së pavarur dhe pluraliste, si dhe shoqërisë civile.

Fushat e tjera kanë të bëjnë me luftën ndaj terrorizmit, dyfishimin e programit Erasmus + për të rinjtë e Ballkanit Perëndimor, si dhe rritja e ndërlidhjes në rajon, qoftë kjo infrastrukturale, në fushën e energjisë etj.

(Konica.al, 17 maj)

NËSE NUK
E KËNI DITUR...

KUR DHE KU JANË PRODHUAR LLULLA NË SHQIPËRI?

Llullat (çibukët) në lashtësi janë përdorur edhe për të tymosur bimë të tjera e droga, sidomos për qëllime mjekësore. Llullat prej balte të pjekur janë punuar nga poçarët, si p.sh. në Farkë të Tiranës deri në shek XVIII-XIX.

Krahas tyre janë punuar llulla e cigarishte prej druri, sidomos në fshat. Zeja e punimit me çark të llullave u zhvillua në qytete, veçanërisht në Shqipërinë e Mesme. Zejtaret përdornin dru të fortë bushi,



arborea) dhe filloi prodhimi industrial i llullave. Llullat prej shqope prodhoheshin në një fabrikë të veçantë me teknologji të kohës, të ngritur në Tiranë dhe eksportoheshin në disa vende të botës.

grifshe, degë shqope etj. Në vitet 20-30 të shek XX filloi nxjerrja, përpunimi dhe eksportimi si lëndë e parë gjysmë e gatshme e rrënjës së shqopës. Pas Çlirimit u kalua në përpunimin e plotë të rrënjës së shqopës (Erica

KRB e thelloi bashkëpunimin rajonal në të gjithë sektorët

Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (KRB) arriti me aktivitetet e tij dhe me përpjekjet e vendeve të Ballkanit Perëndimor ta thellojë bashkëpunimin rajonal në pothuajse të gjithë sektorët, deklaroi sekretari i përgjithshëm i KRB, Goran Svillanoviq, në Sofje. Duke folur në Samitin e Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor në emër të KRB, që është organizatë e vetme ndërqeveritare e vendeve anëtare të Procesit për bashkëpunim në Ejl (PBEJL), Svillanoviq nënvizoi se rezultatet veçanërisht janë të dukshme në bashkëpunim për lëvizjen e fuqisë së punës dhe ekonomisë dhe lidhshmërinë digjitale të rajonit, si pjesë të Planit veprues shumëvjeçar (OVSH), i miratuar vitin e kaluar në Trieste. Duke i mbledhur raportet e marra nga gjashtë vendet e rajonit Svillanoviq, siç kumtoi KRB, i prezantoi rezultatet kryesore në draft raportin për zbatimin e planit për hapësirë të përbashkët ekonomike (OVSH-HPE):

- Agjenda investuese: të gjitha gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor e mbështesin Agjendën rajonale për reforma në fushën e investimeve me grupin përkatës të politikave dhe e kanë harmonizuar dokumentin politik për koordinim të tregjeve financiare dhe diversifikimin e qasjes ndaj tregjeve të kapitalit.

- Intervenim digjital: rajoni ka ngritur dialog politik në nivel të lartë për digjitalizimin e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor përmes rrugës së samiteve digjitale vjetore, ndërsa i pari është mbajtur në Shkup më 18 dhe 19 prill të vitit 2018. Këshilli u ka bërë thirrje ekipeve për përgjigje të incidenteve të sigurisë kompjuterike nga gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor dhe përfaqësuesit e tyre i ka përfshirë në aktivitetet për siguri kibernetike, me çfarë përforcohen kapacitetet për siguri kibernetike dhe avancohet bashkëpunimi midis ekipeve të rajonit. Përveç kësaj, KRB ka arritur marrëveshje që marrëveshja rajonale ekzistuese për roaming të vazhdohet dhe të vendoset parimi në gjashtë vendet "në roaming, njëjtë si në shtëpi".

- Agjenda për mobilitet: gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor e kanë mbështetur rekomandimin për fillimin e negociatave për marrëveshje për njohje reciproke të kualifikimeve profesionale. KRB ka ndërmjetësuar edhe gjatë harmonizimit të parimeve kyçe të modelit të përbashkët për njohje automatike të kualifikimeve akademike të Ballkanit Perëndimor. Këshilli rajonal për bashkëpunim është trup ndërqeveritar i PBEJL, themelues dhe anëtar i plotfuqishëm është Republika e Maqedonisë, ndërsa nga samiti i kaluar në Trieste i është dhënë rol kyç ta koordinojë bashkëpunimin në rajon.

ZAEV DHE CIPRAS OFROJNË QËNDRIMET, NDËRHYN MERKELI DHE MAKRONI

GJENDET OPSIONI I MUNDSHËM PËR EMRIN



Sofje, 17 maj - Kryeministri i Maqedonisë dhe Greqisë në takim në margjinat e Samitit BE-Ballkani Perëndimor në Sofje kanë shqyrtuar opsione të mundshme për zgjidhje kreative për kontestin me emrin, me ç'rast njëra prej tyre ka qenë më e pranueshme, njofton raportuesi i MIA-s nga kryeqyteti i Bullgarisë. "Së bashku me kryeministrin Cipras kemi shqyrtuar opsione të mundshme për zgjidhje kreative, të cilët pala e Maqedonisë i prezantoi në fazën e fundit të bisedimeve. Pason konsultime në dy vendet me faktorë të rëndësishëm politik, informoi Zaev në konferencën për shtyp në Sofje.

Kryeministri Zaev theksoi se me Ciprasin kanë biseduar në mënyrë thelbësore për disa opsione, me ç'rast kanë vërtetuar një opsion, e cila mund të jetë e pranueshme për dy palët. Vazhdojnë konsultimet në terren vendor në dy vendet. Zaev theksoi se nëse është e mundur zbatim praktik i kësaj zgjidhje, atëherë në të vërtetë kemi zgjidhje. Kryeministri nuk precizoi për çfarë zgjidhje bëhet fjalë, as nuk u përgjigj drejtpërdrejtë nëse në takim është bërë fjalë për ndryshim të Kushtetutës së Maqedonisë. Ai tha se në proces nuk janë vetëm ai dhe Cipras dhe se duhet të bisedohet me kryetarët e dy shteteve dhe me shefat e opozitës. "Prej sot, miqësia mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë është më e fuqishme. Zgjidhim kontest që ta përforcojmë dinjitetin dhe identitetin e qytetarëve në dy vende", tha Zaev. Në pyetjen nëse është e mundur zgjidhja e kontestit të anulohet për në vjeshtë, Zaev tha se gjithçka është e mundur. Ai theksoi se dy palët kërkojnë zgjidhje të pranueshme.

PESIMIZËM PËR ZGJIDHJE DERI NË KORRIK

"E dini se në qershor ka Samit të BE-së, në korrik Samit të NATO-s dhe Maqedonia dëshirojnë deri atëherë të gjendet zgjidhje, por nëse nuk gjendet vazhdojmë të kërkojmë", theksoi kryeministri. "Bashkimi i sotëm i të gjithë liderëve të BE-së dhe të gjithë liderëve të Ballkanit Perëndimor tregon se edhe më fuqishëm jemi të lidhur dhe se dyert e BE-së janë të hapura për ne", tha Zaev, ndërsa e përshëndeti apelin e BE-së deri te rajoni "që të tregojmë se anëtarësimi në Bashkësinë evropiane

ne është zgjidhje e gjeneratës dhe orientim strategjik". Njëkohësisht, shtoi ai, rajoni pret raport të njëjtë edhe nga vendet anëtare të BE-së drejtë nesh.

"Në planin vendor shteti i robëruar dhe kontesti 25 vjeçar rreth emrit ishin çështjet më të vështira të cilat në gjithë këtë kohë e çuan Maqedoninë prapa. Sot, ballafaqohemi me këto dhe patëm sukses. Sot Maqedonia dhe qytetarët shkojnë para. Së bashku shënuam se 2018-ta do të jetë vit i reformave të fuqishme dhe se Maqedoninë e dërgojmë në BE dhe me këtë Evropën e sjellim në Maqedoni", tha kryeministri në margjinat e Samitit. Në këto tema bisedoi edhe me presidentin e Francës, Emanuel Makron dhe me kancelaren e Gjermanisë, Angela Merkel. "Ata e njohin lidhshmërinë të cilin e demonstroi Maqedoninë dhe japin përkrahje që të përforcohen lidhjet ndërmjet nesh dhe BE-së, tha Zaev.

Makron dhe Merkel, por edhe kryeministri i Holandës, Mark Rute, kryeministri i Austrisë, Sebastian Kurc, kryeministrat e Suedisë dhe Estonisë Stefan Lofren dhe Juri Ratas, me të cilët gjithashtu kishte takime bilaterale e japin mbështetjen e tyre të pa rezervë dhe mirënjohjen për atë që është arritur, si dhe inkurajimin që shteti të qëndrojë në agjendën evropiane.

"Porositë e tyre janë vërtetim për perspektivat tona. Kjo nënkupton se anëtarësimi i Maqedonisë në BE garanton institucione të fuqishme dhe shtetjuridik. Anëtarësimi në familjen evropiane për Maqedoninë nënkupton edhe rritje të përshpejtuar ekonomike, mobilizim të rritur, lidhshmëri dhe shanse të barabarta për të rinjtë e Maqedonisë me moshatarët e tyre evropianë", theksoi Zaev. Sipas tij, Samiti i sotëm tregoi se zgjerimi i BE-së, gjegjësisht sigurimi i "karriges sonë në Bruksel është realitet i cili është para nesh nëse vazhdojmë me përmbushjen e standardeve evropiane dhe në çoftë se i përforcojmë lidhjet e Maqedonisë dhe Ballkanit Perëndimor me Bashkësinë evropiane.

MERKEL: TREGIMI I SUKSESSHËM I MAQEDONISË DUHET TË VAZHDOJË

Mbështetja e madhe e qytetarëve për aspiratat e vendeve për anëtarësim në BE dhe në NATO flet se vendi nuk ka alternativë

Kryeministri Zaev theksoi se me Ciprasin kanë biseduar në mënyrë thelbësore për disa opsione, me ç'rast kanë vërtetuar një opsion, e cila mund të jetë e pranueshme për dy palët. Ai nuk precizoi për çfarë zgjidhje bëhet fjalë, as nuk u përgjigj drejtpërdrejtë nëse në takim është bërë fjalë për ndryshim të Kushtetutës së Maqedonisë

tjetër. Qytetarët e Republikës së Maqedonisë ndajnë vlera të njëjta evropiane dhe meritojnë vlerësim individual për avancimin në bazë të arritjeve. Këtë e theksoi kryeministri Zoran Zaev i cili në Samitin e BE-së për Ballkanin Perëndimor realizoi takim me kancelaren gjermane, Angela Merkel. Në takim, siç kumtoi shërbimi qeveritar për media, morën pjesë edhe zëvendëskryeministri për çështje evropiane Bujar Osmani dhe ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov. Kryeministri Zaev në takim e theksoi bashkëpunimin e jashtëzakonshëm dhe mbështetjen e sinqertë që Maqedonia e merr nga Republika Federale në të gjitha proceset politike. "Republika e Maqedonisë me aktivitete të forcave progresive politike në vend ka bërë hap të madh dhe nga 'shteti i robëruar' është kthyer në rrugën e proceseve demokratike për reforma në vend dhe për intensifikimin e agjencisë euro-atlantike", thuhet në kumtesë. Kryeministri Zaev theksoi se është i bindur se RF e Gjermanisë do ta dedikojë mbështetjen e saj për datë për negociatë në Samitin e ardhshëm të Këshillit të Evropës në muajin qershor. Zaev, siç theksoi, shpreson në mbështetjen e kancelares Merkel në bisedimet me kryeministrat e tjerë të vendeve anëtare të BE-së. Në takim, Zaev e ndau si shumë të rëndësishme për rajonin, iniciativën që Procesit i Berlinit, nga i cili dalin një numër i madh i projekteve për lidhje ekonomike dhe të tjera të vendeve të Ballkanit Perëndimor. "Kryeministri Zaev dhe kancelaraj Merkel biseduan edhe për pasojat e mundshme nëse rajoni dhe Republika e Maqedonisë nuk i marrin mirënjohjet e merituar dhe nëse kontestohen proceset për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Një skenar i tillë do t'i pengojë proceset reformuese, do t'i inkurajojë forcat politike regresive dhe do të hap hapësirë për involvimin e palëve të treta që mund të shkaktojë prishje të stabilitetit. Që të eliminohen këto kërcënime të mundshme, tregimi i suksesshëm i Republikës së Maqedonisë duhet të vazhdojë edhe sivjet me vendime të guximshme që duhet të vijnë nga BE-ja dhe NATO-ja", thuhet në kumtesën e Qeverisë.

S'KA LËVIZJE NË PUNËN E KOMISIONIT PËR TRANSPORT

VMRO ME AMENDAMENTE BLOKON LIGJET PËR MEDIAT

Deri tek këto amendamente ka ardhur pasi VMRO dhe partitë në pushtet nuk kanë gjetur gjuhë të përbashkët paraprakisht rreth Këshillit programor të RTVM-së, dhe rreth kriterëve për nominimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë për media dhe shërbime audio dhe audio-vizuale



min e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë për media dhe shërbime audio dhe audio-vizuale.

VMRO ka kërkuar që anëtarët e tanishëm të Këshillit Programor të mbarojnë mandatin e tyre pavarësisht ndryshimeve të reja ligjore, ndërsa LSDM ka propozuar që të njëjtit të shkarkohen nga Ligji të hyj në fuqi dhe të zgjidhen anëtarë të rinj të Këshillit programor. Përveç kësaj, VMRO nuk po pajtohet që dy anëtarët e Këshillit të Agjencisë për media të mos propozohen nga së paku dy organizata joqeveritare dhe një anëtar tjetër të nominohet nga Konferenca e universiteteve. Me këtë rast, VMRO arsyetohet se anëtarët e propozuar nga sektori joqeveritar do të jenë njerëz të afërt

me partitë në pushtet dhe nga ana tjetër - sa i përket asaj se kush mund të nominohen - deputetë e VMRO-së kanë mbajtur qëndrimet se kriteret nuk janë të qartësuar për cilësinë e kandidatëve.

"Na thoni në bazë të cilave kritere, një kandidat qenka më i mirë se tjetri meqë mund ti merr dy nënshkrime nga dy OJQ që janë të lidhura me politikën, apo do të jenë nga Revolucioni Laraman. Po për universitetet ka ndonjë dalim se kush do të jetë kandidat më i mirë - njëri që p.sh. mund të favorizohet meqë ka kryer studimet në Universitetin që ia jep nënshkrimin dhe tjetri që mund të ketë kryer jashtë vendit nga Universitetet e ranguar lart mund të mos marrë nënshk-

ime nga Universitetet e vendit. Prandaj, më mirë të hiqen këto kritere dhe ata që kandidojnë, të kandidojnë direkt në bazë të konkursit që do ta shpall Parlamenti, dhe këtu do ti debatohet biografitë e tyre", theksoi deputetja e VMRO-së, Nevenka Stamenkovska gjatë debatit në Komisionin për transport lidhje dhe ekologji.

Por me heqjen e kriterëve të propozuara nga deputetët e VMRO-së nuk u pajtua deputeti i LSDM-së, Dime Velkovski, duke kujtuar kështu se këto dy ligje ishin pjesë e Marrëveshjes së Përzihos mes katër partive politike. "Nuk e kam të qartë pse doni të bllokoni kur ky draft është pjesë e Marrëveshjes së Përzihos të nënshkruar

nga katër parti politike dhe ka ardhur si rezultat i vërejtjeve të shumta në Raportin e Pribes. Tani doni të bllokoni me amendamente dhe merrni kohën dhe ende jemi te amendamenti i 70-të. Plus dhe jeni kontradiktor, në një amendament thoni të mos ketë nënshkrime, te tjetri thoni të zgjidhen OJQ-të", tha deputeti Velkovski. Ne, shtoi ai, ishim të sinqertë dhe ju pritëm të ktheheshit në Parlament dhe të merremi vesh bashkë për të votuar dy ligje që janë shumë të rëndësishme për mediat. Ndryshe me propozim-ligjin e ri për themelimin e servisit publik me propozim të BDI-së, por që ka marrë përkrahjen edhe të LSDM-së, parashihet program 24 orë vetëm në gjuhën shqipe të radios, përveç programit televiziv që është rregulluar më herët, por që ene nuk është realizuar. "Me këto ndryshime kemi diçka të re tani, ku përveç Televizionit që është rregulluar më parë, do të kemi edhe program në radio 24 orë në gjuhën shqipe. Kjo do të jetë një mundësi e mirë që në servisin publik të kemi një fizionomi komplet shqip - në televizion dhe radio, me çka dhe do të rritet numri i gazetarëve dhe punonjësve tjerë në këto dy njësi", tha për gazetën KOHA, deputeti Rexhail Ismaili.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 17 maj - Deputetët e VMRO-së kanë vazhduar me bllokimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audio-vizuale, si dhe Ligji për themelimin e Ndërmarrjes Publike Radiodifuzioni i Maqedonisë, edhe atë përmes fjalimeve të zgjatura mbi 80 amendamentet në Komisionin për transport, lidhje dhe ekologji. Deri tek këto amendamente ka ardhur pasi VMRO dhe partitë në pushtet nuk kanë gjetur gjuhë të përbashkët paraprakisht rreth Këshillit programor të RTVM-së, dhe rreth kriterëve për nomini-

2017-ta, TREND POZITIV I KURORËZIMEVE

GUSHT... E DASMË, KOMUNAT SHQIPTARE I LËNË PAS TË TJERAT

Komunat si Tetova, Gostivari, Saraji, por edhe Struga e Dibra plotësojnë vakumin e krijuar nëpër komuna të tjera maqedonase ku martesat janë në numër disa herë më të vogël, por njëherazi ndikojnë pozitivisht në raportet e shpërpjesëtuara me divorcet. Tetova është komuna që renditet e para për shifrat e larta të martesave të evidentuara, gjithsej 785 të tilla ose 90 më shumë se një vit më parë



tuara me divorcet. Tetova është komuna që renditet e para për shifrat e larta të martesave të evidentuara, gjithsej 785 të tilla ose 90 më shumë se një vit më parë. Numri i kurorëzimeve vetëm në këtë komunë përbën rreth 6 për qind të numrit të përgjithshëm të tyre. Struga dhe Dibra janë po ashtu dy komuna që ndonëse vitet e tjera kanë regjistruar shifra më të ulëta kurorëzimesh gjatë 2017 kanë rritur numrin e përgjithshëm të tyre. Një pasqyrë e ngjashme të dhënash është edhe për komuna si Saraji (336 martesat), Haraçina, Tearca, Zhelina (281), ku vazhdimisht numri i martesave të regjistruara ecën me trend pozitiv. Mes tyre dallojnë disa të tjera, si komuna e Çairit, ku numri i kurorave të evidentuara gjatë vitit të kaluar ka pë-

suar rënie, po ashtu edhe Likova, apo Vrapçishti.

Në total gjatë vitit të kaluar janë regjistruar rreth 13.800 martesat, shifër kjo që është 4,4 për qind më e lartë sesa një vit më parë. Pasqyra e të dhënave gjithsej që nuk përkon me situatën reale, për shkak se në shumë komuna divorcet, apo martesat në disa raste janë fiktive dhe në marrëveshje mes bashkëshortëve për të siguruar shtetësinë në një shtet tjetër. Nga ana tjetër në zyrat e gjendjes civile në komunat shqiptare pohojnë se gjatë një viti ndodhin më shumë martesat sesa regjistruar në realitet, pasi akti i celebrimit pason disa vite më vonë, kur çiftit i nevojiten dokumente në rastet e lindjes së një fëmije, apo të rregullimit të dokumentacionit në

NUMRI I KURORËZIMEVE 2017 (KOMUNAT SHQIPTARE)

Tetovë 785
Gostivar 757
Struga 502
Çair 488
Saraj 336
Zhelinë 281
Likovë 274
Vrapçisht 258
Tearcë 203
Studenica 186
Dibër 165
Haraçinë 101

NUMRI I KURORËZIMEVE 2017 (KOMUNAT MAQEDONASE)

Manastir 496
Gazi Baba 469
Aerodrom 453
Prilep 430
Ohër 339
Karposh 301
Qendër 290
Vevçan 13
Zërnovc, Llozovë 11

papërfillshëm krahasuar me vitin e kaluar, gjithsej 1194 shkurorëzime, ose 0.5 për qind më shumë se në 2016. Karakteristikë për muajin kur ndodhin divorcet është dhjetori dhe më pak në muajin gusht. Moshë mesatare e të divorcuarve është nga 30 deri në 34 vjeç, që nënkupton se disa martesat nuk arrijnë t'i mbijetojnë as pesëvjeçarit të parë. Komuna ku ndodhin më pak martesat gjatë një viti është Vevçani (13 martesat), Novaci, Llozova (11 martesat). Në një situatë të ngjashme janë edhe komuna të tjera më të mëdha, ku si pasojë e numrit të vogël të kurorave dhe lindjeve, divorcet në rritje dhe numrit të lartë të vdekjeve, kanë kaluar në ritmet negative të pakësimit drastik të popullsisë.

Koha

Evis HALILI

Shkup, 17 maj - Nëse gjatë vitit të kaluar kurba e martesave të regjistruara në rang vendi është në rritje janë zyrat e gjendjes civile në komunat shqiptare aty ku çiftet drejtohen më së shumti për të kurorëzuar bashkëshortësinë. Komunitat si Tetova, Gostivari, Saraji, por edhe Struga e Dibra plotësojnë vakumin e krijuar nëpër komuna të tjera maqedonase ku martesat janë në numër disa herë më të vogël, por njëherazi ndikojnë pozitivisht në raportet e shpërpjesë-

Për një pjesë të madhe të të papunëve në Maqedoni, por edhe në shtetet e rajonit, punët sezonale paraqesin mundësi për mbijetesë. Në Gjermani, Austri dhe disa shtete të tjera vetëm në ueb faqen joble.org ofrohen në mënyrë legale më shumë vende pune

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 17 maj - Shkalla e lartë e papunësisë, si dhe standardi i ulët në shtetet e rajonit, kanë bërë që për çdo vit në sezonin e pranverës, të rinisë fluksi i punëve sezonale në shtetet perëndimore. Njerëzit punësohen jashtë shtetit në mënyra të ndryshme. Disa shkojnë përmes agjencive apo ndërmjetësuesve, ndërsa të tjerët shfrytëzojnë informacionet që ofron interneti. Gjithashtu shfrytëzohen edhe përvojat dhe lidhjet e vjetra të punës sezonale në vitet e kaluara, ndërsa një ndihmesë në këtë drejtim ofrojnë edhe familjarët që jetojnë dhe punojnë jashtë. Gjithashtu shfrytëzohet edhe mundësia e paraqitjes së drejtpërdrejtë në shpalljet për punë, si dhe puna në të zezë.

Për një pjesë të madhe të të papunëve në Maqedoni, por edhe në shtetet e rajonit, punët sezonale paraqesin mundësi për mbijetesë. Në Gjermani, Austri dhe disa shtete të tjera vetëm në ueb faqen joble.org ofrohen në mënyrë legale më shumë vende pune duke filluar nga ato në hotele, elektrikist, punëtorë të qeramiks, pastrues, saldues, kamerier, kuzhinier, automekanik, punëtorë në plantazhe të pemëve, përkujdesja për të moshuarit, vozitës etj.

Shpesh punëdhënësit që kërkojnë zanatlinj të profileve të

PUNA SEZONALE

MUNDËSI PËR MBIJETESË



caktuara, siç është për shembull profesioni i elektrikistit, jo vetëm që sigurojnë sistemim dhe ushqim, por edhe sigurojnë dokumentet legale për qëndrim dhe punë sezonale në Gjermani me pagë mujore prej 2400 euro. Në Austri ofrohet punë për ndërtimtarët që fillon me 10 euro neto për orë pune. Në Angli ofrohet vendi i punës i përkujdesjes së personave të moshuar për kompensimin mujor prej 2000 deri 2500 euro. Në Islandë ofrohen punë për mjeshtrit e fasadave dhe zdrukthëtarët për 20 euro orën. Në Itali pastruesit e dhomave të hoteleve paguhen 1600 euro, përfshi edhe sistemimin dhe ushqimin. Ndërkaq për salduesit me përvojë në Itali ofrohen paga prej 2000 deri 2600 euro me ushqim dhe fjetje të siguruar.

Në Austri ofrohet edhe pagë prej afër 1400 euro për punë tre mujore për mbledhjen e dredhëzave. Në Gjermani për mbledhjen e pemëve dhe perimeve të ndryshme ofrohet pagë mujore prej 2000 euro me fjetje dhe ushqim të paguar.

Në ndërkohë në Itali, sipas dekreteve të flukseve 2018, janë vendosur në dispozicion 30.850 kuota për punë sezonale të punonjësve të huaj, përfshi edhe shtetasit e Maqedonisë, Shqipërisë etj., si dhe ofrohen konvertime lejesh të ndryshme qëndrimi në leje pune të huajve që tashmë janë rezidentë në Itali.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme Italiane, 30.850 kuotat janë të ndara për

18.000 punëtor sezonal për sektorin bujqësor dhe atë turistik (2.000 nga këto u rezervohen autorizimeve shumëvjeçare). Punëtorët mund të jenë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Algjeria, Bosnja-Herzegovina, dhe dhjetëra shtete të tjera afrikane dhe aziatike si Korea, Bregu i Fildishtë, Egjipti, El Salvadori, Etiopia, Sudani, Tunizia, Gambia, Gana, India, Mali etj. Angazhimi me punë sezonale praktikohet edhe në vendet e rajonit, konkretisht në bregdetin e Adriatikut, qoftë në Kroaci apo Mal të Zi si kamerierë, kuzhinierë, punë-

torë në ndërtimtari etj. Kroacia madje e cila vite me radhë ballafaqohet me ikjen e fuqisë punëtore kryesisht në Gjermani, e plotëson boshllëkun me punëtorë sezonal kryesisht nga Bosnja e Hercegovina, dhe më pak nga Maqedonia dhe Serbia. Në këtë shtet ofrohen më shumë se 70.000 vende të lira pune dhe një pagë mesatare prej 500 deri në 2000 euro. Pagat në restorante apo hotele për kamerierë lëvizin prej 600 në 800 euro, me ç'rast ofrohet edhe akomodimi dhe ushqimi, ndërsa nga bakshishet mund të fitohet së paku edhe një pagë mujore. Shpesh punohet edhe nga 12 deri 14 orë. Kuzhinieri në Kroaci fiton rreth 2000 euro në muaj.

Gjithashtu, edhe studentët përmes programeve të ndryshme shkojnë për punë sezonale në Gjermani apo Amerikë ku punojnë, punë të ndryshme. Kur kthehen në shtetet e rajonit, një pjesë e konsiderueshme e tyre vijën me disa mijëra euro të kursyera. Me këto kursime e kalojnë pjesën e mbetur të vitit.

Ofertë e përbashkët turistike

Shkup, 17 maj - Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, në vigjilje të Samitit BE-Ballkani Perëndimor u takua me ministren e Turizmit të Republikës së Bullgarisë, Nikolina Angelova. Ai gjatë takimit ka shprehur kënaqësi me rritjen e vazhdueshme të numrit të turistëve bullgarë në Maqedoni, duke përmendur faktin se në vitin 2017 afro 50 mijë shtetas bullgarë kanë vizituar Maqedoninë, duke realizuar rreth 80 mijë bujtje.

Në fakt, sipas të dhënave statistikore që paraqiti ministri, numri i turistëve bullgarë të cilët vizituan Maqedoninë në vitin 2017 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar u rrit me 24 për qind, aq sa është edhe numri i bujtjeve, ndërsa gjatë muajve janar - mars 2018, Maqedonia u vizitua nga rreth 10 mijë mysafirë bullgarë, të cilët kanë bërë 14 mijë bujtje në vendin tonë, një rritje prej 21 për qind të vizitorëve, dhe 14 për qind të bujtjeve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ministria bullgare Angelova, ndërkohë, shprehu kënaqësinë që në sezonin e dimrit turistët nga Maqedonia zgjedhën vendpushimet bullgare të skijimit, që tregojnë se turistët nga të dy vendet kanë shije të ngjashme për përmbajtjen e ofertave turistike, dhe për ta gjejnë turne tërheqëse në fqinjësi, ndërsa shtoi ajo, nënshkrimi i Protokollit për qëllime të bashkëpunimit në fushën e turizmit mes qeverive të Maqedonisë dhe Bullgarisë vjeshtën e kaluar, ka dhënë tashmë efektet e saj në forcimin e bashkëpunimit në fushën e turizmit si një sektor me potencial të lartë, që kontribuon në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në të dy vendet. Bekteshi dhe Angelova ranë dakord se, për të tërhequr turistë nga tregjet e largët nevojitet krijimi i një rrugë (rute) rajonale turistike, dhe për këtë qëllim veç më është krijuar një grup pune nga dy vendet, të cilat deri në këtë vjeshtë duhet të përgatisin një propozim-ofertë të përbashkët të turizmit, që mund të përfshijë vendet e tjera në rajonin e interesit, të cilat do të ofrojnë tërheqje të ndryshme për turistët botërorë në një distancë të vogël.

PËR HERË TË PARË NË MAQEDONI

ARRIHET TRANSPLANTIMI JOFAMILJAR I QELIZAVE STAMINALE HEMATOPOETIKE

Shkup, 17 maj - Reparti tërësisht i rinovuar për transplantim sot është hapur në Klinikën universitare për hematologji në Shkup dhe në të për herë të parë në Maqedoni dhe më gjerë do të kryhet transplantim jofamiljar i qelizave staminale hematopoetike, që është një nga procedurat më të sofistikuar terapeutike në mjekësinë moderne. Pacientët nga tani më nuk do të duhet të shkojnë jashtë vendit për transplantim të këtillë. Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe e vizitoi Klinikën pas së cilës deklaroi se që sot pacientët në hematologji do të

mjekohen në dhoma të rinuara dhe në hapësira sipas standardeve më të moderne botërore. Thëksoi se bëhet fjalë për pacientë, të cilët mjekohen nga sëmundje malinje në gjak të cilët kërkojnë transplantim të palcës kuruzore.

"Shpenzimi gjatë vitit 2017 për rreth 25 për qind, të cilët janë dërgua në vendet e huaja për këtë metodë ka arritur mes 150.000 dhe 200.000 euro për pacient. Planifikojmë kursim serioz të buxhetit, rreth 75 për qind e parave që tani i paguajmë për mjekim në vendet e huaja, do t'i investojmë në sistemim

tonë shëndetësor në implementimin e ilaçeve të reja në listën pozitive dhe në rritjen e rrogave dhe shumave për kujdestari për mjekët dhe infermierët", theksoi Filipçe. Drejtoresha e Klinikës universitare për hematologji, Irina Panovska-Stavridis tha se pacientët do të mjekohen sipas standardeve më moderne evropiane dhe kushteve për zbatim të transplantimit. Sqaroi se ekipi që do ta bëjë transplantimin është edukuar në Gjermani, Slloveni dhe në SHA. "Shpresojmë se do të vendosim bashkëpunim edhe me spitalet e Kroacisë, të cilët po qe



se ka nevojë do të marrin pjesë në këto procedura. Nga 10 deri në 20 pacientë në vit kanë nevojë për transplantim jofamiljar të qelizave staminale hematopoetike", theksoi Panovska-Stavridis. Shtoi se në Klinikë janë punësuar katër mjekë, të cilët kanë qenë të parët e gjeneratës dhe kjo paraqet përfundim të rëndësishëm kadrovik. (D.K)

Shkup, 17 maj - Qeveria e Maqedonisë në seancën e saj të fundit miratoi propozim e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, për nevojën e përmirësimit të gjendjes së infrastrukturës rrugore në komunat e Maqedonisë. Zëdhënësi i Qeverisë së Maqedonisë, Muhamet Hoxha informoi se për këtë qëllim, Qeveria ka angazhuar shumë institucione, në mesin e të cilave edhe Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore, që të hartojnë analizë të hollësishme për gjendjen aktuale të rrugëve në të gjitha komunat.

"Rrugët janë në kompetencë të Bashkësisë së Njësite të Vetëqeverisjes Lokale, por duke pasur parasysh mundësitë financiare të komunave, këto rrugë një kohë të gjatë janë në një gjendje katastrofave. Me qëllim të sanimit të tyre, pushteti qendror përmes disa projekteve do të rehabilitojë të gjitha rrugët komunale", tha Hoxha.

Jo pak komuna kanë kërkuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve që të gjendet mënyra se si të sanohen rrugët komunale, të cilat 10 vitet e fundit janë në gjendje shumë të rëndë.

"Për këto arsye u paraqit nevoja për sigurimin e mjeteve financiare nga Qeveria të cilat do të dedikohen për sanimin dhe rehabilitimin e të gjitha rrugëve komunale që janë në gjendje të rëndë përfshirë këtu edhe rrugët nëpër

PUSHTETI QENDROR NDIHMON KOMUNAT

Rritja barabartë ekonomike rajonale duhet të jetë e qëndrueshme sepse infrastruktura rrugore, sidomos ajo brenda komunave, paraqet parakushtin kryesor për zhvillim të planifikuar rajonal

REHABILITOHEN TË GJITHA RRUGËT KOMUNALE

komunat shqiptare", tha Hoxha.

Me qëllim që këto mjete të shfrytëzohen në mënyrë sa më efektive dhe ato të shpërndahen në mënyrë të barabartë për zhvillim rajonal, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve në bashkëpunim me BNJVL-në do të merr parasysh të gjitha të dhënat relevante ekonomike të dallimeve sociale dhe ekonomike midis komunave. "Është më se e nevojshme në bazë të analizave të përgatitura të bëhet vlerësimi i mjeteve financiare të nevojshme për sanimin e infrastrukturës rru-

gore të keqe nëpër komunat dhe njëherit të vendoset një mekanizëm që rehabilitimi i rrugëve të fillohet në ato rrugë ky lidhen dy vendbanime të banuara. Rritja barabartë ekonomike rajonale duhet të jetë e qëndrueshme sepse infrastruktura rrugore sidomos ajo brenda komunave paraqet parakushtin kryesor për zhvillim të planifikuar rajonal. Gjendja e rrugëve të cilat kalojnë pothuajse në të gjitha komunat, këto dhjetë vitet e fundit, e në veçanti rrugët që kalojnë afër objekteve shkollore apo

foshnjoreve, janë larg të gjithë kritereve që duhet t'i ketë një rrugë", sqaroi Muhamet Hoxha, duke shtuar se pasi Ministria e Transportit të përgatis analizën, duhet të dorëzojë Planin e veprimit për përmirësimin e gjendjes së rrjetit infrastrukturor nëpër komunat. Gjithashtu zëdhënësi Hoxha informoi se në seancën e fundit Qeveria miratoi programin për ndryshimin dhe plotësimin e Programit për sigurimin e mjeteve për shërbime spitalore pa pagesë të pjesëmarrjes - participimit, i cili

krahas pensionistëve, do të përfshijë edhe personat të moshës deri në 18 vite të familjeve që marrin asistencë financiare sociale në Republikën e Maqedonisë për vitin 2018-të. Gjithashtu, sipas tij, edhe ministrat e kabinetit qeveritar miratuan raportet përfundimtare për revizionin e kryer të punës financiare për vitin 2016-të Institutit për Shëndet Publik dhe Institutit të Mjekësisë së Punës dhe se qeveria dy raportet e revizionit ia ka dorëzuar Prokurorisë Themelore Publike. (Z.V)

PROKURORIA SPECIALE DHA FJALËT PËRFUNDIMTARE NË RASTIN "TANK"

Prokuroria sqaroi se aktakuza është për procedurën joligjore për furnizimin e automjetit të blinduar "mercedes gard" dhe se Gruevski ka kërkuar në mënyrë joligjore të kryhet, kështu që nuk është me rëndësi a ka udhëtuar apo jo me të

GRUEVSKI TË SHPALLET FAJTORË, TË KTHEJË 500 MIJË EUROT E MERCEDESIT



Shkup, 17 maj - Prokuroria Speciale Publike në fjalët përfundimtare për lëndën "Tank" kërkon që gjykata t'i shpallë fajtorë ish-kryeministrin Nikolla Gruevski dhe ish-ndihmës ministrin në MPJ, Gjoko Popovskin, si dhe t'i paguajnë shpenzimet gjyqësore në vlerë prej 313.160 denarë (rreth 500 mijë euro). Prokurori Gavril Bubevski në fjalët përfundimtare kërkoj që gjykata gjatë konfirmimit të përgjegjësisë penale të të akuzuarve t'i marrë parasysh rrethanat e vështira se Gruevski ka vepruar me paramendim direkt derisa ka qenë kryeministër dhe veprën e ka bërë me dëshirë personale, por me mjete nga buxheti, ndërsa si rrethana lehtësuese të marrë parasysh gjendjen të tij familjare.

Prokuroria sqaroi se aktakuza është për procedurën joligjore për furnizimin e automjetit të blinduar "mercedes gard" dhe se Gruevski ka kërkuar në mënyrë joligjore të kryhet, kështu që nuk është me rëndësi a ka udhëtuar apo jo me të. "Nga MPB-ja kompanisë Mak Auto Star në vitin 2012 i janë paguar 35.226.000 denarë për furnizim. Mak Auto Star me këtë ka realizuar për 2.3 për qind përfitim më të lartë nga shitja e automjetit të këtij operatori ekonomik", tha Bubevski.

Stevço Donev nga PSP-ja në fillim të fjalëve përfundimtare tha se i akuzuari Gjoko Popovski në vitin 2011 ka sjellë vendim për blerjen e një automjeti të përdorur të sigurt në pajtim me fuqinë e zvogëluar ekonomike dhe të blerjes të MPB-së, por më pas ka ndryshuar dhe është anuluar me qëllim të furnizohet një automjet i tillë i ri. Donev, gjithashtu, theksoi se MPB-ja paraprakisht ka paraparë 15 milionë denarë për furnizimin e një automjeti të përdorur dhe më pas

e ka rritur në 30 milionë denarë për furnizimin e një automjeti të tillë. Avokatët e mbrojtjes në fjalët përfundimtare thanë se furnizimi i automjetit ishte i nevojshëm për arsye të sigurisë dhe për arsye teknike. Avokatja Sanja Aleksiq tha se me dëshmitë nga Prokuroria nuk dëshmohej vepra për të cilën akuzohet Gruevski dhe propozoi gjykim për pafajësi.

Gjykatësja Dobrila Kacarska në kërkesë të mbrojtjes dha pauzë

prej gjysmë ore, pas të cilës, siç tha, do të vazhdohet me fjalët përfundimtare të mbrojtjes. Në lëndën "Tank" akuzohen ish-kryeministri Nikolla Gruevski, ish-ndihmës ministri në MPB Gjoko Popovski dhe ish-ministria e Punëve të Brendshme Gordana Jankulovska, për të cilën procedura është ndarë për shkak të "shtatzënisë së rrezikuar". Gruevski, Jankulovska dhe Popovski akuzohen për furnizimin e mercedesit luksoz prej 600.000 eurove.

Sipas PSP-së, Gruevski si kryeministër ka kërkuar nga Jankulovska të përcaktojë një person i cili do të zbatojë furnizim të paligjshëm për automjet të ri të blinduar, ndërsa është favorizuar kompania "Max Autostar SHPKNJ". Për ta plotësuar kërkesën, Jankulovska e ka angazhuar Popovskin dhe që të dy e kanë keqpërdorur pozitën dhe autorizimin zyrtar. MPB-ja ka bërë furnizimin e automjetit i cili është dashur t'i jepet Qeverisë, por sipas aktakuzës, është furnizuar sepse Gruevski ka dashur të udhëtojë në një automjet të tillë, por nuk ka dashur opinionin e mësiojës për këtë.

Për herë të parë pas pavarësismit të Maqedonisë, duke filluar nga 16 maji, kompanitë nga sektori i biznesit privat do të kenë mundësinë e financimit të zhvillimit teknologjik, që nënkupton blerjen dhe aplikimin e teknologjisë së re, e cila do të rritë konkurrencën. Të gjitha kompanitë makro, të mesme dhe të vogla në Maqedoni do të mund të aplikojnë për marrjen e mjeteve financiare për investime, të cilat do t'i kenë në llogarinë e tyre bankare brenda 60 ditëve nga dita që ata do të aplikojnë

Koha Zejnulla VESELI

PLANI PËR RITJE EKONOMIKE DHE INVESTIME

KOMPANITË SHQIPTARE, SKEPTIKE



Shkup, 17 maj - Në kuadër të planit për rritje ekonomike dhe investime, nga dita e mërkurë (16 maj) për të gjitha kompanitë makro, të mesme dhe të vogla në Maqedoni ka filluar aplikimi për marrjen e mjeteve financiare për investime. Siç bëri të ditur edhe zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev, të gjitha kompanitë vendore makro, të mesme dhe të vogla që do të aplikojnë për mbështetje financiare nga Qeveria, të hollat do t'i kenë në llogarinë e tyre bankare brenda 60 ditëve.

"Ligji ka hyrë në fuqi nga 16 maji dhe të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të aplikojnë për marrjen e mbështetjes financiare. Ekonomia e Maqedonisë duhet patjetër të orientohet nga eksporti dhe të jetë sa ma konkurrense në tregjet e treta. Prandaj dhe ideja e Qeverisë aktuale është që me këto mjete financiare t'ju ndih-

mohet të gjitha firmave nga sektori i biznesit privat që duan të rrisin kapacitetet e tyre prodhuese", sqaron Angjushev. Ai gjithashtu informoi se qysh në thirrjen e parë publike, planifikohet që të ndahen 185 milionë denarë apo rreth 30 milion euro, që tashmë janë siguruar nga Qeveria, kurse deri në fund të këtij viti planifikohen edhe dy thirrje publike. Shuma totale e mjeteve që do të ndahen duhet të arrijë në 645 milionë denarë apo mbi 100 milionë euro, ndërkaq kushtet që kompanitë duhet t'i plotësojnë, janë definuar për çdo masë në veçanti dhe bazohen në numrin e të punësuarve, të ardhurat vjetore, strukturën pronësore si dhe përmbushjen e detyrimeve financiare ndaj furnizuesit", nënvizon Angjushev.

Sa i përket këtyre masave stimuluese të Qeverisë, nga Oda Ekonomike Maqedonisë Veriperëndimore (OEMVP) shtrojnë nevojën e

zgjërimit të listës me sektorët tjerë që kanë potencial të madh për ekonominë vendore duke përfshirë këtu edhe zhvillimin e barabartë rajonal.

Arben Halili është i mendimit se përveç sektorit të prodhimit duhet të përfshihen edhe sektorët që kanë ndikim në krijimin e BPV-në në vend. Sipas tij duhet të parashihen edhe masa të veçanta për kompanitë që vijnë nga viset rurale dhe bizneset e udhëhequra nga gratë.

"Ligji për masat e reja të promovuar nga ana e qeverisë, paraqesin një paketë atraktive në aspekt të afirmimit dhe mbështetjes së iniciativave biznesore, me theks të veçantë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Si të tilla ato duhet të shërbejnë edhe si një katalizator në aspekt të formalizimit të tërësishëm të veprimtarive afariste të kompanive", nënvizon Halili nga OEMVP-ja, duke potencuar se re-

zultati financiar i kompanive në vitet paraprake është shumë i rëndësishëm dhe kjo është një prej arsyeve që përmes këtyre masave të shkohet edhe drejt formalizimit të tërësishëm të veprimtarisë.

"Vlerësoj që kompanitë pavarësisht nga rajoni ku ushtrojnë veprimtarinë, janë të barabarta në start në aspekt të përmbushjes së kushteve për aplikim dhe në këtë drejtim edhe kompanitë shqiptare nuk dyshoj që janë potencial i mirë për të shfrytëzuar këto lloj burime të financimit. Ajo që duhet marrë në konsideratë është gatishmëria e kompanive për të besuar që këto fonde janë reale dhe për të aplikuar duhet plotësuar kushtet e parapara, ndonëse kompanitë shqiptare sikur nuk besojnë shumë në sigurimin e mjeteve përmes këtyre fondeve dhe padyshim që kjo lloj praktike duhet të ndryshojë", thotë Arben Halili nga Oda Ekonomike Veriperëndimore.

ASANI DHE PAPUKÇINSKI PËR KORRIDORIN 8

Ndërlidhje hekurudhore me Bullgarisë, deri në viti 2023

Shkup, 17 maj - Ndërlidhje hekurudhore e Maqedonisë dhe Bullgarisë deri në vitin 2023 në vend që në vitin 2025, presin drejtori i HM Infrastruktura e Maqedonisë, Irfan Asani dhe i hekurudhës bullgare Krasimir Papukçinski. Në mbledhjen e djeshme në Shkup, Asani dhe Papukçinski thanë se është prioritet ndërtimi i pjesës hekurudhore të Korridorit 8 përmes të cilit, sipas studimeve të bëra, brenda një dite duhet të qarkullojnë 10 palë trena transportues në relacionin Shkup-Sofje. "Nga ana jonë veçmë ka filluar thirrja për zgjedhje të kompanisë për projektim dhe falë mirëkuptimit mes dy shteteve fqinje, përfshirë edhe neve si kolegë, kërkojmë që të gjenden mënyra që në vitin 2023 të kemi lidhje hekurudhore me ndërtim të tunelit në Deve Bair. Dy palët kemi



vendosur qëllim që në vitin 2023 të përshëndetemi në kufirin e tunelit, respektivisht të takohemi në ndërlidhjen veçmë të krijuar dhe ta lëshojmë trenin e parë Shkup-Sofje. Punojmë në mënyrë të shkëlqyer me kolegët dhe shpresojmë se do t'i arrijmë - qëllimet e parashtruara", tha Papukçinski. Asani gjithashtu, potencoi se në vend që në vitin 2025 siç është parashikuar me Memorandumin që e kanë nënshkruar vi-

tin e kaluar ministrat e Transportit dhe Lidhjeve të Maqedonisë dhe Bullgarisë, shihet mundësi e madhe që koha e ndërlidhjes të zvogëlohet dhe të jetë në vitin 2023. "Do të mund të fillojmë të ndërtojmë pasi që do të rumbullaksohet konstruksioni financiar për çka është ndarë një pjesë e mjeteve të BE-së, ndërsa ka mbetur puna e Qeverisë, e cila bisedon me institucionet ndërkombëtare financiare", tha

Asani. Pjesa hekurudhore e Maqedonisë me Bullgarinë përfshin ndërtim të tri akseve Kumanovë - Bellakoc (31 kilometra) e vetmja për të cilën kanë filluar aktivitete tereni, Bellakoc - Kriva Pallankë (32) dhe Kriva Pallankë - Deve Bair (23 kilometra), ndërsa ndërlidhja duhet të jetë me ndërtim të tunelit në gjatësi prej 2.400 metrave në vendkalimin kufitar Deve Bair. Konstruksioni i përgjithshëm financiar i hekurudhor drejt Bullgarisë, projekt i filluar para 25 viteve vlerësohet se kushton mes 600 dhe 700 milionë euro. Në Korridorin 8 Maqedonia duhet të ndërlidhet përmes hekurudhës edhe me Shqipërinë, me aksin Kërçovë - Lin, në gjatësi prej 63 kilometrave, për të cilën është gati dokumentacioni projektues, ndërsa për ndërtimin duhet të sigurohen 500 milionë euro.

Gati Strategjia transportuese për periudhën 2018-2030

Manastir, 17 maj - Ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski në Konferencën e dytë ndërkombëtare në temë "Transporti në shoqërinë e sotme" që u mbajt në Fakultetin teknik në Manastir paralajmëroi se në Republikën e Maqedonisë do të rritet shfrytëzimi i teknologjive bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit që shfrytëzohen në transport. Sipas Sugareskit, që të mos ketë ngecje teknologjike pas shteteve të zhvilluara është e nevojshme investim në inxhinierinë transportuese të komunikacionit. "Teknologjia e re që për herë të parë përdoret në Qendrën kontrolluese në Negotinë prej ku bëhet monitorim i komunikacionit të rrugës së re në autostradën Demir Kapi-Smokvicë, sistemi i ri elektronik për pagesën e pikave pagesore si dhe projekti i ri i Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve për përpunimin e sistemit inteligjent transportues në Korridorin 10 dukshëm do t'i përmirësojnë performansat në siguri, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe shfrytëzimit të infrastrukturës". Industria transportuese, tha Sugareski, në vazhdimësi përballet me sfida të reja si rezultat i globalizimit, liberalizimit të tregjeve dhe rirregullimit në sektorin transportues dhe prandaj është e nevojshme ndjekje e të gjitha arritjeve teknologjive për shkak të implementimit të tyre dhe shfrytëzimit e përparësive që i ofrojnë, theksoi ministri Sugareski në konferencën ndërkombëtare në manastir. Para adiorimit akademik dhe profesional, ministri Sugareski përkujtoi se Ministria e Transportit dhe Lidhjeve ka përpiluar Strategji transportuese nacionale për periudhën 2018-2030. "Qëllimet kryesore të strategjisë janë që të sigurohet qëndrueshmëria ekonomike në zhvillim, menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemeve transportuese, të përmirësohet siguria në komunikacion, të zhvillohet transporti multimodal, të përmirësohet qëndrueshmëria e mjedisit jetësor dhe ndërtimi i infrastrukturës sipas standardeve evropiane si pjesë e sistemit të vetëm transportues në rajon dhe më gjerë. Propozim strategjia tani më është publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dhe gjatë muajit të ardhshëm presim rekomandime dhe komente nga tërë opinioni profesional në shtet", thotë Sugareski.



Republika e Maqedonisë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave

Në pajtim me direktivën për Furnizim të KfW "Udhëzimet e KfW për Furnizim për të Mirat, Punëve ndërtimore dhe Shërbimeve përkatëse, në Bashkëpunimin Financiar me Vendet partnere" të dhënë nga ana e Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) Banka, Gjermani, (versioni prej muajit gusht 2016) dhe Marrëveshjes për hua mes qeverive të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, për financim të projektit "Programi për ujijtë të Fushës jugore të Vardarit", Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave sjellë dhe publikon:

THIRRJE PUBLIKE Për furnizim nr. 02-6106/2018

1. Furnizues

Furnizues është Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, Drejtoria për ekonomi të ujërave, e përfaqësuar nga Njësia për Implementim të Programit, rr. "Josif Josifovski" (baraka) Gjevgjeli.

2. Procedura e furnizimit

Tenderi do të jetë i hapur, nën kushte të barabarta, për të gjitha subjektet fizike dhe juridike, të cilët marrin pjesë individualisht ose në grup (investim i përbashkët) nga vendet e përshtatshme.

Furnizimi do të realizohet me thirrje të hapur ndërkombëtare dhe në pajtim me procedurën postkualifikuese (procedurë në dy zarfe) të përshkruar në "Udhëzimet e KfW për Furnizim për të Mirat, Punëve ndërtimore dhe Shërbimeve përkatëse, në Bashkëpunimin Financiar me Vendet partnere" të dhënë nga ana e Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) Banka, Gjermani, (versioni prej muajit gusht 2016).

Në mbledhjen e parë publike do të hapen vetëm dokumentet kualifikuese dhe ofertat teknike dhe të vlerësuar në bazë të kriteret nga Dokumentacionet tenderuese. Ofertat të cilat i kanë kaluar kriteret kualifikuese dhe teknike dhe konsiderohen si përkatëse do të pranohen për hapjen e ofertave financiare.

Në mbledhjen e dytë publike, ofertat financiare do të hapen vetëm të ofertuesve të kualifikua. Pas verifikimit dhe korrigjimit të gabimeve aritmetike, oferta më e ulët do të propozohet për ndarje të Marrëveshjes.

Furnizimin do ta realizojë Komisioni për realizim të procedurave për furnizime publike i caktuar nga Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në pajtim me Vendimin për formim të komisionit për realizim të procedurave për furnizime publike me nr. 02-7614/1 të datës 18.10.2017.

3. Lëndë e furnizimit

Lëndë e këtij furnizimi është realizimi i "Punëve ndërtimore dhe punëve të tjera të Sistemit për ujijtë Vallandovë" të ndarë në dy pako, Pakoja 1: "Punët ndërtimore dhe punët tjera të Sistemit të ujijtë Vallandovë" dhe Pako 2: "Stacioni i pompës Straishte" nga Programi për Ujijtë të Luginës jugore të Vardarit Faza 2. Ofertuesit duhet të parashtrojnë ofertë për të dyja paketat.

Sistemi për ujijtë Vallandovë dhe Stacioni i pompës Straishte gjendet në Komunën e Vallandovës (Rajoni juglindor i Maqedonisë) dhe mbulon sipërfaqe prej 2032 ha për ujijtë. Punët do të përfshijnë realizimin e Ndërtimit ndarës (prag) të Lumit Vardar, rehabilitim të ndërtimit të përfshirë dhe stacionin kryesor të pompës tërësisht të automatizuar (rjedha nominale prej 2.4 m3/s), realizimin e tubacionit kryesor të gravitetit (L=8,874 m) dhe pesë stacione të pompave dhe modernizim të rrjetit distribues të tubacioneve.

4. Burimi i mjeteve

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të financojë projektin në kuadër të bashkëpunimit financiar mes Gjermanisë dhe Maqedonisë. Projekti është i financuar me 70 % të borxhit nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë përmes KfW dhe rreth 30% të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Pakoja 2 do të financohet me mjete nga Maqedonia.

5. Kriteret e përshtatshmërisë

Ofertuesit mund të parashtrojnë oferta nëse asnjë prej shkaqeve për përjashtim nuk kanë të bëjnë me ata:

1. Me përjashtim të cilësdo pajsisë ose sektor që është lëndë e embargos nga ana e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Gjermania, të gjitha mallrat, punët ndërtimore, stacionet, shërbimet konsulente dhe shërbimet

jokonsulente janë të kualifikuara për financim nga ana e KfW, pa marrë parasysh i vendin prej nga kanë prejardhjen mjetet ose resurset e shfrytëzuara në procesin e implementimit nga ana e realizuesit, furnizuesit, nën-realizuesit, konsulentit ose nën-konsulentit. Organi kontraktues do të thotë Furnizuesi, Punëdhënësi, Klienti ose Agjencia realizuese e Projektit, varësisht nga rasti, për furnizimin e mallrave, punëve, stacioneve, shërbimeve konsulente ose shërbimeve jokonsulente.

2. Subjektet fizike ose juridike (duke përfshirë anëtarë të këshillit ose përfaqësues ligjor, të gjithë anëtarë të investimit të përbashkët ose dikush nga furnizuesit e tyre, realizues, nën-realizues, konsulent ose nënkonsulent) nuk do tu jepet marrëveshje të financiar nga KfW, nëse në ditën e parashtrimit të aplikacionit, Oferta ose propozimi, ose datën e ndarjes së marrëveshjes, ata:

2.1 Janë të bankrotuar ose likuiduar ose janë ndërprerë aktivitetet e tyre, aktivitetet e tyre i realizojnë gjykatat, futen në falimentim ose janë në çfarëdo situatë të ngjashme që del nga një procedurë e ngjashme;

2.2 janë:

(a) të dënuar, në pesë vitet e fundit me vendim gjyqësor, që ka fuqinë e res judicata në vendin ku do të aplikohet marrëveshja, për mashtrim, korrupsion ose për çfarëdo veprë tjetër penale të realizuar gjatë procesit tenderues ose realizim të marrëveshjes, vetëm nëse sigurojnë informacione shtesë së bashku me Deklaratën e tyre për Marrje (Formular të mundshëm si Shtojcë të Aplikacionit, Ofertës ose Formular për Parashtrimin e Propozimit), që tregojnë se ky gjykim nuk është relevant në kontekst të kësaj marrëveshje dhe se janë ndërmarrë masa përkatëse për harmonizim;

(b) lëndë e sanksionit administrativ në pesë vitet e fundit nga ana e Bashkimit Evropian ose nga ana e pushteteve nacionale, qoftë në vendin e Organit kontraktues ose të KfW, për mashtrim, korrupsion ose për çfarëdo veprë tjetër penale të realizuar gjatë procesit tenderues ose realizim të marrëveshjes, përveç se nëse sigurojnë informata plotësuese së bashku me Deklaratën e tyre për Marrje (Formular të mundshëm si Shtojcë të Aplikacionit, Ofertës ose Formular për Parashtrimin e Propozimit), që tregojnë se ky sanksion nuk është relevant në kontekst të kësaj marrëveshje dhe se janë ndërmarrë masa përkatëse për harmonizim;

(c) të dënuar, në pesë vitet e fundit me vendim gjyqësor, që ka fuqinë e res judicata, për mashtrim, korrupsion ose për çfarëdo veprë tjetër penale të realizuar gjatë procesit tenderues ose realizim të marrëveshjes të financiar nga KfW; 2.3 janë theksuar për sanksione financiare nga ana e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe/ose Gjermania për shkak të financimit të luftës kundër terrorizmit ose kërcënimit ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Ky kriter për përjashtim aplikohet edhe për subjektet juridike, shumica e të cilave aksione mbahen ose faktikisht kontrollohen nga ana e subjektit fizik ose juridik të theksuar në listë;

2.4 në pesë vitet e fundit është lëndë e ndërprerjes së marrëveshjes tërësisht i vendosur kundër tyre për mospërbushje të rëndësishme ose të vazhdueshme të obligimeve të tyre të kontaktuar gjatë realizimit të marrëveshjes, vetëm nëse kjo ndërprerje kontestohet dhe zgjidhja e kontestit ende pritet ose nuk është caktuar vendim i tërësisht kundër tyre;

2.5 nuk kanë përbushur obligimet e tyre fiskale në lidhje me pagesat e tatimeve në pajtim me dispozitat ligjore të vendit ku janë të konstituara ose vendit të Organit kontraktues;

2.6 i nënshtrohen vendimit të përjashtimit nga Banka botërore dhe janë theksuar në ueb faqen <http://www.worldbank.org/debar>, përveç se nëse nuk sigurojnë informacione shtesë së bashku me Deklaratën e tyre për Marrje (Formular të mundshëm si Shtojcë të Aplikacionit, Ofertës ose Formular për Parashtrimin e Propozimit) që dëshmojnë se ky përjashtim nuk është relevant në kontekst të kësaj marrëveshje dhe se janë ndërmarrë masa përkatëse për harmonizim; 2.7 kanë bërë dokumente të rrejshme ose kanë realizuar prezantim të gabueshëm në dokumentacionin e kërkuar nga ana e Organit Kontraktues si pjesë e procesit tenderues të kësaj Marrëveshje.

3. Subjektet në pronësi të shtetit mund të marrin pjesë vetëm në ofertë se mund të dëshmojnë se ata (i) janë të pavarur ligjërisht dhe financiarisht dhe (ii) punojnë sipas ligjit për të drejtën tregtare. Që të jetë i përshtatshëm, subjekti në pronësi të shtetit duhet të dëshmojë në kënaqësi të KfW, përmes të gjitha dokumenteve relevante, duke përfshirë edhe Konventën e vet dhe informacioneve tjera që mund të kërkojë KfW, se: (i) është subjekt juridik i ndarë nga shteti (ii) për momentin nuk merr subvencione të konsiderueshme nga mbështetja buxhetore; (iii) funksionon si cilado ndërmarrje komerciale dhe mes tjerash, nuk obligohet të që tepriçen e tij ta dërgojë në shtetin e tij, mund të fitojë të drejtat dhe obligimet të merr hua mjete dhe të jetë përgjegjës për pagesë të borxheve të veta dhe mund ta shpall veten të bankrotuar.

6. Si fitohet dokumentacioni tenderues

Dokumentacioni tenderues do tu jepet Ofertuesve të interesuar pas pagesës së mëhershme të mjeteve të pakthyeshme në shumë prej 61.000 MKD (gjatshdëjtetjenjëmijë denarë) (në fletëpagesë PP50), në llogari të MBPEU 140010028063119 kontoja e të hyrave 725930 programi 21, llogaria trezore 100000000063095, qëllimi i pagesës "për dokumente tenderuese". Pas prezantimit të kësaj pagese, Dokumentacioni tenderues mund të merret nga Njësia për Implementim të Projektit (NJIP) "Programi për Ujijtë të Luginës jugore të Vardarit" rr. "Josif Josifovski" (baraka) Gjevgjeli, çdo ditë pune prej ora 08:00 deri në ora 17:00. Tel. 034-217-630 ose tel/faks 034-217-631. Personi për kontakt Z. Goran Angellov, Drejtori i NJIP.

7. Afati për dorëzim të ofertave

Ofertat, të përgatitura sipas kërkesës së dokumentacionit tenderues të parashtruar më së voni deri më 04.07.2018 deri në ora 10:00 në arkivin e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave (MBPEU), Aminta Treti nr. 2, 1000 Shkup.

8. Takimi para-tenderues dhe vizita e terrenit

Takimi i domosdoshëm para-tenderues dhe vizita e terrenit do të organizohet nga NJIP më datë 11.06.2018 në ora 10:30 në Zyrat e NJIP, rr. Josif Josifovski (baraka), Gjevgjeli.

KOMISIONI PËR FURNIZIME PUBLIKE

Në bazë të nenit 21 paragrafi 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/141, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të 1 (një) realizuesi për kohë të pacaktuar në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë, publikon shpallje për punësim të një (1) realizuesi për kohë të pacaktuar për pozitën në vijim:

1. Nënpunës i pavarur profesional – pedagog

Kandidati duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të një gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë.

- Kandidati të ketë së paku 180 kredi sipas SETK Fakulteti filozofik pedagogji pa përvojë pune

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrojnë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Kandidatët për të dyja pozitën e punës, duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:

- Dëshmi të shtetësisë;
- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit;
- Biografi të shkurtë;
- Letër motivimi.

Orari i kohës së punës: orë të punës në javë: 40, koha e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

Shuma në të holla e neto pagesës bazë është 23.176,00 denarë

Kandidatët e zgjedhur do të lidhin marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrohet në arkivin e: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë, ose përmes postës në adresën në vijim:

rr. "Aco Axhi Iliov" pn, Negotinë
(me shenjë "për shpallje"): nr. 04-184/
Personi për kontakt: U. D Drejtor Vijoleta Taseva
Kontakt telefoni: 075/292 904

Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IP Qendra ndërkomunale
për punë sociale – Negotinë
u. d Drejtor
Vijoleta Taseva

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 dhe 161 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 74 të datës 08.05.2015), Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave nr. 18-2861/2 të datës 12.03.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 04-194/1 të datës 16.05.2018 nga U.D Drejtori i IPSH Institutit për shëndet publik – Shtip, Prim. Dr. Marija Dimitrova publikohet

SHPALLJE PUBLIKE

për punësimin e 2 (dy) doktorëve të medicinës me kohë të pacaktuar

- IPSH Institutit për shëndet publik – Shtip ka nevojë për punësim të:
 - 2 (dy) doktorëve të medicinës për kohë të pacaktuar, për dërgim në specializim
- Kandidatët duhet ti plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të vërtetuara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore:
 - të jetë shtetas i RM,
 - të jetë i moshës së rritur,
 - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore, dhe
 - të mos je të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Përveç kushteve të përgjithshme të vërtetuara me ligj kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet e **posaçme në vijim**:
 - Arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të Fakultetit të medicinës,
 - provim të dhënë profesional,
 - licencë për punë,
 - me ose pa përvojë pune.
- Orari i punës është 40 orë. Neto pagesa fillestare për Doktor të medicinës është 26.500,00 denarë.
- Me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim
 - Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt
 - Biografi të shkurtë (CV)
 - Diplomë me sukses mesatar
 - dëshmi për njohje të gjuhës së huaj (angleze, frënge ose gjermane)
 - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë për provim të dhënë profesional, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Licencë për punë, original ose kopje të vërtetuar në noter).
- Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
- Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
- Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur të cilët i plotësojnë kushtet nga shpallja publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.
- Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e tërësishtëm të nevojshëm dhe telefoni për kontakt të dorëzohen deri në IPSH Institutit për shëndet publik – Shtip rr. Hristian Karposh pn Shtip, përmes postës ose në arkivin e IPSH Qendra për shëndet publik – Shtip me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Institutit për shëndet publik – Shtip
UD Drejtor
Prim. Dr. Marija Dimitrova

POLICIA NË GJAH EDHE PAS KËMBËSORËVE

TË PASIGURT EDHE NË VIJAT E BARDHA

Vitin e kaluar, në 80 aksidente komunikacioni në rajonin më të gjerë të Tetovës - pjesëmarrës kanë qenë këmbësorë. Dy nga këto aksidente kanë përfunduar me dy të vdekur, lëndime të rënda trupore kanë marrë 13 persona, ndërsa lëndime të karakterit më të lehtë kanë marrë 68 persona

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 17 maj - Qytetarët e Tetovës vazhdojnë të jenë të pasigurt sidomos kur duhet që të qarkullojnë nëpër rrugët e frekuentuara. Viktimë e këtyre aksidenteve shpeshherë janë edhe fëmijët, por nuk përjashtohen as më të rriturit. Rrugët më të rrezikshme janë bulevardi kryesor i Ilindanit, por edhe rruga Industriale, ku vetëm brenda një jave - në këtë rrugë janë aksidentuar katër këmbësorë, në mesin e tyre edhe një fëmijë. Sipas informatave, këmbësorët janë aksidentuar në vijat e bardha kur edhe ata kanë përparësi kalimi. Një nga prindërit e një fëmije të aksidentuar tregoi shkurt se fëmija i tij është aksidentuar në vijat ku janë të shënuara për këmbësorët dhe vetura ka ardhur me shpejtësi të madhe, por fatmirësisht - fëmija ka shpëtuar nga më e keqja dhe ka marrë vetëm lëndime të lehta. Si shkaqe më të shpeshta të këtyre aksidenteve ka qenë mospërshatja e shpejtësisë, por edhe kalimi i pakujdesshëm i rrugëve, parasëgjithash nga fëmijët, të cilët kalojnë në rrugë pa mbikëqyrjen dhe kujdesin e prindërve.

"Për të parandaluar dhe të mos përsëriten këto aksidente, të cilat në të shumtën e rasteve përfundojnë me lëndime të lehta dhe të rënda të këmbësorëve, Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë apelon deri tek prindërit që të mos i lënë të vetëm fëmijët e tyre që të lëvizin ose në mënyrë të pasigurt të kalojnë në rrugë, për arsye se pasojat mund që të jenë edhe më serioze, ndonjëherë edhe të pandreqshme për sigurinë e fëmijëve. Përveç kësaj, prindërit do të ballafaqohen edhe me sanksione për kundërvajtje dhe dënime varësisht rastit dhe pasojave", njoftojnë nga Policia e Tetovës. Në ndërkohë, jo rrallë herë edhe këmbësorët janë të pakujdesshëm. Duke nisur nga kjo situatë, Sektori për Punë të Brendshme njofton se ka ndërmarrë aksione kontrolluese për të dënuar edhe këmbësorët.

"Gjatë kontrollit në Tetovë, gjithsej janë ndaluar 25 këmbësorë, prej të cilëve janë zbuluar 17 kundërvajtje. Gjashtë këmbësorë kanë kaluar rrugën jashtë vendkalimeve të shenjzuara, pesë këmbësorë nuk e kanë respektuar sinjalizimin në trafik



dhe urdhrat e dhëna nga policët, pesë këmbësorë kanë lëvizur jashtë trotuareve ku, dy prej tyre janë ndaluar më gjatë në rrugë, dhe një tjetër ka kryer lloj tjetër të kundërvajtjes. Kundërvajtjet e kryera të tyre janë përmbledhur me 17 fletëpagesa për kundërvajtje, 14 thirrje për edukim trafik, dhe 2 paralajmërime me shkrim", njoftojnë nga Policia e Tetovës. Ndërkohë, aksione të këtilla janë realizuar edhe në Gostivar. "Numri i përgjithshëm i kundërvajtjeve të konstatuara gjatë aksionit në Gostivar është 12, ku po aq këmbësorë e kanë kaluar rrugën jashtë vendkalimeve për këmbësorë, dhe për këtë shkak, janë përgatitur fletëpagesa adekuate, si dhe 12 thirrje për edukim në trafik. Qëllimi i kontrollit dhe aksionit është që të kontribuojnë në rritjen e rendit dhe sigurisë në komunikacion në rrugët e Tetovës dhe të Gostivarit, duke përmendur se gjobat për këto lloje të kundërvajtjeve lëvizin prej 25 deri 45 euro në kundërvlerë të denarit", njoftuan nga policia e Tetovës.

Elmir Mustafai, eksperti i komunikacionit, thotë se duhet më shumë kujdes edhe nga ana e këmbësorëve, por edhe nga ana e vozitësve sidomos në periudhën që po vjen, kur

dihet që frekuentimi i këmbësorëve do të rritet në nivel më të lartë.

"Më shumë problem pritet të ketë gjatë verës, kur ka edhe lëvizje të madhe të qytetarëve nëpër rrugët e Tetovës, sidomos me automjete, ndërsa edhe këmbësorët duhet që të jenë më të kujdesshëm. Nuk duhet që rruga të kalohet në pjesën ku nuk ka shenja sinjalizimi për këmbësorë apo vija të bardha, sidomos nuk duhet të kalohet në ato rrugë ku ka frekuentim më të madh të veturave. Kujdes duhet të bëjnë edhe vozitësit që t'u japin përparësi këmbësorëve në këto raste, prandaj mendoj se fajin e kanë të dyja palët", thotë ai. Vitin e kaluar, në 80 aksidente komunikacioni në rajonin më të gjerë të Tetovës - pjesëmarrës kanë qenë këmbësorë. Dy nga këto aksidente kanë përfunduar me dy të vdekur, lëndime të rënda trupore kanë marrë 13 persona, ndërsa lëndime të karakterit më të lehtë kanë marrë 68 persona ose në krahasim me vitin paraprak, gjegjësisht me vitin 2016 - në këtë rajon numri i këmbësorëve të cilët kanë ndërruar jetë si pasojë e aksidentimit nga automjetet është zvogëluar për 2 për qind, përderisa numri i të lënduarve rëndë është përafërsisht në të njëjtin nivel sikurse në vitin 2016.

VAZHDOJNË KONTROLLET POLICORE NDAJ MOTOÇIKLISTËVE

Shoferë pa leje përkatëse për ngasje me motor, pa kaskë mbrojtëse, dhe shoferë me motorë të paregjistruar, janë kundërvajtjet më të shpeshta të shoferëve të motorëve nëpër rrugët e Tetovës. Në kontrollin e policisë në rajonin e Tetovës dhe Gostivarit gjithsej janë zbuluar 40 motoçikleta me regjistrim të skaduar deri në 30 ditë dhe mbi 30 ditë dhe 14 me polisë të pavazhduar të sigurimit, kundërvajtje për të cilën gjoja e parashikuar lëviz prej 100 deri në 500 euro në kundërvlerë të denarit. Në prill, gjithashtu, janë zbuluar edhe 76 motoçikleta të cilët kanë drejtuar motoçikletën pa dhënë provimin për shoferë dhe leje valide, si dhe 91 që nuk kanë përdorë kaskë mbrojtëse. Numri më i madh i këtyre kundërvajtjeve, më saktë 78 janë thirrur për lëksione trafik, ndërsa dy janë paralajmëruar me shkrim. Përndryshe, në suaza të edukimit të të rinjve, SPB Tetovë, ktë javë e ka përfunduar edhe pjesën e parë, gjegjësisht faza nga dy projektet parandaluese-edukative "Ngasje e sigurt me motoçikletë" dhe "Mos u ul në timon pa dhënë provimin e shoferit", bartës i të cilit është Reparti për parandalim të Sektorit për punë të brendshme Tetovë, në bashkëpunim me pushtetin lokal të Tetovës dhe Gostivarit. Në këtë fazë të projektit janë mbajtur ligjërata të veçanta me të cilat ishin përfshirë 119 paralele të cilat ndjekin mësim në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke me gjithsej 2.556 nxënës nga 13 shkolla të mesme nga rajoni i Pollogut.

KRONIKË

Kapet hajni nga Shqipëria duke vjedhur në xhami

Të mërkurën mbrëma, rreth orës 21.00, 28 vjeçari K.K. nga Tetova, ka paraqitur se dy orë më herët, në oborrin e xhamisë "Tabhane", e cila gjendet në rrugën "Mirçe Acev" në Tetovë, ka vërejtur një person të panjohur i cili është sjellë në mënyrë të dyshueshme. Pas kryerjes së kontrollit në kasafortën e xhamisë, e cila ka qenë e hapur, ka konstatuar se mungojnë paratë edhe atë diku prej 3000 deri 8000 denarë. Më vonë, personi është privuar nga liria është mbajtur në Stacion policorë, deri në zbardhjen e plotë të rastit, ku edhe do të shqiptohen padi adekuate. Bëhet fjalë për shtetasin e Republikës së Shqipërisë A.A. 24 vjeç nga qyteti i Librazhdit.

Gostivar, gjendet drogë në banesë

Të mërkurën rreth orës 17.00, pjesëtarë të policisë të Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë nga Stacioni policor në Gostivar, kanë kryer bastisje në banesë, në rrugën "Beliçica" në Gostivar, në të cilën me qira kanë banuar A.I. 31 vjeçar nga Shkupi dhe Z.R. 34 vjeçare nga Rostusha. Gjatë bastisjes, e cila është realizuar me urdhër të gjykatës, nga personi A.I janë gjetur dhe marrë me vërtetim, 2 qese najloni me kokainë, 1 qese najloni me marihuanë, një foli alumini, një masë e vogël e kokainës e derdhur në një tavolinë, pirun dhe lugë me mbetje të kokainës, 4 ziperqese me mbetje të kokainës dhe fletore në të cilën kanë qenë të regjistruara iniciale dhe shuma parash. Gjësendet e gjetura janë fotodokumentuar dhe do të kryhet ekspertizë, derisa A.I dhe Z.R. janë privuar nga liria dhe janë mbajtur në stacion deri në zbardhjen e plotë të rastit.

Aksident zhinxhiror te stacionit hekurudhor në Shkup

Një aksident rrugor zinxhiror të gjashtë automjeteve ndodhi sot paradite në rrugën "Nikolla Karev", para postës së stacionit hekurudhor në Shkup. Në aksident nuk ka të lënduar, megjithatë është shkaktuar dëm i madh material. Një prej pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë në aksident deklaroi për MIA-n se janë frikësuar shumë kur kanë parë si një automobil lëviz prapa drejt tyre. "Ajo ishte e tmerrshme, për momentin nuk dinim çfarë të bëjmë dhe si të reagojmë", theksoi gruaja e shqetësuar. Në të vërtetë shoferi i automobilit, i cili e ka shkaktuar aksidentin rrugor, i është përkeqësuar gjendja shëndetësore, pas çka papritmas e ka ndaluar automjetin, ka tentuar të dalë prej tij, por nuk i ka ngritur frenat e dorës dhe automobili ka ecur prapa. Policia ka kryer ekspertizë në vendin e ngjarjes.

Një shkupjan është mashtruar nga një mjek i rrejshëm

Një shkupjan dje rreth orës 13.00 në Kompleksin e Klinikave "Nënë Tereza" është mashtruar nga një kryerës i panjohur cili i është prezantuar si mjek dhe i është ofruar t'i ndihmojë bashkëshortes të tij të sëmurë për një kompensim të caktuar. Siç informon MPB, derisa B.V. (63) nga Shkupi ka pritur me bashkëshorten e tij në Repartin për Ortopedi, një person i panjohur i është prezantuar si mjek i punësuar në klinikë dhe ka filluar t'i sqarojë për sëmundjen e bashkëshortes së tij. Personi i ka ofruar se duhet t'u ndihmojë ta përshpejtojë procedurën për terapi, pas çfarë B.V. i ka marrë 12.000 denarë. Pasi i ka marrë paratë, personi më nuk është kthyer. Po ndërmerren masa për ndriçimin e rastit.

Rrahet 21-vjeçari në Çalje

Të mërkurën rreth orës 16.30 minuta, personi me iniciale T.T. 21-vjeçar nga Gostivari, ka paraqitur se duke lëvizur me motoçikletën e tij në rrugën prej fshatit Çegran në drejtim të Çajles, dy persona me motoçikletë, e kanë sulmuar dhe kanë filluar ta rrahin me boks hekuri, dhe me gjësende prej druri duke e rrahur në pjesën e kokës duke i shkaktuar edhe lëndime të dukshme trupore. Dy orë më vonë, në prezencë të prindërve të tyre, janë privuar nga liria dy minorenët e moshës nën 18-vjeçe nga Çegrani, për shkak të dyshimit të involvimit të mundshëm në sulmin ndaj T.T. Janë duke u marrë të gjitha masat dhe aktivitetet për zbardhjen e plotë të rastit dhe gjitha detajeve në veçanti. (U.H)

1. Kur më pyesnin gazetarët e huaj herët në vitet nëntëdhjetë për parashikimin se çka do të ndodhë, gjeja një shprehje që më nxirrte nga sikleti i fallxhiut: shpresoj të mos ketë luftë, se po pati, pos viktimave të shumta do të humbasim edhe nja 20 vjet derisa të vijmë në vete. Numri njëzet, ai i viteve që do të humbasim do të ketë dalë prej nënvetëdijes. Ndoshta pse më duken shumë, ndoshta pse janë shumë. Për cilëndo kategori janë shumë: për atë që i ka mbushur 20 janë tërë jeta, për dyzetvjeçarin gjysma, për gjashtëdhjetëvjeçarin një e treta, për tetëdhjetëvjeçarin çereku i jetës.

Mbase kështu, duke përmendur 20 vjetet që do të humbeshin ndjelja paqe, me efekt të njëjtë sikur kalimtarët e Sarajevës që kalonin nëpër "rrugën e snajperistëve" duke u mbuluar me xhakete e pulovër, si mburojë kundër plumbave. Çdo herë që shkoj në Sarajevë hyj në tramvaj dhe i vështroj fytyrat e njerëzve. Ato bartin brenda luftë që nuk kalon as pas njëzet vjetësh.

Një mik amerikan që ishte në Sarajevë dhe pastaj erdhi në Prishtinë më tha që fytyrat në Prishtinë janë më të gëzuara, ka më shumë rini. "Por edhe ju i kini punët lëmsh".

2. Fytyrat e gëzuara, ato të rinisë që i pa miku im amerikan, janë të njëzetvjeçarëve që nuk kanë pikë tjetër reference. Kanë jetuar tërë jetën në lëmshin e pasluftës dhe çdo vit është më i mirë se tjetri. Por, natyrisht, ky del të jetë rezultat nëse pika krahasuese është jeta jote e deridjeshme. Dr. Branko Horvat ma tërhoqi vërejtjen për këtë fenomen kur takohesha me të, në fund të viteve tetëdhjetë në Zagreb. Në Kosovë e gjithandej Jugosllavisë u bë i famshëm për librin e tij me të cilin i dekriminalizonte kërkesat shqiptare për avancim kushtetues, por në nivel botëror ishte i famshëm për shkak të kritikës së tij ndaj socializmit jugosllav. Ndonëse vetë ishte partizan dhe anëtar i PKJ-së prej moshës gjashtëmbëdhjetëvjeçare - apo ndoshta mu pse ishte i tillë - ai e kritikoi udhëheqjen e vendit për mungesë reformash ekonomike e administrative në momentin e duhur.

- Më 1965 ishte momenti i duhur, më tha. Kishin kaluar 20 vjet nga lufta, mjaftueshëm për ta konsoliduar vendin...

Se çfarë duhet të ishin reformat, ai ka shkruar libra, por me rëndësi për këtë shkrim është numri 20, ai i viteve që do kaluar për t'u konsoliduar pas luftës. Vitet pas atij 1965, dr. Horvat i konsideronte si ato të shansit të humbur.

3. Njëzet vjet pas Luftës së Dytë Botërore u lind Komisioni i komuniteteve evropiane. Sot njihet si Komisioni Evropian. U themelua më 1965, pasi traktatin për këtë e ratifikuan Franca dhe Gjermania, dy shtetet

Njëzet vjet



fqinje që njëzet vjet më parë kishin përfunduar luftën e madhe të përgjakshme, njëren prej luftërave rituale që ndodhnin mes tyre, duke marrë me vete jetët e miliona njerëzve.

Komisioni i komuniteteve evropiane që vazhdimësi logjike e një koncepti të filluar me bashkëpunim institucional në fushën e çelikut dhe qymyrit. Koncepti i qymyrit dhe i çelikut filloi 8 vjet pas luftës. Njerëz të mençur në Gjermani, Francë dhe posaçërisht në Amerikë, të mbledhur rreth administratës së presidentit

Truman e sekretarit të shtetit Marshall, vlerësuan se nuk mund të prisnin 20 vjet që gjërat të rehatoheshin në Evropën e shkatërruar. Dhe se nuk kishin as kohë e as para për të mbajtur me ndihma atë territor të madh, të shkatërruar e të uritur të quajtur Evropë.

Vendosën se pos komunitetit të qymyrit e çelikut kishin nevojë për komunitet tjetër, atë të kohës, një resurs të pakthyeshëm. Ashtu siç nuk mund të linin pa shfrytëzuar qymyrin e çelikut për nevoja të rindërtimit të përbashkët industrial, ashtu

Ndoshta pa u mbushur njëzetvjetori do të ishte mirë të thuhej, kolektivisht, mjaft më me këtë vjedhje industriale të resursit më të madh e të pakthyeshëm, kohë



nuk mund të linin pa e shfrytëzuar kohën.

4. Vitin e ardhshëm Kosova do të mbushë 20 vjet nga fundi i luftës. Tri funksionet bazike të shtetit bashkëkohor evropian, të "shtetit social" apo "welfare state"; arsimit, shëndetësisë dhe sigurisë sociale, janë në nivel të njëjtë cilësisë sikur menjëherë pas luftës - fazë imediate për ndihmë. Elitat politike të saj deri në njëzetvjetor, datën e "stabilizimit" të shoqërive të pasluftës, do të kenë shpenzuar tre miliardë euro dhe 7.300 ditë për asfalt dhe avancimin e interesave të tyre familjare dhe klanore.

5. Kur ta kalojnë njëzetvjeçarin e luftës qytetarët e Kosovës mund të pyeten se a ekziston diku ndonjë plan i zhvillimit afatgjatë të vendit?

Pyetja nuk do të jetë me rëndësi. Siç kishte konstatuar kaheerë ekonomisti John Maynard Keynes për planet afatgjata, ato edhe ashtu nuk çojnë kandar se "në afat të gjatë edhe ashtu që të gjithë do të jemi të vdekur".


Ndoshta pa u mbushur njëzetvjetori do të ishte mirë të thuhej, kolektivisht, mjaft më me këtë vjedhje industriale të resursit më të madh e të pakthyeshëm, kohës.

(koha.net)



Nga
Veton SURROI

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovrasja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 17 maj | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Për myslimanët besimtarë ka filluar muaji i agjërimit, Ramazani. Kësaj urdhërese i përmbahen gjithë e më shumë fëmijë. Për shkollat një problem gjithnjë e më serioz

RAMAZANI BËHET PROBLEM PËR SHKOLLAT NË GJERMANI



Agjërimi është një nga pesë shtyllat e fesë islame. Me disa përjashtime të vogla, agjërimi vlen për të gjithë myslimanët që kanë arritur përafërsisht moshën 14 vjeçare, mosha e zgjedhjes së një konfesionit fetar. Por gjithmonë e më shumë nxënës të shkollave fillore mbajnë Ramazan, megjithëse feja nuk i detyron. Ata duan të ndjekin shembullin e më të rriturve dhe të fitojnë adhurimin e prindërve, siç thonë drejtorët e shkollave. Si pasojë, fëmijët ankohen për dhimbje koke, pëzierje, ata kanë probleme përqendrimit dhe kanë rezultate më të dobëta në shkolla.

PRESION NGA PRINDËRIT MYSLIMANË

Në përgjithësi Shoqata Gjermane e Mësuesve e konsideron problematik agjërimit në shkolla. "Ndërkohë ka shumë nxënës që e marrin shumë seriozisht agjërimit", ka thënë presidenti i shoqatës, Heinz-Peter Meidinger, për edicionin online të gazetës "Die Welt". Në të gjitha shkollat që kanë një numër të madh nxënësish me origjinë migrimi, sjellja gjatë

muajit të agjërimit është kthyer në temë qendrore dhe në një problem.

Sipas tij, prindërit myslimanë ushtrojnë presion të madh te drejtorët e shkollave që në këtë periudhë të mos ketë provime ose ekskursione. Situata është problematike sidomos kur, për të respektuar besimin e disa individëve, limitohen të gjithë nxënësit e

tjerë. "Kjo ka si çmim që provimet e të gjithë nxënësve të përqendrohen në një periudhë të shkurtër. E kjo nuk shkon", ka theksuar Meidinger.

NË PRAG TË PROVIMEVE TË MATURËS

Këtë vit gjendja është veçanërisht problematike. Pas festës së krishterë të Rrëshajave që kremtohet pas disa ditësh, nxënësit në Gjermani do të përballen me një numër të madh provimesh. Maturantët kanë kryesisht provime, disa prej të cilave janë me shkrim, por pjesa më e madhe është me gojë. Por ata nuk mund të rrinë pa provime për javë të tëra. Për nxënësit që agjërojnë është tepër e vështirë - sidomos për ata që e marrin aq seriozisht Ramazanin, sa që gjatë ditës as nuk pinë. "Ka herë pas here nxënës

manë do të përballen me një numër të madh provimesh. Maturantët kanë kryesisht provime, disa prej të cilave janë me shkrim, por pjesa më e madhe është me gojë. Por ata nuk mund të rrinë pa provime për javë të tëra. Për nxënësit që agjërojnë është tepër e vështirë - sidomos për ata që e marrin aq seriozisht Ramazanin, sa që gjatë ditës as nuk pinë. "Ka herë pas here nxënës

që thjesht humbin ndjenjat", thotë Meidinger.

I ngarkuari i grupit parlamentar CDU/CSU për kishat dhe bashkësitë fetare, Hermann Gröhe, ka kërkuar një diskutim më ofensiv për këtë temë. "Sidomos te fëmijët e fillores duhet të kenë prioritet gjithmonë shëndeti dhe aftësia nxënëse", i ka thënë Gröhe gazetës "Die Welt". Presioni me motive fetare duhet të luftohet sikurse edhe përcmimi ndaj urdhëresave fetare. Ai shtoi se në lidhje me këtë temë pret prononcim të qartë nga shoqatat myslimane. Shoqata Arsim dhe Edukim (VBE) ka apeluar te vetëdija përgjegjëse e prindërve myslimanë. Shoqata e Peditërve u ka bërë thirrje prindërve që të mos i lënë fëmijët të agjërojnë. Në aspektin mjekësor agjërimit për fëmijë dhe të rinj është "i pashëndetshëm dhe i dëmshëm, sidomos mospirja e lëngjeve".

Gjatë muajit të Ramazanit, nga agimi e deri në mbrëmje, myslimanëve u ndalohet ngrënia, pirja e lëngjeve, pirja e duhanit dhe akti seksual. Me "Iftarin", darkën e përbashkët, merr fund edhe agjërimit ditor. Muaji i Ramazanit përfundon më 14 qershor.



Samosa i ngjan byrekut në formë trekëndëshi dhe mund të gjendet pothuajse në çdo rrugë të kryeqytetit Islamabad

SAMOSA, ushqimi i domosdoshëm në sofrat e iftarit në Pakistan

Samosa, një nga ushqimet tradicionale të rrugës në Pakistan, përbën një nga ushqimet më të preferuara me ardhjen e muajit të Ramazanit. Samosa i ngjan byrekut në formë trekëndëshi dhe mund të gjendet pothuajse në çdo rrugë të kryeqytetit Islamabad.

Ajo përgatitet duke e mbushur me mish të bluar ose patate,

ndërsa më pas skuqet. Samosa përbën një nga ushqimet e domosdoshme në Ramazan. Muhammed Rijaz, i cili përgatit samosa në një tezgë mobile, për Anadolu Agency (AA) thotë se normalisht, në ditë arrin të shesë 1.500-2.000 samosa, por ky numër rritet në mbi 3.000 gjatë Ramazanit.

"Personat që duan të hanë samosa të ngrohta në iftar, nxitojnë

drejt shitësve", thekson Rijaz, duke shtuar se gjatë këtij muaji ai bën shitje nga iftari e deri në syfy. Në Pakistan, pas hapjes së iftarit falet namazi i akshamit, kurse ushqimi hahet më pas, thotë Rijaz, sipas të cilit, pakistanezët zakonisht hapin iftarin me samosa. Në vend të ushqimeve, në iftaret dhe syfyret në Pakistan parapëlqehet samosa, qofte me

perime të quajtura pakora, si dhe pije si lëngu i trëndafilave. Ndërkaq, kur përmenden gjellat kryesore, gjëja e parë që bie në mend janë biriani dhe karahi, ushqime të përgatitura në forma dhe me erëza të veçanta të Pakistanit.

Supozohet se samosa daton që nga vitet 500 para erës sonë. Të dhënat historike tregojnë se sa-

mosa ka qenë një nga ushqimet e preferuara edhe të perandorëve persianë. Samosa, e cila konsumohet gjerësisht në vendet e Azisë Jugore, është përhapur edhe në pjesë të tjera të botës. Në Kenia, ky ushqim konsumohet së bashku me çajin dhe quhet "sambussa". Samosa përgatitet me peta brumi të mbushura me mish të bluar ose patate, duke u skuqur në vaj.

INTERVISTË ME OMBUDSMANIN E MAQEDONISË, IXHET MEMETI

NUK KA MIRËNJOHJE MË TË MADHE SE BESIMI I QYTETARËVE

Formula për rritjen e besimit është e thjeshtë: punoni në mënyrë të paanshme, manifestoni shkallë të lartë të profesionalizmit, luftoni, shfrytëzoni të gjitha instrumentet të cilat ju janë dhënë dhe bindini institucionet t'i respektojnë dhe zbatojnë rregullat të cilat qytetarëve ua garantojnë të drejtat. Kur thuhet kështu, tingëllon shkëlqyeshëm edhe pse për fat të keq në praktikë, zbatimi i kësaj formule nuk është edhe aq i lehtë për shkak se edhe pas 20 vitesh ende ka organe dhe institucione të cilat thjeshtë nuk e dinë se çka është Avokati i Popullit..., thotë në këtë intervistë Avokati i Popullit, Ixhet Memeti



Koha Bisedoi: Omer XHAFERI

KOHA: Fillimisht Ju urojmë përvjetorin e 20 të themelimit të Zyrës së Avokatit të Popullit në Maqedoni dhe Ju dëshirojmë shumë fat dhe sukses në punën e mëtutjeshme!

MEMETI: Ju falënderoj për urimet. Do të doja ta shfrytëzoj këtë intervistë që ta falënderoj jo vetëm median tuaj, por edhe të gjitha mediat e tjera të cilat gjatë dy dekadave të kaluara kanë qenë aleatë të mëdhenj në promovimin dhe etablimin e Institucionit. Unë vazhdimisht e përsëris se mediat janë aleati më i madh i Avokatit të Popullit. Ata janë porta përmes së cilës kalojnë informacionet, dhe përmes së cilave qytetarët informohen për atë se kush është Avokati i Popullit, cili është mandati i tij dhe si mund t'u ndihmojë. Shpresoj se ky bashkëpunim të vazhdojë edhe më tutje, madje me intensitet akoma më të madh.

KOHA: Dy dekada më vonë Ombudsmani i Maqedonisë, zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin e jetës shoqërore në vend dhe si i tillë, ai ka arritur të bëhet një derë e shpresës për shumë qytetarët, liritë dhe të drejtat e të cilëve shpeshherë nuk respektohen. Si ishte rrugëtimi dhe ndërtimi i Ombudsmanit në Maqedoni gjatë 20 viteve të kaluara?

MEMETI: Do të përpiqem t'i përgjigjem pyetjes tuaj, edhe pse e pranoj se është e vështirë që me disa fjalë të përshkruhet ajo që është ndërtuar gjatë dy dekadave. Duke e pasur parasysh faktin se unë jam Ombudsmani i dytë, para meje këtë funksione ushtronte z.

Branko Naumoski, kështu që pyetjes do t'i përgjigjem nga perspektiva ime, edhe pse konsideroj se edhe paraardhësi im do të dakordohej me konstatimin se themelimi i institucionit, fillimet e tij nuk ishin të lehta. Kur e them këtë, e kam parasysh faktin se Institucioni Avokat i Popullit është përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1991, megjithatë, Ligji për Avokatin e Popullit është miratuar në vitin 1997. Kjo tregon se, në njëfarë mënyre, nuk ka pasur sens për rëndësinë e ekzistimit të një trupi të pavarur, puna primare e të cilit është mbrojtja e të drejtave të qytetarëve. Prandaj, nuk guxojmë ta harrojmë faktin se Institucioni u ngrit paralelisht me tranzicionin, përmes së cilit kalonte shoqëria me ndryshimin e sistemit dhe të gjitha pasojat të cilat i barte me vete ky ndryshim. Të jesh i pari në diçka, ose të thyhet akulli, është vërtetë shumë e vështirë. Në parim, asnjë pushtet nuk dëshiron të ketë një mekanizëm kontrollues i cili do ta monitoroj punën e tij, punën e administratës, mekanizëm i cili do të reagoj në mënyrë të paanshme çdoherë kur do të konstatoj se shkelen rregullat në llogari të të drejtave të qytetarëve. Megjithatë, nëse merren parasysh të dhënat se ku ka qenë Institucioni në fillim dhe ku është tani, konsideroj se është bërë shumë punë që ai sot të jetë instrument emblematik i qytetarëve në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Besimi i tyre

gjatë viteve rritej vazhdimisht e që është tregues i vetëm për atë se a kemi qenë në rrugën e duhur. Zhvillimin e Institucionit do ta ndaja në dy periudha kohore: Periudha e parë - Fillimi dhe Periudha e dytë - Zhvillimi.

Periudha e parë është koha kur themelohej Institucioni, kur eki-pojeh me kuadër dhe kur bëhe-shin përpjekje ta gjente vendin e tij në shoqëri. Jam plotësisht i sigurt se një gjë e këtillë nuk ka qenë fare e lehtë, për shkak se edhe sot, pas 20 vjetësh, nga ana e institucioneve të caktuara akoma përballemi me problemin e terminit se çka do të thotë Ombudsman, kështu që mund ta merrni me mend se si ka qenë situata në fillim kur, nga ana e institucioneve të caktuara, shumë pak është ditur se kush është Avokati i Popullit. Dhe jo vetëm kaq. Problemet me pavarësinë financiare dhe kapacitetet kadrovike edhe sot e kësaj dite janë problem i madh që ndikon në kryerjen e funksionit. Unë vazhdimisht e përsëris se Avokati i Popullit nuk ka pas vete një instrument të detyrueshëm me ndihmën e të cilit do t'i zbatoj vendimet e tij. Fuqia e tij qëndron në fuqinë e bindjes së organeve se në mënyrë të gabuar e kanë zbatuar ndonjë rregull edhe atë në dem të të drejtave të qytetarit. Gjithashtu, në një shoqëri në tranzicion dhe me nivel të ulët të demokracisë duhet ta pranonim se bindja është e vështirë.

Sa i përket fazës së dytë të zh-

villimit, do të them se ajo është shumë dinamike dhe bart me vete ndryshime të mëdha edhe në strukturim edhe në funksionim. Në këtë periudhë janë bërë ndryshime të mëdha, para së gjithash, me decentralizimin e Institucionit përmes hapjes së gjashtë zyrave rajonale, me çka Ombudsmani u afrua akoma më pranë qytetarëve. Në këtë periudhë e morëm mandatin për ndjekjen e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të bashkësive në institucione. Konsideroj se kjo kompetencë nuk i është dhënë rastësisht Ombudsmanit, por se ky është rezultat se ai në mënyrë të paanshme, pa bërë politikë, do të ofroj një pasqyrë reale për gjendjen me përfaqësimin e të gjitha bashkësive. Gjithashtu, është me rëndësi edhe marrja e mundësisë për mbrojtjen nga diskriminimi, e cila në shoqëri multietnike, siç është e jona, padyshim se është i pranishëm. Po ashtu, duke i ndjekur ndryshimet në shoqëri e morëm rolin e parandalimit të torturës që përmes fitimit të mandatit të veprimtari si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN) me çka na u dha mundësia për preventim, por edhe për mbrojtjen e një kategorie vulnerable, siç janë personat të cilëve u është kufizuar lëvizja, dhe të cilët pikërisht për këtë ekspozohen në rrezik të madh të jenë viktime të torturës dhe llojeve tjera të trajtimit jonjerëzor.

Ndryshime të rëndësishme

janë bërë në vitet e fundit kur e morëm mandatin për promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, mundësinë të veprimtari si "Mik i gjykatës" dhe ndryshimet e fundit me të cilat Avokati i Popullit, bashkë me sektorin joqeveritar, e mori mandatin për kontrollin mbi punën e policisë dhe policisë së burgjeve. Në praktikë, kjo do të thotë se mund të ndërmarrim veprime dhe masa për sigurimin e mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave, interesave të drejtave të tyre në të gjitha procedurat të cilat zhvillohen kundër personave me autorizime policore, si dhe pjesëtarët e policisë së burgjeve për vepra penale gjatë kryerjes së shërbimit të tyre. Në pika të shkurtra, këto janë karakteristikat e zhvillimit të Institucionit gjatë 20 viteve të kaluara.

KOHA: Shumë institucione në vend edhe pse thuhet se faza e tranzicionit në Maqedoni ka kaluar, të njëjtat edhe më tutje përballen me një shkallë të ulët të besueshmërisë nga ana e qytetarëve. Në këtë drejtim, na tregoni se cila është formula të cilën Avokati i Popullit e përdori gjatë këtyre 20 vitesh dhe e cila ndikoi që një numër i mirë i qytetarëve t'u drejtohen juve për zgjidhjen e halleve dhe problemeve kundrejt institucioneve tjera?

MEMETI: Formula është e thjeshtë, punoni në mënyrë të paanshme, manifestoni shkallë të lartë të profesionalizmit, luftoni, shfrytëzoni të gjitha instrumentet të cilat ju janë dhënë dhe bindini institucionet t'i respektojnë dhe zbatojnë rregullat të cilat qytetarëve ua garantojnë të drejtat. Kur thuhet kështu, tingëllon shkëlqyeshëm edhe pse për fat të keq në praktikë, zbatimi i kësaj formule nuk është edhe aq i lehtë për shkak se edhe pas 20 vitesh ende ka organe dhe institucione të cilat thjeshtë nuk e dinë se çka është Avokati i Popullit. Tanimë e përmenda se në shoqëritë në tranzicion bindja është shumë e vështirë, e ngadalë, por nuk mund të heqim dorë nga kjo, për faktin se çdo qytetar, pavarësisht se cilës bashkësi, fe, gjeni, racë i përket, meriton respektimin e të drejtave të tij. Nuk ka mirënjohje më të madhe për një ombudsman sesa niveli i lartë i besimit nga qytetarët, veçanërisht në kushte të tranzicionit dhe krizës politike, të cilat ishin karakteristike

Koha, e premte 18 maj, 2018

gjatë viteve të kaluara. Në të vërtetë, Institucioni ekziston për qytetarët. Në një farë mënyre ne i përfaqësojmë ata dhe së këtejmi lind edhe emërtimi "Avokat i Qytetarëve". Ndërtimi i besimit të ndërsjellë me qytetarët është motiv i madh për punë, për arritjen e suksesit në drejtim të etablimit akoma më të madh të Institucionit në shoqëri.

KOHA: Ndër vërejtjet më të shpeshta të opinionit ndaj Ombudsmanit janë se ai nuk vepron në kohë për parashtrësia e tyre, gjegjësisht qëndrimi i juaj çdoherë ka qenë se mungesa e kuadrit dhe financave paraqet pengesa kryesor për shqyrtimin e të gjitha ankesave. Vallë edhe pas 20 viteve zyra e Avokatit të Popullit në Maqedoni ka mungesë kadrovike dhe në çfarë mënyrë i mbulonit kërkesat e shumta për shkeljet e ndryshme të lirive dhe të drejtave të njeriut?

MEMETI: Qëndrimi im, sa i përket kësaj pyetje, nuk ka ndryshuar ende, edhe pse, të jemi real dhe objektiv, buxheti i fundit është buxheti më i mirë të cilin deri më tani, e ka marrë ky Institucion. Gjatë krijimit të tij u respektuan të gjitha ndryshimet ligjore sa i përket konsultimeve me Avokatin e Popullit, para se i njëjti të votohet në Parlament. Kjo është një lëvizje, e cila duhet përshëndetur dhe e cila jep shpresë që në një të ardhme do të arrijmë deri në nivelin e pavarësisë së mirëfilltë financiare, e cila është faktor kryesor në kryerjen e punës sonë. Në të vërtetë, edhe vet definicioni "trup i pavarur rregullator" para së gjithash e nënkupton pavarësinë financiare.

Sa i përket ekipimit kadrovik, edhe këtu kemi shumë punë për të bërë, duke e pasur parasysh faktin se me ndryshimet e fundit ligjore morëm mandate të reja, të cilat pa kuadër thjeshtë nuk mund të realizohen. Pikërisht përmes zgjidhjes së kësaj çështjeje do të shihet nëse autoritetet me të vërtetë dëshirojnë mekanizëm të fuqishëm për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, apo bëhet fjalë vetëm për angazhime deklarative, me qëllim të plotësimit të detyrave të dhëna nga Bashkimi Evropian. Si përfundim, nëse mandatet e dhëna nuk jetësohen në praktikë një gjë e këtillë do të ndikoj direkt në dëm të qytetarëve. Për shembull, nëse Ombudsmani nuk fillon ta kryej kontrollin mbi punën e policisë, qytetarët edhe më tej do të jenë në rrezik lidhur me përballjen me brutalitetin policor, ndërsa mosndëshkimi do të vazhdojë qëndrojnë në raportet e BE-së, si një problem i madh i shtetit. E them këtë për shkak se problemet, të cilët janë konstatuar ndër vite, duhet të zgjidhen doemos. Shteti ligjor nuk ndërtohet nëpër kabinetet ministrore, por në realitet, përmes mundësisë të qytetarëve të ndëjnë se ligjet zbatohen/vlejnë njësoj për të gjithë.



KOHA: Ky është mandati i dytë të cilën ju e ushtroni si Ombudsmani i Maqedoni. Përgjatë kohës sa jeni në këtë pozitë, cilat kanë qenë peripecitë me të cilët jeni ballafaquar dhe cilën periudhë të mandatit të juaj do të veçoni si më të rëndën?

MEMETI: Më duhet të pranoj se gjatë këtyre 14 vjetëve, aq sa jam në këtë funksion, ka pasur situata dhe peripeci të ndryshme përmes të cilave kam kaluar. Nuk është e lehtë të jesh Ombudsman. Pse e them këtë? Për shkak se edhe unë, por edhe të punësuarit e mi, për çdo ditë ballafaqohemi me fate të ndryshme të njerëzve, të cilat padyshim se ndikojnë mbi ne. Domethënë, për çdo ditë ballafaqohemi me histori jetësore të cilat duhet t'i zgjidhim. Problemet e palëve, në njëfarë mënyrë, i bartim edhe në shtëpi. Dhe, çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë se në të vërtetë, ju nuk jeni Ombudsman vetëm gjatë tetë orëve të punës. Shpeshherë, kam menduar dhe jam përpjekur të vihem në pozitën e atyre të cilët drejtohen për ndihmë dhe më duhet të pranoj se me të vërtetë e kam pasur vështirë, dhe nuk jam ndier mirë, sepse padrejtësia dhemb



Nuk është e lehtë të jesh Ombudsman. Pse e them këtë? Për shkak se edhe unë, por edhe të punësuarit e mi, për çdo ditë ballafaqohemi me fate të ndryshme të njerëzve, të cilat padyshim se ndikojnë mbi ne. Domethënë, për çdo ditë ballafaqohemi me histori jetësore të cilat duhet t'i zgjidhim. Problemet e palëve, në njëfarë mënyrë, i bartim edhe në shtëpi. Dhe, çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë se në të vërtetë, ju nuk jeni Ombudsman vetëm gjatë tetë orëve të punës. Shpeshherë, kam menduar dhe jam përpjekur të vihem në pozitën e atyre të cilët drejtohen për ndihmë dhe më duhet të pranoj se me të vërtetë e kam pasur vështirë, dhe nuk jam ndier mirë, sepse padrejtësia dhemb

mend rizgjedhjen time, e cila më ndjek edhe sot e kësaj dite. Unë, disa herë, kam thënë se më rëndon kjo ngjarje. Ndoshta pikërisht ky ishte momenti më i vështirë i imi, të cilin e kam përjetuar dhe që më ka shkakuar dhe ende edhe më tutje i vuaj kritikën, por personalisht konsideroj se nuk gabova kur e pranova edhe mandatin e dytë. Dëshmi për këtë është se besimi i qytetarëve nuk ka rënë për asnjë moment, por edhe Raporti i njohur i Pribe-s, i cili e dha notën më të lartë për punën e Institucionit të cilin e udhëheq.

KOHA: Gjatë prezantimit të Raportit të fundit të Ombudsmanit theksuar se, që nga viti i kaluar është përmirësuar komunikimi i institucioneve shtetërore me kërkesat e Avokatit të Popullit. Në çfarë menduar konkretisht kur deklaruat një gjë të tillë, ose cilët janë ato institucione që ngurrojnë të përgjigjen në kërkesat Tuaja?

MEMETI: Për fat të keq, ja edhe pas dy dekadash, ne ende flasim për mosbashkëpunimin e institucioneve me Ombudsmanin, çështje e cila duhet të ishte tejkaluar deri më tani. Si shembull, për mosbashkëpunim do ta theksoja sjelljen e prokurorisë publike e cila në vazhdimësi i injoron kallëzimet të cilat i paraqesim, edhe pse të njëjtat mbështeten mbi prova të forta. Në raportin me këtë organ kishte edhe situata (bëhet fjalë për lëndën kur punonim në lëndën me përgjimet e paligjshme) kur morëm përgjigje se të gjitha informacionet janë publikuar në uebfaqen e tyre dhe se mund t'i shfrytëzojmë të njëjtat. Për fat të keq, ky institucion nuk është i vetmi që ka sjellje të këtillë ndaj Avokatit të Popullit. Si shembull për mosbashkëpunim do ta theksoja edhe Radio Televizionin e Maqedonisë, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, të Punëve të Brendshme, dhe NP "Pyjet e Maqedonisë".

Por, të mos duket se vetëm kritikoj, me këtë rast do të doja të theksoj se dalëngadalë po fillojmë ta tejkalojmë problemin kryesor i cili zvarritej vite me radhë dhe ai është respektimi i rekomandimeve të përgjithshme të dhëna në Raportet vjetore të Avokatit të Popullit, përmes miratimit të masave nga ana e Parlamentit, me të cilat pushteti ekzekutiv angazhohet të

veproj dhe pas gjashtë muajsh të njoftoj se deri ku ka arritur implementimi. Ky është një ndryshim i rëndësishëm i cili shpresojmë se në vitet e ardhshme do t'i jep rezultatat e pritura, përmirësimin e sistemit, ligje të zbatueshme, administratë profesionale.

KOHA: Mund të na thoni shkurt se, cili dikaster i pushtetit nuk respekton të drejtat dhe liritë e njeriut, ose i shkelë më së shumti ato?

MEMETI: Vite me radhë, në raporte në vend të parë janë ankesat e qytetarëve, të cilat kanë të bëjnë me punën e gjyqësorit, policisë, ndërsa viteve të fundit edhe të punës së përmbartuesve dhe disa ndërmarrjeve publike. Konsideroj se pikërisht këto të dhëna ishin shkak për marrjen e mandatit të ri "Mik i gjykatës", me të cilin na u dha mundësia të marrim pjesë në seancat gjyqësore dhe të japim propozime dhe mendime, të cilat gjykata duhet t'i merr parasysh. Dua të theksoj se, tani për tani, me vështirësi të mëdha e realizojmë këtë mandat, jemi pritur keq nga ana e gjykatësve të caktuar, megjithatë mendoj se së shpejti do të tejkalohen këto probleme. Kur e them këtë, dua të them se çdo fillim është i vështirë.

Sa i përket mandatit për kontroll të jashtëm të policisë, ai në një të ardhme të shpejt duhet të fillojë të funksionoj. Konsideroj se të gjithë ata që do të marrin pjesë dhe që do ta zbatojnë këtë mandat, do t'i qasen me seriozitet dhe profesionalizëm të madhe, sepse vetëm në këtë mënyrë do të kemi polici me profesionalizëm të lartë, e cila do të punoj nga pozita e mbrojtësit të qytetarëve.

Në rrjedhë e sipër janë ndryshimet e Ligjit për përmbartim dhe unë sinjersht shpresoj se do të merren parasysh vërejtjet tona, të cilat burojnë nga praktika, më saktësisht nga ankesat e qytetarëve. Përkatesisht, se do të tejkalohet problemi i procedurës së përmbartimit që ata të mbeten pa mjete themelore ekzistenciale.

KOHA: Keni theksuar se shumë institucioni, edhe pse paraprakisht kanë pranuar vërejtjet e Ombudsmanit, të njëjtat nuk i kanë përmirësuar "gabimet". Në këto raste, cili është roli dhe puna e Ombudsmanit?

MEMETI: Roli kryesor i Ombudsmanit është të jetë korrektor i pushtetit, që do të thotë vazhdimisht ta përkujtoj për dobësitë dhe të cilat do t'i përcaktoj përmes punës së tij. Për fat të keq, tek ne kritikën që i drejton, nuk kuptohen si mirëdashëse prandaj dhe këtu qëndron problemi kryesor në të cilin duhet të punohet. Përdorimi i kritikës e adresuara kuptohen personalisht, dhe jo si një përpjekje për përmirësimin e gjendjeve, në emër dhe në llogari të qytetarëve, do të ketë pyetje të këtij lloji "cili është roli i Ombudsmanit".



PRITJET NGA SAMITI I SOFJES

BE NUK KA NXITIM PËR ZGJERIM

Presidenti i Këshillit Evropian Donald Tusk ka thënë në Sofje së zhvillimi i këtij samiti pas 15 vjetëve, sa kanë kaluar nga Samiti i Selanikut në vitin 2003, është rast për të konfirmuar perspektivën Evropiane të rajonit dhe se kjo perspektivë është një zgjidhje strategjike e Ballkanit Perëndimor



Liderët e 27 shteteve të BE-së dhe të rajonit të Ballkanit perëndimor, që quhen "partner" janë duke zhvilluar takimin e tyre të përbashkët në Kryeqytetin e Bullgarisë. Nuk mungoi në samit shefja e qeverisë britanike, sepse kur përmbledën 27 e jo 28 kryesisht mendohet për këtë shtet i cili është në procedurë të daljes nga anëtarësia në BE, por në Kryeministrin e Spanjës Mariano Rajoy, i cili për shkak të pjesëmarrjes së Kosovës në samit, ka vendosur të mos merr pjesë, raportin i dërguar special i Grupit KOHA, Augustin Palokaj.

Spanja në takim përfaqësohet nga ambasadori në BE, që është nivel jashtëzakonisht i ulët, ndërsa në drekën e përbashkët as ambasadori nuk do të jetë i pranishëm.

Në hapësirën ku po zhvillohet samiti nuk ka flamuj e as simbole shtetërore, që ka qenë pjesë e protokollit për të adresuar shqetësimet e vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën dhe si pasojë është vendosur që asnjë shtet të mos paraqitet me flamuj dhe simbole shtetërore të tyre. Vetë fakti se ky është takimi i parë në nivel të tillë pas 15 vitesh për Bashkimin Evropian konsiderohet si sukses historik.

Me nismë të kryeministrit të Bullgarisë Bojko Borisov, e me mbështetje të Komisionit Evropian dhe Presidentit të Këshillit Evropian Donald Tusk, samiti i Sofjes nuk është kësaj radhe për zgjerimin e BE-së por më shumë për çështje si konektiviteti, zhvillimi digjital, migracioni, reformat dhe çështje tjera të ci-

lat duhet të avancohen në rajon në mënyrë që ai të afrohet me BE-në.

Pa zhvillimi ekonomik do të jetë vështirë që vendet e rajonit të Ballkanit të afrohen me BE-n dhe të bëhen të pranueshme për qytetarët e BE-së. Edhe vet Kryeministri i Bullgarisë Bojko Borisov në një konferencë në Sofje në prag të samitit ka përmendur si shembull se të gjitha gjashtë shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor së bashku nuk e kanë nivelin e Bruto Prodhimit të Brendshëm sa i ka Sllovakia vetëm.

RAST PËR TË KONFIRMUAR PERSPEKTIVËN EVROPIANE TË RAJONIT

Presidenti i Këshillit Evropian Donald Tusk ka thënë në Sofje së zhvillimi i këtij samiti pas 15 vjetëve, sa kanë kaluar nga Samiti i Selanikut në vitin 2003, është rast për të konfirmuar perspektivën Evropiane të rajonit dhe se kjo perspektivë është një zgjidhje strategjike e Ballkanit Perëndimor. Presidenti i Parlamentit Evropian Antonia Tajani ka thënë se pa përfshirjen e këtij rajoni në BE nuk do të mund të thuhet se Evropa është e bashkuar sepse vendet e Ballkanit Perëndimor në mënyrë të pashkëputshme janë të lidhura edhe gjeografikisht, edhe historikisht edhe kulturologjikisht me BE-në.

Se sa ka ngecur procesi i zgjerimit të BE-së dhe si ka kaluar ai në plan të dytë krahasuar me periudhën e para 15, vitesh ka përkujtuar në Sofje kryeministri i Kroacisë Andrej Plenković. Ai ka thënë se kur ishte zhvilluar samiti i Selanikut ishte ideja që takime të tilla të zh-

villohen çdo 3 vite por deri me tash nuk ka pasur asnjë të tillë prandaj edhe ky i sotëm në Sofje e ka rëndësinë e veçantë. Plenković ka aralajmëruar se Kroacia gjatë kryesimit të saj të BE-së në pjesën e parë të vitit 2020 do të zhvillojë një samit të tillë. Edhe ai ka bërë thirrje për BE-në që të jetë më i qartë rreth zgjerimit por edhe për vendet që kufizojnë me Ballkanin Perëndimor, e këtu është edhe Kroacia, të ngritin më shumë zërin në favor të vendeve të rajonit. Teksti i deklaratës së përbashkët e cila pritet të miratohet në këtë samit, së pari nga liderët e 28 shteteve anëtare e më pas të mbështetjet edhe nga "partnerët e Ballkanit Perëndimor" është dakorduar kohë më parë në Bruksel në takimet e përfaqësuesve të përhershëm të vendeve anëtare. "Ne, liderët Bashkimit Evropian dhe të shteteve të saja anëtare, në konsultim me partnerët tanë nga Ballkani Perëndimor, dhe në prani të pjesëtarëve relevantë rajonalë, sot kemi konkluduar si vijon: BE mirëpret përkushtimin e përbashkët të partnerëve nga Ballkani Perëndimor ndaj vlerave dhe parimeve evropiane dhe vizionit për një Evropë të fortë, stabile dhe të bashkuar, të përforcuar nga lidhjet tona historike, kulturore dhe gjeografike dhe nga interesat tona të përbashkëta politike, të sigurisë dhe ekonomike" pritet të thuhet në këtë deklaratë.

"Duke rikujtuar samitin e Selanikut të vitit 2003, BE ripërsërit mbështetjen e rezervë për perspektivën evropiane të Ballkanit perëndimorë. Duke ndërtuar mbi pro-

gresin e arritur deri me tash, partnerët nga Ballkani Perëndimorë kanë ripërsëritur përkushtimin për perspektivën evropiane si zgjidhje e tyre e prerë strategjike, për të përforcuar përpjekjet e tyre dhe mbështetjen e ndërsjellë. Kredibiliteti i këtyre përpjekjeve varet nga komunikimi i qartë publikë" thuhet më tej.

KUJDES ME ZGJERIMIN POROSITË PRESIDENTI I FRANCËS

Se Brenda BE-ë nuk ka ndonjë entuziazëm të madhë për të përshpejtuar procesin e zgjerimit e ka bërë të qartë në Sofje edhe Presidenti i Francës Emanuel Macron duke bërë ftesë që të kihet kujdes me procesin e zgjerimit dhe të protot që edhe vendet e rajonit të kryejn reformat por edhe BE të thellojë reformat e veta para se të mendojë të zgjerohet.

"Un jam për të lidhur Ballkanin Perëndimorë me Evropën. Me shumë kujdes dhe vëmendje duhet shikuar çdo zgjerim. Negociatat të cilat po zhvillohen duhet të vazhduar, duhet ndihmuar vendeve të cilat bëjnë reforma dhe avancojnë drejt BE-së, dhe kjo është edhe zgjedhja ime strategjike. Por nuk jam në favour të kësaj para se të kemi të gjitha garancitë dhe para reformave të cilat do të mundësonin thellimin dhe funksionimin më të mirë të Bashkimit Evropian në mënyrë që të shkohet më pas drejt zgjerimit" ka thënë Macron.

"Në 15 vitet e fundit është dëshmuar se ka qënë gabim që gjithmonë të mendohet në zgjerim. Nuk

do tu bëjmë shërbim as shteteve që janë candidate për anëtarësim e as vetvetes me mekanizma që nuk kanë rregulla dhe i cili shkon gjithmonë drejt zgjerimit. Un jam në favour që të rrisim dialogun strategjikë me Ballkanin perëndimorë, që ndjekim për së afërmi, reformat që po bëhen dhe i inkurajojmë, por pa lëshime dhe pa hipokrizi" ka thënë Presidenti i Francës.

Komisioneri i BE-së për fqinjësi dhe zgjerim Johannes Hahn ka thënë se në këtë samit është konfirmuar perspektiva Evropiane por poashtu edhe ajo që është thënë më parë, se procesi është i bazuar në meritat individuale dhe secili vend duhet ti kryej detyrat e shtëpisë.

Kancelarja Gjermane Angela Merkel ka thënë se është në interes të Evropës që Ballkani perëndimorë të zhvillohet ekonomikisht.

Kryeministria e Britanisë së madhe Theresa May ka thënë se synimi duhet të jetë që të ketë më shumë stabilitet, siguri dhe prosperitet në Ballkanin perëndimorë.

Kancelari i Austrisë Sebastian Kurz, vendi i të cilin do e merr pas një muaj e gjasmë kryesimin e BE-së, a përsëritur se qëllimi i tij është që të mbështesin vendet e rajonit në rrugën e tyre drejt BE-së. Ai në veçanti ka përmendur Serina dhe Malin e zi si më të përpatruar të këtë drejtim.

Presidenti i Parlamentit Evropian Antonia Tajani ka thënë se ai ka propozuar një fond prej 10 miliardë eurosh për investime në ndërtimin e infrastrukturës në rajonin e Ballkanit.

Gjatë samitit takime të rëndësishme kanë qënë edhe disa që janë bërë në margjinat e tij. Kështu një ditë para tij në Sofje janë takuar Presidentët e Kosovës dhe të Serbisë Hashim Thaci dhe Aleksandar Vučić për të shikuar mundësinë e vazhimit të dialogut dhe të arritjes së një marrëveshje gjithpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënjeve. Në BE pikërisht këto raporte i shohin si kyçe për paqen dhe stabilitetin afatgjatë në rajon.

Po ashtu është zhvilluar edhe takimi i Kryeministrave të Greqisë dhe Maqedonisë Trizipas dhe Zaev të cilët thuhet se i kanë përfunduar qëndrimet për një zgjidhje përfundimtare të çështjes së emrit.

Delawie: Gjykata Speciale do të akuzojë vetëm individë

Ambasadori amerikan, Greg Delawie në një intervistë dhënë për RTV Dukagjinin ka thënë se viti 2018 duhet të jetë vit i suksesit në dialog, të ecet para në raportet Kosovë-Serbi si dhe të përqendrohen në arritjen e një marrëveshjeje për-

fundimtare. Ambasadori Delawie në këtë intervistë ka folur për shumë çështje, duke përfshirë edhe Gjykatën Speciale.

"Jack Smith, një amerikan, është caktuar kryeprokuror special para një jave e ca. Mendoj se kjo

është pozitive dhe mendoj se kjo shpreh përkushtimin amerikan të vazhdueshëm për Gjykatën. Mendoj se është me rëndësi të kuptohet se Gjykata do të gjykojë individë të akuzuar për krime. Nuk do të gjykojë grupe etnike apo anë-

tarë të organizatave e ngjashëm. Mendoj se është shumë me rëndësi që Kosova ta mbajë zotimin e saj për ta ndihmuar Gjykatën Speciale për ta përbushur misionin e saj. Mendoj se duhet të punohet për këtë", thotë ai.



Vendimi i Presidentit Donald Trump për t'u tërhequr nga marrëveshja bërthamore me Iranin i vë Shtetet e Bashkuara në konflikt me disa prej aleatëve më të afërt europianë. Zoti Trump ka dhënë orientimin që të vihen sanksione maksimale ndaj kompanive që vazhdojnë të bëjnë biznes me Iranin, duke shkaktuar alarm, sidomos në Francë dhe në Gjermani, ku kompani si Airbus dhe Volkswagen kanë nënshkruar kontrata shumë miliardë dollarëshe me Teheranin.

IRANI PËRPLAS SHBA ME EUROPËN



pianët dhe për pjesën tjetër të botës, për t'u tërhequr nga kjo marrëveshje dhe për të rivendosur sanksione jo vetëm ndaj kompanive të tyre, por edhe jashtë territorit të tyre. Në këtë mënyrë ata vendosin për fatin e marrëveshjes me Iranin për të gjithë." - thotë Celia Belin, e Institutit "Brookings".

I pyetur nga Zëri i Amerikës, nëse ka për të patur një ngërç diplomatik lidhur me sanksionet ndaj Iranit, Këshilltari i Sigurisë Kombëtare i Presidentit Trump, John Bolton, tha se kjo nuk ka për të ndodhur:

"Unë mendoj se në mënyrë të pashmangshme, sapo të hyjnë në fuqi sanksionet, kanë për të patur ndikim në Europë. Mendoj, se edhe marrëdhëniet e tyre tregtare me Iranin kanë për t'u pakësuar dhe Irani do të gjendet para një zgjedhjeje të vështirë."

Zoti Bolton shtoi se përfitimet ekonomike të marrëveshjes me Iranin shpejt kanë për t'u pakësuar dhe se ekonomia iraniane tashmë po ndeshet me vështirësi, gjë që shkaktoi demonstrata në fund të vitit të kaluar.

Departamenti i Shtetit njoftoi se zoti Pompeo do të mbajë një fjalim të rëndësishëm për politikën e jashtme amerikane të hënën e ardhshme. Fokusi do të jetë Irani.

Vetëm disa orë pasi bëri betimin, Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo shkoi në selinë e NATO-së në Bruksel, ku ai theksoi se sa shumë e vlerësojnë Shtetet e Bashkuara marrëdhënien transatlantike, si një kolonë mbështetëse për sigurinë dhe stabilitetin botëror. Por kjo marrëdhënie kohët e fundit ka marrë një goditje, ndërsa SHBA thanë se do të vendosin sanksione ndaj çdo firme që bën biznes me Iranin, shkruan VOA. Kancelarja gjermane Angela Merkel komentoi të martën në Berlin lidhur me vendimin e javës së kaluar të Presidentit Donald Trump, për t'u tërhequr nga marrëveshja bërthamore me

Iranin: "Tani kemi një ndryshim në marrëdhëniet gjermano-amerikane, europiano-amerikane, në kushtet kur Britania e Madhe, Franca dhe Gjermania ishin të mendimit se marrëveshja kundër armatimeve bërthamore të Iranit, natyrisht që ka dobësitë e saj, por ajo është një marrëveshje së cilës ne duhet t'i qëndrojmë besnikë," - tha zonja Merkel. Ministri i Jashtëm i Iranit Javad Zarif, u takua të martën me homologët e tij europianë në Bruksel, për të diskutuar se si mund të ruhet marrëveshja bërthamore me Iranin. "Është në dorën e Bashkimit Europian dhe shteteve anëtare, për t'u siguruar që interesat e tyre dhe tonat të

mbrohen dhe që veprimi i paligjshëm i SHBA të mos shpërblehet," - tha Zarif.

Sekretari Pompeo thotë se marrëveshja bërthamore e ka pasuruar Iranin, duke sjellë një "akvitet të rrezikshëm"; ai shtoi se tërheqja e Shteteve të Bashkuara nuk synonte të prekte Europën. Por ekspertët thonë se europianët janë zemëruar me Shtetet e Bashkuara për rivendosjen e sanksioneve dhe mendojnë që alternativat e tyre janë të kufizuara. "Europianët ndjenë se kanë mbetur pa asnjë lloj zgjedhjeje, por gjithashtu që kjo administratë nuk ka ndonjë strategji - apo një plan B. Pra, në parim amerikanët vendosën për euro-



Britania nuk do ta zhvendosë ambasadën në Jerusalem

Sekretari britanik i Punëve të Jashtme, Boris Johnson, tha se Britania e Madhe nuk pranon zhvendosjen e ambasadës së SHBA-ve në Kuds, transmeton Anadolu Agency (AA).

Sipas lajmit të agjencisë zyrtare palestineze Wafa, presidenti i Palestinës, Mahmud Abbas dhe sekretari i Jashtëm i Britanisë së Madhe, Boris Johnson, kanë realizuar një bisedë telefonike. Duke theksuar se shteti i tij nuk pranon zhvendosjen e ambasadës së SHBA-ve, Johnson ka reaguar edhe për viktimat civile që humbën jetën në Gaza. Ai po ashtu theksoi se janë të gatshëm për të ndihmuar në arritjen e paqes.

Presidenti i Palestinës, Abbas, tha se është i kënaqur me qëndrimin e Britanisë së Madhe dhe ka shtuar se Palestina është për sigurimin e procesit të paqes e bazuar në legjitimitetin ndërkombëtar.

Abbas po ashtu ka ritheksuar se tanimë nuk mund të pranohet që SHBA-ja të jetë ndërmjetësues i vetëm në mes të Izraelit dhe Palestinës, pas largimit të dosjeve të Kudsit dhe të refugjatëve nga tryeza e negociatave. Ai tha se tani për ofrimin e paqes kërkojnë një mekanizëm ndërkombëtar. Ushtarët izraelitë vranë 62 palestinezë dhe plagosën të paktën 3.000 të tjerë të cilët morën pjesë në protestat e organizuara në kufirin e Gazës nën rrethim, me qëllim për të protestuar kundër hapjes së ambasadës së SHBA-ve në Kuds dhe për të përkujtuar 70 vjetorin e "Nakba"-s (Fatkeqësisë së Madhe).

Udhëheqësi i ri i Katalonias i vendosur për pavarësinë

Separatisti katalan Quim Torra u betua si kreu i ri i rajonit spanjoll, me kërkesat e tij për një Kataloni të pavarur. Torra zyrtarisht mori detyrën në një ceremoni në kryeqytetin katalan, Barcelonë, ku ai u zgjodh nga ligjvënësit separatistë të parlamentit katalanas. Në shenjë të tensionit të zjarrtë, qeveria e Spanjës në Madrid, e cila zakonisht dërgon një përfaqësues në ceremoninë e qeverisë rajonale, nuk pranoi të merrte pjesë në betim.

Ceremonia e së enjtës ishte me



sinjale të theksuara që duket se kishin për qëllim autoritetet qendro-

re spanjolle. Torra kishte vetëm flamurin e kuq dhe të verdhë prapa tij

gjatë ceremonisë, ndërsa, flamuri spanjoll mungonte.

Gjithashtu, në betimin e tij ai premtoi se do të jetë besnik ndaj popullit të Katalonjës, duke mos bërë me dije respektin e tij ndaj Kushtetutës së Spanjës dhe as ndaj mbretit spanjoll.

Qeveria spanjolle thotë se nuk mund t'i jap pavarësinë Katalonjës, sepse në kushtetutën e Spanjës thuhet se ajo pjesë është "e pandashme". Mbreti Felipe VI ka mbështetur publikisht qëndrimin e qeverisë spanjolle.



Erogan: OKB ka kolapsuar në Rripin e Gazës

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan tha se Kombet e Bashkuara kanë kolapsuar para brutalitetit të shprehur në Rripin e Gazës nga Izraeli.

"Kombet e Bashkuara kanë përfunduar, kanë kolapsuar. Në këtë moment kjo i shkon sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara pavarësisht miqësisë

të mirë që kam me të", tha Erdoğan. "Asnjëherë nuk do të pranojmë uzurpimin e Jeruzalemit nga Izraeli. Ne do të mbështesim luftën e vëllezërve tanë deri në ditën kur palestinezët do të vendosen në tokat e tyre, ku do të ketë paqe dhe siguri në shtetin e Palestinës", shtoi ai, raporton "Hurriyet", transmeton Perisko-

pi. Turqia si kryesuese e Konferencës së Organizatës Islamike për Bashkëpunim (OIC), ka bërë thirrje për një samit që do të mbahet në Stamboll, rreth një diskutimi kundërt Izraelit. Më 14 maj, të paktën 62 protestues palestinezë janë vranë dhe qindra të tjerë janë plagosur nga ushtarët izraelitë.



Nga Halim PURRELKU

(vijon nga numri i kaluar)

Për ndjekjen e kaçakëve të strehuar në Korab, në fillim të shtatorit 1920 komandanti i "Sektorit të majtë"-Dibrës i kishte lënë në dispozicion nënprefektit të Rostushës (Galiçnikut) një çetë ushtarake nga Hanet e Mavrovës dhe një repart prej 40 ushtarësh nga Zheranica (Zhirovnica), por këto nuk shënuan ndonjë efekt të veçantë në ndjekjen e kaçakëve. Për hakmarrje fuqitë serbo-kroato-slllovene terrorizonin popullsinë civile. Nga fundi i shtatorit-fillimi i tetorit 1920, nën pretekstin e vrasjes së një xhandari serbo-kroato-slllovene gjatë një përleshje me kaçakët, në afërsi të fshatit shqiptar Pesoçan të rrethit të Ohrit, forcat serbo-kroato-slllovene masakruan tërë popullatën e fshatit dhe për pasojë pastaj pronat e shqiptarëve u kolonizuan me popullatë sllave me çka tërësisht ndërroi karakteri etnik i fshatit.

Por, aksionet e kaçakëve nuk ndaluan as gjatë muajit tetor 1920. Kalosh Kërçova me çetën e tij prej 150-200 veta, në mbremje të 22 tetorit të vitit 1920, ndërmoi sulm me përmasa shumë të mëdha mbi selinë komunale dhe stacionin e xhandarmerisë në fshatin Galiçnik, qendër administrative e rrethit të Galiçnikut (Rekës së Dibrës). Gjatë sulmit në fjalë u zhvillua luftë e madhe, që përfundoi me viktima në njerëz nga të dyja palët. Këtë aksion të çetës në Galiçnik gazeta "Stara Srbija" e Shkupit, e karakterizon si sulm i kaçakëve që "për nga dimensionin i ka tejkaluar të gjitha sulmet e deritanishme...kjo tregon se ato nuk janë plaçkitje të rëndomta dhe aksidente të rralla; por ekspedita të tëra të organizuara...", të tilla aksionet e çetës së Kaloshit i vlerësuan edhe autoritetet e larta ushtarake jugosllave. Të nesërmen, në mëngjesin e 23 tetorit 1920, Kërsta Smiljanij-Bradina, komandant i "Trupave të Anadrinit" (në Zonën e Pushtimit jugosllav në Shqipërinë politike), urdhëroi që efektivat e tri çetave ushtarake dhe fuqitë e xhandarmerisë të vihen në ndjekje të çetës së Kaloshit në gjithë territorin e rrethit të Galiçnikut. Ndërkaq, një çete ushtarake iu urdhërua që të zhvendoset përkohësisht nga Hanet e Mavrovës në Galiçnik dhe të vendosi roje nga 10-15 ushtarë në fshatrat Tresonçe, Lazaropole etj. Gjithashtu, edhe nga drejtimi i Kërçovës u dërguan tri ekspedita (potera) në drejtim të Mavrovës. Por, të gjitha këto ekspedita të ndjekjes nuk arritën të asgjësonin çetën e Kaloshit. Siç njoftojnë burimet jugosllave, Kalosh Kërçova me një grup luftëtarësh të çetës së tij, gjatë 26-30 tetor 1920 gjendej në malet e fshatrave Zajaz dhe Baçisht

AKSIONET E ÇETAVE KAÇAKE (GUERILE) NË TREVAT LINDORE SHQIPTARE 1919-1925 (3)

ZGJERIMI I AKSIONEVE DERI NË TETOVË DHE SHKUP

Gjatë muajve shtator-nëntor 1921, aksionet e çetave në Trevat Lindore shqiptare vazhdonin dhe u shtrinë në rrethet e Tetovës, Shkupit, Kërçovës, Brodit ku dhe ishin ndërmarrë mbi shtatë aksione, nga të cilët do theksuar vrasjen e kryetarit të Hanit të Elezit, sulmi ndaj trenit në linjën Tetovë-Shkup, por dhe çetat u ndanë me humbje. Humbja më e madhja ishte vrasja e Sadin Selmani prijësit të çetës

të Kërçovës, nga aty Kaloshi u dërgoi dy letra kërcënuese autoriteteve jugosllave në Galiçnik. Prandaj, do të pason një ekspeditë e madhe tjetër jugosllave e ndjekjes e organizuar nga Ministria serbo-kroato-slllovene e Punëve të Brendshme, e cila filloi më 1 nëntor 1920 dhe do të vazhdoji dy ditë. Në këtë ekspeditë, krahas forcave të xhandarmerisë nga rrethi i Galiçnikut dhe nga rrethi i Kërçovës, do të inkuadrohen edhe tri çeta ushtarake. Mirëpo edhe ky operacion ushtarako-polikor serbo-kroato-slllovene i ndjekjes përfundoi pa sukses. Ndërkaq, çeta e Kaloshit në fund të nëntorit dhe në fillim të dhjetorit të vitit 1920, ndërmoi edhe tre sulme tjera mbi efektivat e rojeve ushtarake në Galiçnik, të cilat sulme autoritetet ushtarake jugosllave i vlerësonin si të pa suksesshme.

Shkaqet e mossuksesit të ekspeditave jugosllave të ndjekjes kundër çetave ishin të ndryshme.



Nga ato ishte dhe mbështetja e çetave nga popullata dhe jatakët të tyre që vazhdimisht i informonin çetat mbi numrin e efektiveve të forcave jugosllave dhe drejtimet e lëvizjes së tyre, kurse nga ana tjetër, përkundër reprezaljeve që ushtroheshin mbi popullatën, ajo nuk bashkëpunonte me pushtetin jugosllav dhe nuk i jepte informata pushtetit mbi lëvizjet e grupeve kaçake.

Më 27 janar 1921, Ministria e Punëve të Brendshme e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene lëshoi "proklamata", me të cilën ftoheshin të gjithë kaçakët në "Serbinë Jugore" që deri më 10 mars ti dorëzoeshin organeve shtetërore. Mirëpo, masatë e qeverisë serbo-kroato-slllovene nuk i hamendën kaçakët nga qëllimet e tyre. Në muajt janar-shkurt 1921, në Trevat Lindore shqiptare nuk pati aksione të mëdha të çetave kaçake, me ndonjë përjashtim të rrallë. Megjithatë, në

11 dhe 12 shkurt 1921, Abdulla Bojku me çetën e tij hyri në fshatin Belicë e Poshtme, për çka u ndërmor ekspeditë ndjekje ndaj çetës dhe përsuan tetë veta/fshatarë të cilët u arrestuan nën akuzën se janë jatakë të çetës. Aksionet e kaçakëve morën përmasa më të mëdha nga fundi i shkurtit dhe fillimi i marsit të vitit 1921. Më 23 mars 1921 pati përpjekje të armatosur në malin Korab ndërmjet një çete shqiptare dhe xhandarëve jugosllav.

Ndërkaq, në verë të vitit 1921 u intensifikuan aksionet e çetave kaçake në terren që rezultuan, veç tjerash, me kidnapime të personave zyrtar, me zënien e dy grupeve ushtarësh të cilët u çarmatosën dhe me vrasjen e dy ushtarëve. Në fillim të majit 1921, arriti në rrethin e Kërçovës Sadin Selmani nga fshati Zajaz i Kërçovës me çetën e tij prej 16 veta, dhe filloj të ndërmerr aksione të dhunshme në këtë trevë ndaj interesave shtetërore. Por që

nga fillimi i majit 1921, në ndjekje të çetës kaçake të Sadinit u angazhuan, krahas forcave policore e ushtarake, edhe çeta çetnike vendore e përbërë nga 50 veta në krye me vojvodën çetnik Bllazhe Nikodijeviq, e cila shërbente si "roje e përgjithshme e rendit publik". Më 15/maj 1921 çeta kaçake e Sadin Selmanit pati një përpjekje me çetën çetnike në rrethin e Kërçovës. Kurse, më 30 maj 1921, në afërsi të Gostivarit në një aksion të një çete shqiptare u zunë rob një grup ushtarësh me dy oficerë, të cilët u çarmatosën nga çeta. Më 7 qershor 1921 një grup shqiptarë u ndesh në rrethin e Dibrës me një patrullë jugosllave. Më 13 qershor 1921, një çetë shqiptare në pritë në ngushicën në malin Vllajnicë zuri një grup ushtarësh jugosllav të cilët i çarmatosi.

Gjatë muajve korrik-gusht të vitit 1921 aksionet e çetave ishin më intensive në rrethet e Shkupit, Tetovës, Kërçovës etj. që rezultuan dhe me viktima në njerëz. Në natën e 18-19 korrik qe ndërmarr një aksion diversant ndaj lokomotivës së Trenit në stacionin hekurudhor "Gjeneral Henri" në rrethin e Shkupit. Më 25 korrik një çetë kaçake zuri pritë në rrugën Tetovë-fshati Saraçinë, me qëllim që të kap prefektin e qarkut të Tetovës, por duket se në mungesë të prefektit kidnapoi një grup hekurudharësh (ferovistësh) ku bënë pjesë dhe supletit dhe shefi i stacionit hekurudhor. Në rrethin e Kërçovës gjatë gjithë verës vazhdon të veprojë edhe çeta kaçake e Sadin Selmanit, e cila disa herë u përplas me forcat serbo-kroato-slllovene. Nga ato aksione veçohej përleshja e çetës së



Sadinit me forcat e ndjekjes në natën e 15-16 gushtit 1921, ku dhe mbetën të vrarë dy luftëtar nga radhët e forcave serbo-kroato-slllovene. Ndërkaq, asokohe Kalosh Kërçova me të vëllain Lazamin me çetën ishin angazhuar përkrahë fuqive kombëtare kundër fuqive mercenare pro serbo-kroato-slllovene të Halit Lleshit e Tafë Kaziut në "Vijën e demarkacioni". Për shembull, Kaloshi e Lazami me fuqitë e tyre morën pjesë përkrah Dikë Xhelilit dhe Miftar Kaloshit në luftën mbi Prat të Dardhës (rrethi i Peshkopisë) dhe në Krej (majat) e Lurës, më 4 gusht 1921.

Por gjatë muajve shtator-nëntor 1921, aksionet e çetave në Trevat Lindore shqiptare vazhdonin dhe u shtrinë në rrethet e Tetovës, Shkupit, Kërçovës, Brodit ku dhe ishin ndërmarrë mbi shtatë aksione, nga të cilët do theksuar vrasjen e kryetarit të Hanit të Elezit, sulmi ndaj trenit në linjën Tetovë-Shkup, por dhe çetat u ndanë me humbje. Humbja më e madhja ishte vrasja e Sadin Selmani prijësit të çetës. Rreth 5-6 shtator 1921, Kalosh Zajazi, me 16 kaçakë, kaloi kufirin dhe shkoi për në Tetovë dhe shpejtë rifilluan aksionet e çetave. Më 13 shtator 1921, një çetë kaçake, prej 60 vetash sulmoi trenin i cili qarkullonte nga Shkupi në Tetovë. Kurse nga mezi i shtatorit 1921, në rrethin e Brodit, në kufi me rrethin e Tetovës, vepronte një çetë kaçake prej 100 vetash, por dhe në rrethin e Shkupit nga mesi i shtatorit 1921 vepronte një çetë tjetër shqiptare, në krye me "kaçakun e vjetër të Tetovës", Adem Merxhan Bulku, e cila e likuidoi kryetarin e komunës së Hanit të Elezit ("Gjenerall Jankoviq"). Nga mezi i shtatorit të vitit 1921 edhe Kalosh Kërçova me një numër më të madh kaçakësh rreth 80 -100 vetash tani vepronte në rrethin e Kërçovës dhe në malin Bigla, nga ku i kërkoj pushtetit serbo-kroato-slllovene që të i lirojë familjarët e internuar të tij. Më 18 shtator 1921, Kaloshi me çetën rreth 100 vetash kaloi nga fshati "Hatishit" (Atishte) të Kërçovës në zonën midis Kërçovës e Brodit dhe nga aty shkoi në malin e Bushovës ("Bushovsku planinu"). Duket se pushteti nuk iu përgjigj kërkesës së Kaloshit, ndaj dhe ai më 17 tetor të vitit 1921 me çetën e vet e sulmoi fshatin Tajmisht i banuar me popullatë sllave, në veri-perëndim të Kërçovës, ku më parë nga fshatarët dhe xhandarët qe plagosur Sadin Selmani. Por, forcat serbo-kroato-slllovene të ndjekjes asokohe vazhdonin ekspeditat e tyre kundër çetave kaçake të Kërçovës. Për rrjedhojë të këtyre ekspeditave, në malin Çelojçë, në veri-lindje të Kërçovës, kah fundi i nëntorit të vitit 1921 në luftë me xhandarmerinë serbo-kroato-slllovene u vra prijësi i njëjës çete kërçovare, Sadin Selmani. Vetëm pas vrasjes së Sadin Selmanit, u suspendua gjendja e shtetrrethimit ndaj fshatit Zajaz dhe u larguan nga aty forcat ushtarako-policore jugosllave.

(vijon në numrin e ardhshëm)

FEJTON: FERRI PAS ISIS-it: (5)



U MASAKRUAN 150 BURRA!



Nga Anand GOPAL

Në të njëjtën mbrëmje, një ushtar i ISIS me një altoparant njoftoi se kushdo që kishte punuar me amerikanët ose qeverinë irakiane të paktën gjysma e fshatit - do të kishte 24 orë për t'u larguar. Ata u urdhëruan të lënë makinat e tyre prapa dhe të marrin vetëm atë që mund të mbanin. Umm Ammar, gruaja e Abu Ammar, nxitoi në dhomën e gjumit dhe i futi sendet në një qese: certifikatat e lindjes, formularët e regjistrimit të policisë, fotot e fëmijëve, një gjerdan nga burri i saj. Në agim, ajo dhe Abu Latifi kishin mbledhur fëmijët e saj, gruan dhe fëmijët e Falahut, disa kushërinj dhe mbesa - një e re gati 20 vjeçare - dhe filluan të ecnin. ISIS e kontrollonte autostradën që kalonte nëpër qytet, kështu që kishte vetëm një mënyrë për Haditha: nëpër shkretëtirë.

Për tre milje ata ecnin nëpër rërë, lëkurën e Umm Ammarit që digjej në mes të nxehtësisë së mesditës derisa ata nuk mund të shkonin më larg. Ata ngritën një çadër në një rrahje në mes të dunave. Në pasdite pluhuri filloi në llojin e stuhisë verbuese që dënon jazira, djerrinë e shkretëtirës midis Tigrit dhe Eufratit. Deri në mbrëmje, erërat kishin heshtur, vetëm për t'u zëvendësuar nga të ftohtit e hidhur. Gjatë gjithë natës, fëmijët bërtitën, u tundën dhe teshtinë dhe qanë disa më shumë. Ndërsa Umm Ammar qëndronte atje, me paaftësi për të fjetur, mendonte për ditët e errëta përpara. Ajo ishte dëbuar nga shtëpia e vetme që kishte njohur ndonjëherë. Ndoshta gjithë Iraku do të binte, dhe familja e saj do të detyrohej të fshihej, duke jetuar në skrap dhe fletëpalosje. Ishte atëherë ajo kujtonte kafshët e saj: tre mësh-

Familja ecte në këmbë në autostradë, përgjatë shtrirjes së rrugës. Ata udhëtuan për dy ditë dhe gjatë rrugës u bashkuan me familje të tjera nga fisi Abu Nimr që iknin nga fshatra përgjatë Eufratit. Shkretëtiria ishte e mbushur me luftëtarë të ISIS dhe mbështetësit e tyre; 150 burra të rinj Abu Nimr humbën dhe u masakruan nga anëtarët të një fisi të afërt pro-ISIS

qerra dhe një viç dem. Ajo i kishte ngritur vetë, dhe ata do të ishin me të nëpërmjet të gjitha, nga sanksionet në luftë. Ajo u kap nga ideja se lopët ishin shpresa e fundit e familjes, sigurimi i vetëm kundër vështirësive të ardhshme.

Umm Ammar u ngrit në agim, e vendosur për t'u kthyer në Zweiya dhe për të shpëtuar kafshët e saj. Sonda e saj në ligj mendonte se ajo do të humbiste mendjen.

"Por kam menduar ndoshta nëse i shpëtoja shpirtat e këtyre lopëve," tha Umm Ammar, "Perëndia do të ndihmojë familjen time të dalë nga ky makth". Ajo vendosi të marrë djalin e saj 4-vjeçar, Humam, sepse ajo besonte luftëtarët



ISIS nuk do të dëmtonin një nënë me fëmijën e saj. Para se Abu Latif të vinte re, ata u larguan. Ata udhëtuan nëpër shkretëtirë, dielli u ngjit dhe shamia e Umm Ammar u ngjit me të me djersë. Kur ata arritën në Zweiya, nuk ishte asnjë shpirt i pranishëm.

"Kur nuk shihni askënd, është sikur ka fantazma kudo", tha ajo. "Këmbët e mia po lëkundeshin". Pemët dridheshin nga një shpërthim i fuqishëm, dhe Humam filloi të qante. Ajo u gjunjëzua për ta zbutur dhe një shpërthim tjetër dukej jo shumë larg. ISIS po kontrollonte shumë shtëpi.

Umm Ammar dhe Humam nxituan përgjatë një shtegu të papastërtive nëpër fushat e elbit. Kur e pa shtëpinë e saj, u afruan në muret e jashtme dhe dëgjonin. Vetëm erë. Ajo u kthye prapa. E pa ku ishin kafshët. I thirri ata me nuancat e

ngjyrës së tyre: zeza, kafja, verdha, portokalli. Ata erdhën tek ajo, dhe ajo i puthi dhe i çoi larg, përmes elbit. Diku pas tyre, një tjetër shpërthim bëri jehonë.

Dielli në mesditë po flakëronte në kohën kur Umm Amari dhe procesioni i saj e ktheu në kampin e shkretëtirës. Abu Latif nuk mund të besonte atë që ajo do të bënte dhe tha se burri i saj do të ishte i zemëruar kur të kuptonte se do të rrezikonte jetën e saj. Por ajo kujdeset vetëm për një gjë: "Dua që të largohemi këtu", tha ajo.

Familja ecte dhe hyri në autostradë përgjatë shtrirjes së rrugës. Ata udhëtuan për dy ditë, u bashkuan aty dhe aty me familje të tjera nga fisi Abu Nimr që iknin nga fshatra përgjatë Eufratit. Shkretëtiria ishte e mbushur me luftëtarë të ISIS dhe mbështetësit e tyre; 150 burra të rinj Abu Nimr humbën dhe u masakruan nga anëtarët të një fisi të afërt pro-ISIS. Ndërkohë, në Hit, banorët e qytetit ndihmuan të zbulonin policët Abu Nimr që kishin qëndruar prapa. ISIS rreshtoi 47 njerëz në rrugën kryesore dhe i ekzekutoi ato, ndërsa disa banorë të Hitit i fotografuan me celularët e tyre. **(vijon)**

Ky shkrim është shkruar nga Anand Gopal, autor i librit "Asnjë njeri i mirë mes të gjallëve: Amerika, talebanët dhe lufta në sytë afgane". Teksti është botuar në "The Atlantic", i përkthyer dhe përshtatur nga "KDPolitik.com".



• Umm Ammar, gruaja e Abu Ammar, nxitoi në dhomën e gjumit dhe i futi sendet në një qese - certifikatat e lindjes, formularët e regjistrimit të policisë, fotot e fëmijëve, një gjerdan nga burri i saj

Në bazë të nenit 50, paragrafi 1, pika 9, nga Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 5/02) dhe neni 19-a paragrafi 1 nga Ligji për ndërmarrjet publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 38/96...64/18), ndërsa në pajtim me Vendimin për publikimin e Shpalljes publike për zgjedhje të Drejtorit të NP "Mito Haxhi Vasilev -Jasmin" Kavadar nr.09-2799/1 të datës 15.05.2018 Kryetari Komunës së Kavadarit, publikon

SHPALLJE PUBLIKE
për zgjedhje të drejtorit të NP për menaxhim me objekte banimi
"Mito Haxhi Vasilev-Jasmin" Kavadar

Shpallet Konkurs publik për zgjedhje të Drejtorit të Ndërmarrjes publike për menaxhim me objekte sportive "Mito Haxhi Vasilev-Jasmin" Kavadar.

Për drejtor mund të emërohet personi i cili përmbushë kushtet në vijim:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë

-ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit

-në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

- ka së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune.

(vërejtje: kushti për njohjen e gjuhës angleze përmes posedimit të një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) të dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë apo APTIS së paku niveli B2, kandidati i zgjedhur është i obliguar që ta plotësojë më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit. Drejtori i cili nuk do ta plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj në afat prej një viti nga emërimi i përfundon mandati)

Krahas dokumentacionit nga pika 1, kandidatët e interesuar duhet të parashtrojnë edhe Program për punë dhe zhvillim të ndërmarrjes së NP "Mito Haxhi Vasilev-Jasmin" Kavadar.

Secili kandidat i interesuar duhet të parashtrojë Fletëparaqitje, CV dhe dokumente në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, si dëshmi për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura.

Shpallja publike do të zgjasë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore.

Dokumentet e arritura i shqyrton Komisioni i tre anëtarësh i zgjedhur nga Kryetari i Komunës në afat prej 8 (tetë) ditëve dhe pas kalimit të Shpalljes tërë dokumentacionin e parashtron deri te Kryetari i Komunës, i cili në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve sjellë Vendim për zgjedhje.

Lajmërimi për zgjedhjen e realizuar deri te kandidatët do të dorëzohet në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e parashtrimit të Vendimit për zgjedhje.

Kryetari i Komunës do të mbajë të drejtën që kandidatët me fletëparaqitje në gjendje të rregullt t'i intervistojë.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm parashtrohet deri në Arkivin e Komunës së Kavadarit ose në adresën në vijim: Sheshi "Marshall Tito" pn Kavadar me shenjë: "Për Konkurs publik për zgjedhje të Drejtorit për menaxhim me objekte sportive" Mito Haxhi Vasilev-Jasmin" Kavadar.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

KOMUNA E KAVADARIT
KRYETARI I KOMUNËS
M-r Mitko Jançev

Në bazë të nenit 50, paragrafi 1, pika 9, nga Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 5/02) dhe neni 19-a paragrafi 1 nga Ligji për ndërmarrjet publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 38/96...64/18), ndërsa në pajtim me Vendimin për publikimin e Shpalljes publike për zgjedhje të Drejtorit të NP "Komunalec" Kavadar nr.09-2800/1 të datës 15.05.2018 Kryetari Komunës së Kavadarit, publikon

SHPALLJE PUBLIKE
për zgjedhje të Drejtorit të NP "Komunalec" Kavadar

Shpallet Konkurs publik për zgjedhje të Drejtorit të Ndërmarrjes publike "Komunalec" Kavadar.

Për drejtor mund të emërohet personi i cili përmbushë kushtet në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë

-ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit

-në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

- ka së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune.

(vërejtje: kushti për njohjen e gjuhës angleze përmes posedimit të një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) të dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë apo APTIS së paku niveli B2, kandidati i zgjedhur është i obliguar që ta plotësojë më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit. Drejtori i cili nuk do ta plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj në afat prej një viti nga emërimi i përfundon mandati)

Krahas dokumentacionit nga pika 1, kandidatët e interesuar duhet të parashtrojnë edhe Program për punë dhe zhvillim të ndërmarrjes së NP "Komunalec" Kavadar.

Secili kandidat i interesuar duhet të parashtrojë Fletëparaqitje, CV dhe dokumente në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, si dëshmi për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura.

Shpallja publike do të zgjasë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore.

Dokumentet e arritura i shqyrton Komisioni i tre anëtarësh i zgjedhur nga Kryetari i Komunës në afat prej 8 (tetë) ditëve dhe pas kalimit të Shpalljes tërë dokumentacionin e parashtron deri te Kryetari i Komunës, i cili në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve sjellë Vendim për zgjedhje.

Lajmërimi për zgjedhjen e realizuar deri te kandidatët do të dorëzohet në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e parashtrimit të Vendimit për zgjedhje.

Kryetari i Komunës do të mbajë të drejtën që kandidatët me fletëparaqitje në gjendje të rregullt t'i intervistojë.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm parashtrohet deri në Arkivin e Komunës së Kavadarit ose në adresën në vijim: Sheshi "Marshall Tito" pn Kavadar me shenjë: "Për Konkurs publik për zgjedhje të Drejtorit të NP "Komunalec" Kavadar.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

KOMUNA E KAVADARIT
KRYETARI I KOMUNËS
M-r Mitko Jançev

Në bazë të nenit 30 dhe nenit 37 nga Ligji për kulturë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 24/07...11/18) dhe neni 11 nga Ligji për muzet ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 66/04/, 89/08, 116/10, 51/11, 88/15, 152/15, 39/15), dhe neni 50 paragrafi 1 pika 9 nga Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.05/2002) Kryetari Komunës së Kavadarit, publikon

SHPALLJE PUBLIKE
për zgjedhje të Drejtorit të Muzeut Lokal Galeria- Kavadar

1.Shpallet Konkurs publik për zgjedhje të Drejtorit të Muzeut Lokal Galeria-Kavadar.

Për drejtor mund të emërohet personi i cili përmbushë kushtet në vijim:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë

-ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit të lartë, Shkencat shoqërore (Fakulteti filoz. gr.histori, Fakul.e historisë së artit me arkeologji, Fak.për arkeologji me hist. e artit, Fakultet për etnologji, Fakultet të artit figurativ)

-në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

- ka së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në sferën e veprimtarisë së kulturës apo pesë vite përvojë pune në punë apo projekte nga sfera e kulturës në bazë të kontratave ne vepër.

(vërejtje: kushti për njohjen e gjuhës angleze përmes posedimit të një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) të dhënë ose BULATS – së paku 60 pikë apo APTIS së paku niveli B2, kandidati i zgjedhur është i obliguar që ta plotësojë më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit. Drejtori i cili nuk do ta plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj në afat prej një viti nga emërimi i përfundon mandati)

2. Secili kandidat i interesuar duhet të parashtrojë Fletëparaqitje, CV dhe dokumente në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, si dëshmi për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura.

3. Shpallja publike do të zgjasë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

4. Kandidatët i parashtrojnë dokumentet e nevojshme në pajtim me Konkursin deri te Këshilli drejtues i Muzeut lokal Galeria Kavadar.

Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni i tre anëtarësh i formuar nga ana e Këshillit Drejtues të Muzeut Galeria Kavadar në afat prej 5 ditëve pas përfundimit të shpalljes parashtron propozim deri te Kryetari i Komunës me arsyetim për zgjedhje të drejtorit.

Kryetari i Komunës në afat prej 15 ditë nga dita e marrjes së propozimit bën zgjedhjen e drejtorit.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

KOMUNA E KAVADARIT
KRYETARI I KOMUNËS
M-r Mitko Jançev

Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16), neni 22 paragrafi 1 dhe neni 23 paragrafi 1 dhe 4, ndërsa në lidhje me nenin 14 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 74/15 dhe 167/15), neni 143 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16 dhe 163/17), Pëlqimit nga Ministria e financave të RM nr. 18-2384/2 të datës 22.02.2018, Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF "Carka Andreevska" – Kratovë nr. 01-110/7 të datës 09.07.2015 dhe Vendimit nr. 04-156/1 të datës 16.05.2018, Institucioni publik komunal për fëmijë – Çerdhja për fëmijë "Carka Andreevska" Kratovë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim për kohë të pacaktuar të punës

- Eduktor..... 1 (një) realizues;**
 - 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim sipëror të mbaruar të shkallës VII/1;
 - Licencë valide për edukator;
 - Me apo pa përvojë pune;
 - Orari ditor i punës: 8 orë (prej 07:00 – 15:00);
 - Orari javor i punës: 40 orë (nga e hëna deri të premten);
 - Neto rroga bazë: **19.581,00** den.
- Përkëdhelës..... 1 (një) realizues;**
 - Të ketë të mbaruar arsim të mesëm katërvjeçar;
 - Licencë valide për përkëdhelës;
 - Me apo pa përvojë pune;
 - Orari ditor i punës: 8 orë (prej ora 8:30 – 16:30);
 - Orari javor i punës: 40 orë (nga e hëna deri të premten);
 - Neto rroga bazë: **14.780,00** den.

Përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune kandidatët duhet ti plotësojnë dhe kushtet e parapara në nenin 134 dhe 142 nga Ligji për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 23/2013, 12/2014, 44/2014, 144/2014, 10/2015, 25/2015, 150/2015, 192/2015, 27/2016 dhe 163/17).

Krahas fletëparaqitjes, kandidatët me numër rendor 1 (Eduktor) dhe me numër rendor 2 (Përkëdhelës) duhet të parashtrojnë dhe dokumentet në vijim:

- Dokumentet e nevojshme për aplikim:**
- Fletëparaqitje;
 - Dëftesë apo Diplomë për mbarim të arsimit të përshtatshëm (*origjinal apo kopje e notuarizuar*);
 - Certifikatë të shtetësisë (*jo më të vjetër se 6 muaj*);
 - Vërtetim mjekësor se personi është psikikisht dhe fizikisht i shëndosh;
 - Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (*jo më të vjetër se 6 muaj*);
 - Vërtetim se nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë është dënuar për një krim të dhunës në familje, heqjes së një të mitur, neglizhenca apo abuzimi i një të mituri apo incestit, një krim nga grupi i veprave penale kundër lirisë gjinore duke pasur parasysh sanksioni i vënë dhe në të cilën sipas ligjit përcaktuar sjelljen diskriminuese (*jo më të vjetër se 6 muaj*);
 - Të përmbushë dhe kushte tjera të përcaktuara me aktin për organizim të brendshëm dhe sistemim të vendeve të punës;
 - Licencë valide për edukator për vendin e punës numër 1;
 - Licencë valide për përkëdhelës për vendin e punës numër 2;

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të konkursit në shtyp ditor.

Me kandidatët të cilët kanë aplikuar në Shpallje do të mbahet intervistë.

Vendimi për zgjedhjen do të merret në afat prej 15 ditë pas skadimit të afatit për aplikim në shpallje publike.

Dokumentet e nevojshme të dorëzohen në adresën e Institutit "Goce Dellçev" nr. 1 1360 Kratovë apo drejtpërsëdrejti në arkivin e institutit.

Telefoni për kontakt 031/481-705.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IKPKF "Canka Andreevska"
Kratovë

NË PRAG TË SFIDËS VENDIMTARE PËR PLASMAN NË LIGA EVROPË

FC SHKUPI DHE "SHVERCERAT" KËRKOJNË PËRKRAHJE

Fitorja ndaj Pelisterit dhe barazimi pa gola mes Sileksit dhe Rabotniçkit, ka bërë që Shkupi ta shoh vetën në Evropë pas 13-të viteve, diçka që u ka munguar shumë dashamirëve dhe tifozëve më të flaktë "Shvecerat Shkup". Pikërisht këta të fundit, pasi kuptuan rezultatin e ndeshjes në Kratovë, nuk nguruan të bëjnë thirrje për të gjithë ata që e duan FC Shkupin dhe ngjyrat e saj



Shkupi, ju njoftojmë se të dielën në Çair, zhvillohet xhiroja e fundit mes Shkupit dhe Vardarit, që në historinë e futbollit vendor dhe jashtë, njihet si derbi kryesor. E veçanta e derbit që zhvillohet këtë të diele është se Shkupi lufton për fitore dhe dalje në Evropë që i jep kuptim edhe më të madh këtij derbi të njohur ndërkombëtarisht. Në emër të 'Shvecercave' ju ftoj publikisht që të jeni në përkrahje të klubit të vetëm shqiptar në kryeqytet, si dhe publikisht ftoj mediat që së paku këtë herë ti japin mbështetje dhe së bashku të udhëtojmë drejt Evropës. Deri të dielën, çdo sekondë ka emocion, dashuri dhe krenari. Ne sundojmë Shkupin, kanë shkruar në faqen zyrtare grupi i mirënjohur "Shvecerat Shkup". Derisa, me një apel tifozëve të saj nëpërmjet një video pikërisht nga ndeshja me Vardarin, ku së fundmi Shkupi e mundi në Çair me 2-0, i janë drejtuar edhe nga radhët e FC Shkupi. "Të dielën të gjitha rrugët shpien drejt Çairit. Eja edhe ti i duhesh Shkupit", titullohet videoja prej më shumë se një minutë. Ndeshja ndërmjet Shkupit dhe Vardarit zhvillohet të dielën në ora 16.30.

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 17 maj - FC Shkupi ka mbajtur dje stërvitjen e radhës në stadiumin në Çair, nën drejtimin e trajnerit Zekirja Ramadani. Skuadra ka punuar më shumë në lojën e saj ku atmosfera dukej mjaftë e

mirë. Në fushë ishin të gjithë lojtarët që dukeshin të vetëdijshëm se para vetës kanë një sfidë të madhe. Cekim, Shkupi në fundjavë luan me Vardarin në ndeshjen që e vendos pjesëmarrjen në Liga Evropë. Bardhekaltërve u nevojitet vetëm fitorja, për të mos pritur epilogët nga ndeshjet tjera Rabotniçki - "Skopje" dhe Akademia Pan-

devi - Sileksi. Fitorja ndaj Pelisterit dhe barazimi pa gola mes Sileksit dhe Rabotniçkit, ka bërë që Shkupi ta shoh vetën në Evropë pas 13-të viteve, diçka që u ka munguar shumë dashamirëve dhe tifozëve më të flaktë "Shvecerat Shkup". Pikërisht këta të fundit, pasi kuptuan rezultatin e ndeshjes në Kratovë, nuk nguruan të bëjnë thirrje

për të gjithë ata që e duan FC Shkupin dhe ngjyrat e saj. Në faqen e tyre zyrtare në "Facebook", nëpërmjet një statusi, i cili më pas është shpërndarë nga shumë anëtar të saj, "Shvecerat" u bëjnë thirrje të gjithëve, duke thënë se 'Shkupi ka nevojë për ju'. "Shkupi ka nevojë për ju. Të nderuar 'Shvecera' dhe ju dashamir të KF

Panuçi fton Gurin për dy miqësoret e radhës



Më në fund ka ardhur edhe momenti i Sindrit Gurit, që të marrë një ftesë në Kombëtaren Shqiptare. Ai ka marrë ftesë nga Kristian Panuçi për të qenë pjesë e Shqipërisë në dy ndeshjet miqësore të fundmuajt, ndaj Kosovës dhe Ukrainës. Sulmuesi shkodoran i Kukësit ka qenë një nga elementët më të spikatur këtë sezon në Kategorinë Superiore, teksa është në krye të listës së golashënuesve më të mirë, kur kanë mbetur edhe dy javë deri

në fund të sezonit. Për më tepër, vetëm pasditën e djeshme u përcoll lajmi që Guri do t'i bashkohet skuadrës belge të KVV Oostendes, duke filluar nga kjo verë e për 3 sezonet në vijim. Guri u bë çështje edhe në miqësoren me Norvegjinë, pasi mungesa e ftesës për të shkaktoi debat në opinionin sportiv në Shqipëri, ndërsa pak ditë më parë, Kristian Panuçi pranoi se tashmë sulmuesi shkodoran do të jetë pjesë e Shqipërisë.

Me apo pa Sarrin, Hysaj qëndron te Napoli

Agjenti i Elseid Hysaj Mario Giuffredi shuan përfundimisht zërat që e japin të ardhmen e mbrojtësit shqiptar larg Napolit. Në ditët e fundit mediat angleze kanë aluduar rreth një kalimi të mundshëm të Hysajt te Mançester Junajtedi në merkaton e kësaj vere por në një intervistë për Radio "Kiss Kiss" që qëndron shumë pranë klubit të Napoli, menaxheri i kuqe-



ziut ka theksuar se me apo pa trajnerin Maurizio Sarri, Hysaj do të qëndrojë tek Napoli sepse presidenti De Laurentis do të ndërtojë një skuadër akoma edhe më shumë kompetitive se kjo aktuale për të fituar trofe në të ardhmen. Giuffredi shtoi se Elseidi është shumë i lumtur te Napoli dhe dëshiron të qëndrojë gjatë në San Paolo.

Rënia e kampionit të vetëm shqiptar të botës

Botërori i futbollit "Rusia 2018" do të jetë pa të vetmin shqiptar që e ka fituar Kupën e Botës. Mbrojtësi i qendrës Shkodran Mustafi nuk është përfshirë në listën e zgjeruar të Gjermanisë prej 27 lojtarëve, të bërë publike të martën nga përzgjedhësi Joakim Lev. Kjo nënkupton se ai nuk do të jetë në botërorin që nis më 14 qershor. Kështu Mustafi po e paguan çmimin për formën jo të lartë që e pati gjatë këtij edicioni tek Arsenali. Shumë faktorë shkonin në favor që Musta-

fi të jetë në botëror. Ai është në moshën më të mirë për futboll - 26-vjeçar. Po luan për klubin më të mirë që ka luajtur në karrierë. Është pjesë e gjeneratës që para katër vjetësh fitoi titullin e botës dhe tashmë ka përvojë dukshëm më të madhe se në botërorin e vitit 2014. Por Lev, që befasisht ia kishte dhënë rastin e madh katër vjet më parë, nuk besoi në mbrojtësin me prejardhje nga Gostivari për botërorin në Rusi. Ai ka përzgjedhur katër mbrojtës të Bajernit dhe nga një të Çellsit, Bo-



russia Menhengladbahut, Kelnit, Herta Berlinit e Bajer Leverkusentit.



Në bazë të nenit 37 – i të Ligjit për ndërmarrje publike (Gazeta Zyrtare e RM nr. 38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14 и 138/14, 25/2015, 61/2015 dhe 39/2016) dhe nenit 20-g të Ligjit të të punësuarve në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014, 199/2014 dhe 27/2016), NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup, publikon

SHPALLJE PUBLIKE nr. 03/2018

Për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar

Në drejtorinë e NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup:

Një (1) person në vendin e punës – Këshilltar i drejtorit për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe automjeteve me shifër KDR0305A0104

Kushtet e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Të jetë i moshës së rritur, të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Kushtet e posaçme

- Me shkallë të arsimit PSP ose së paku 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar;
- Lloji i arsimit Fakulteti i pylltarisë – pylltaria dhe hortikultura, Fakulteti ekonomik
- Përvojë pune prej së paku katër vjet në profesionin prej të cilave së paku dy vjet në vend udhëheqës të punës në sektorin publik, gjegjësisht së paku gjashtë vjet përvojë pune në profesionin dhe prej të cilave së paku tre vjet në vend udhëheqës të punës në sektorin priva;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike dhe punës në zyrë;
- Orari ditor i punës 8 orë prej ora 07:30 deri në ora 15:30; Orari javor i punës 40 orë prej ditës së hënë deri ditën e premte;

Neto pagesa fillestare 33.600,00 denarë.

Punësimi i paraparë në pajtim me planin vjetor të institucionit është për Maqedonas(e).

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrorin edhe dokumentet në vijim:

- Certifikatë të shtetësisë
- Dëshmi për arsim të mbaruar
- Dëshmi për përvojë të punës
- Certifikatë për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin përkatës të punës
- Vërtetim për njohje të programeve kompjuterike dhe punës në zyrë
- Vërtetim se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk do të shtohet dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të parashtrorin deri në NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup në rr. "Pero Nakov" nr. 128 – 1000 Shkup.

Shpallja zgjatë 15 ditë duke konsideruar nga dita e publikimit, gjegjësisht më së voni deri më 01.06.2018, ndërsa zgjedhja do të realizohet në pajtim me afatet e përcaktuara me ligj.

Dokumentacioni i pakompletuar dhe dokumentacioni i parashtruar pas kalimit të afatit për aplikim nuk do të shqyrtohet.

NP "Pyjet e Maqedonisë" – Shkup

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159 dhe 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pëlqimi për punësim nga Ministria e financave të RM nr. 18-5085/2 nga data 14.05.2018, Vendimit për publikim të shpalljes nr. 0401-1199/1 nga data 17.05.2018, u.d. Drejtori i Institutit, publikon

SHPALLJE

për punësimin e 2 (dy) personave në vendin e punës Laborant për kohë të pacaktuar

- IPSH Instituti për sëmundje të mushkërive tek fëmijët Kozle, Shkup ka nevojë për punësimin e 2 (dy) personave në vendin e punës Laborant për kohë të pacaktuar.
- Kandidatët duhet ti plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
- Të mos i jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për realizim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

- Përpos me ligj të vërtetuara kushtet e përgjithshme nga pika 2 Kandidatët për Laborant duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Arsim të mesëm të mbaruar të medicinës për laborant i medicinës dhe teknik sanitar.
- Provim të dhënë profesional
- 4. Orari i punës javore është 40 orë. Pagesa neto bazë për Laborant është 16.500,00 denarë.
- 5. Si shtojcë me fletëparaqitjen kandidatët për vendin e punës Laborant janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
- Dëftesë për arsim të mesëm të mbaruar të medicinës për laborant i medicinës dhe teknik sanitar, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë nga mjeku ju më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Kopje të letërnjoftimit të vërtetuar në noter
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë për provim të dhënë profesional në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- 6. Afati për paraqitje të kandidatëve është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes.
- 7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
- 8. Selektimi i kandidatëve të paraqitur nga pika 2 të cilët i plotësojnë kushtet nga shpallja publike, do të realizohet në pajtim me nenin 160 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.
- 9. Fletëparaqitja me dokumentacionin e përgjithshëm dhe telefoni për kontakt, të dorëzohet në IPSH Instituti për sëmundje të mushkërive tek fëmijët Kozle, Shkup lagjja Kozle p.n., Shkup me postë apo në arkivin e IPSH Instituti për sëmundje të mushkërive tek fëmijët Kozle, Shkup, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Instituti për sëmundje të mushkërive tek fëmijët Kozle, Shkup

UD Drejtor

D-r Angellço Andonovski

Ekk i Dipl. Rijad Alimi

Në bazë të neneve 20, 21 dhe 22 të Rregullores për licenca për kryerje të veprimtarive energjetike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 143/11, 78/13, 33/15 dhe 207/16), Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime NIMEKS SA Aleksandar i drugji SHPK eksport-import Shkup, me seli në rr. 1613 nr. 1-2/45, Shkup, Republika e Maqedonisë në vijim publikon:

LAJMËRIM

Informohet opinioni se Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime NIMEKS SA Aleksandar i drugji SHPK eksport-import Shkup, me seli në rr. 1613 nr. 1-2/45, Shkup, Republika e Maqedonisë më datë 03.05.2018 ka parashtruar kërkesë për dhënie të licencës për prodhim të energjisë elektrike me UP1 nr. 12-32/18 deri te KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.

Emri i kërkesit

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime NIMEKS SA Aleksandar i drugji SHPK eksport-import Shkup, me seli në rr. 1613 nr. 1-2/45, Shkup, Republika e Maqedonisë

Lloji i veprimtarisë energjetike

Prodhim i energjisë elektrike nga burime të ripërtëritura të energjisë nga biomasa.

Rajoni ku do të realizohet veprimtaria

Veprimtarinë energjetike, prodhim i energjisë elektrike nga burime të ripërtëritura të energjisë nga biomasa, Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime NIMEKS SA Aleksandar i drugji SHPK eksport-import Shkup, me seli në rr. 1613 nr. 1-2/45, Shkup, Republika e Maqedonisë, do ta realizojë në lokacionin në pajtim me vendimin e dhënë për adaptim të objektit, i cili gjendet në PK nr. 501/1, KK Terinci, Komuna Karbinci, me UP1 nr. 11-32 të datës 26.04.2018.

Përshkrimi i mënyrës, objekteve dhe mjeteve për kryerje të veprimtarisë

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime NIMEKS SA Aleksandar i drugji SHPK eksport-import Shkup, me seli në rr. 1613 nr. 1-2/45, Shkup, Republika e Maqedonisë do të prodhojë energji elektrike nga elektrana e biomasës me fuqi të instaluar prej 990Kw, me vend të kyçjes së rrjetit elektrodistribues të EVN Maqedoni SHA Shkup.

Kohëzgjatja e licencës

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime NIMEKS SA Aleksandar i drugji SHPK eksport-import Shkup, me seli në rr. 1613 nr. 1-2/45, Shkup, Republika e Maqedonisë deri te KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, kërkon që kohëzgjatja e licencës të jetë 35 (tridhjetepesë) vjet.

Mënyra dhe afati përfundimtar për parashtrimin e propozimeve, mendimeve dhe sugjerimeve në lidhje me Kërkesën për dhënie të licencës për prodhim të energjisë elektrike:

Palët e interesuara, subjektet juridike dhe fizike mund që me shkrim të parashtrorin deri te KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË propozime, mendime dhe sugjerime në lidhje me kërkesën për dhënie të licencës për prodhim të energjisë elektrike në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit të LAJMËRIMIT për kërkim të Dhënies së licencës për prodhim të energjisë elektrike.

KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË rr. "Makedonija" pn, Pallati "Lazar Pop Trajkov" kati 6, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

Në bazë të nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/2005, 106/2008, 114/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 dhe 27/2016), nenit 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/13, 12/14, 44/14, 10/15, 192/15, 27/16, 163/17), Drejtori i IPKÇF "PROLET" – Karposh – Shkup, publikon

SHPALLJE

Për punësim për kohë të pacaktuar të

1. I (një)-Ndihmës gjellëbërës, me arsim të mesëm të mbaruar III dhe IV, me ose pa përvojë pune

Së bashku me fletëparaqitjen ku duhet kandidati duhet të parashtrorin:

- Dëftesë për shkallën e mbaruar të arsimit që kërkohet (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter),
- Certifikatë të mjekut,
- Certifikatë të shtetësisë (kopje)
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Dëshmi të mos i jetë shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm me të cilën është gjykuar me vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes apo keqpërdorim i personit të mitur, për vepër penale të akteve kundër lirisë së gjinisë, pa marr parasysh sanksionit të shqiptuar në të cilën në pajtim me ligjin është vërtetuar sjellje diskriminuese

Afati për parashtrimin e dokumenteve është 5 ditë pune, duke përfshirë nga dita e publikimit të shpalljes.

Orari i punës së Ndihmës gjellëbërës është 40 orë në javë (prej ditës së hënë deri ditën e premte), ndërsa orari ditor i punës është 8 orë dhe i njëjti është i shkallëzuar prej ora 06:00 -18:00.

Neto pagesa fillestare për vendin e punës:

- Ndihmës gjellëbërës është 12.006,00 den

Dokumentacioni i dorëzuar pas fatit, jo i kompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrorin deri në:

IPKÇF "PROLET" – Karposh – Shkup
rr. Mile Pop Jordanov nr. 74
tel 02/3082-737 ose 070/305-501

Drejtor

Vita Jakovlevska

Institucioni publik komunal çerdhja për fëmijë "Prolet" – Karposh – Shkup

IPSH Spitali Klinik Tetovë shpall të pavlefshëm faksimilen dygjuhësor me përmbajtjen në vijim:

Д-р Руфадие Р. Вејсели

D-r Rufadie R. Vejseli

спец. по општа хирургија

spec. për kirurgji të përgjithshme

755320

IPSH Spitali Klinik – Tetovë

Drejtori,

Doc. Dr. Florin Besimi

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar Po+Pr+2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë "Momin Potok" – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m2 së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m2. Çmimi 178.000 euro.
Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 – Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

ZYRTARIZIMI PAS FINALES SË LIGËS SË KAMPIONËVE

JUVENTUSI MBYLL NËN SHKRIMIN ME EMRE XHAN

Goal” kupton se Xhan është i gatshëm të nënshkruajë një kontratë pesëvjeçare me Juventusin, ndërsa burimet mediatike nga Italia pretendojnë se do të fitojë rreth 5 milionë euro në vit, plus bonuset. Zyrtarizimi i këtij transferimi ka të ngjarë të bëhet pasi Liverpooli të ketë luajtur finalen e Ligës së Kampionëve me Real Madridin në Kiev, më 26 maj

Transferimi i mesfushorit gjerman në Seria A mund të konfirmohet këtë muaj, pasi përfundimi i Ligës së Kampionëve është gjatë rrugës. Mbeten edhe pak kohë që marrëveshja e mesfushorit në fjalë në “Anfield” të përfundojë. Liverpooli nuk ka qenë në gjendje të pajtohet me kushtet e reja të 24-vjeçarit dhe ka dhënë dakordësinë për largimin e tij. “Goal” kupton se Xhan është i gatshëm të nënsh-

ruajë një kontratë pesëvjeçare me Juventusin, ndërsa burimet mediatike nga Italia pretendojnë se do të fitojë rreth 5 milionë euro në vit, plus bonuset. Zyrtarizimi i këtij transferimi ka të ngjarë të bëhet pasi Liverpooli të ketë luajtur finalen e Ligës së Kampionëve me Real Madridin në Kiev, më 26 maj. Ai udhëtoi me skuadrën e Jurgen Klopp për në kampin e trajnimit të motit të ngrohtë, në Marbella, të

mërkurën, dhe është vendosur të rifillojë trajnimin në Spanjë. Kjo ngre mundësinë që ish-lojtari i Bajer Leverkusen të përfshihet në listë për sfidën Real Madridit, edhe pse duhet të provojë përshtatshmërinë e tij për Klopp, para se të mund të konsiderohet për një vend në stol. Që kur u bashkua me Liverpoolin, në vitin 2014, ai ka bërë 166 paraqitje, duke shënuar 14 gola. Emre Xhan ka qenë subjekt i



interesimit të klubeve të shumta, sapo u bë e qartë se një marrëveshje e re në “Anfield” ishte e pamundur. Manchester Siti, Bajern

Munih dhe Borussia Dortmund kanë bërë të gjitha përpjekjet, por Juventus duket se e ka fituar garën.

Publicitet

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, nenit 22 paragrafi 1 i Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015-tekst i pastuar) dhe nenit 142 paragrafi 1 i Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013), UD Drejtori i IPKÇF “VTORI SEPTEMVRI” Demir Hisar publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim për kohë të pacaktuar

1. Edukator për fëmijët e moshës prej 2-6 vjeç - 1 (një) për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme

- Profesor i diplomuar i lartë/sipëror për edukim parashkollor, edukator i diplomuar për fëmijë të moshës parashkollorë dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim sipëror të mbaruar të shkallës VII/1 ose me arsim të lartë të mbaruar përkatës për edukatorë

- pa përvojë pune

- licencë valide për edukatorë

Orari i punës është 40 orë në javë, të cilat ndahen në 30 orë për punë të drejtpërdrejta me fëmijë, dhe koha e mbetur për aktivitete të tjera, prej ditës së hënë deri ditën e premte orari i kohës së punës caktohet në mënyrë të shkallëzuar në kuadër të orarit të punës prej ora 7:00 deri në ora 15:00.

Neto pagesa bazë është 19.574 denarë për përgatitje sipërore profesionale.

2. Përkëdhelës - 2 (dy) persona për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme

- PMP – arsim të mesëm katërvjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës

- pa përvojë pune

- licencë valide për përkëdhelës

Orari i punës është 40 orë në javë, të cilat janë të shpërndara në 35 orë për punë drejtpërdrejtë me fëmijë, ndërsa koha tjetër për aktivitete të tjera prej ditës së hënë deri ditën e premte; orari i punës është me shkallë në kuadër të orarit të punës prej ora 7:30 deri në ora 15:00.

Neto pagesa bazë është 14.772 denarë.

Së bashku me lutjen kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Diplomë (Certifikatë), Dëftësë për arsimin e mbaruar përkatës (origjinal ose kopje të vërtetuar);

- Licencë valide (për edukator ose përkëdhelës)

- Certifikatë të shtetësisë së RM (jo më të vjetër se gjashtë muaj);

- Certifikatë të lindjes

- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se gjashtë muaj).

- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën do dënohet për veprë penale dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskudjesë dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore (jo më të vjetër se gjashtë muaj).

Shpallja zgjatë pesë (5) ditë pune nga dita e publikimit të saj.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej dyzetepesë (45) ditëve, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentacioni i kompletuar të dorëzohet në adresën: IPK Çerdhja për fëmijë “VTORI SEPTEMVRI” Demir Hisar, rr. “Marshall Tito” nr. 16

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IPK Çerdhja për fëmijë “VTORI SEPTEMVRI”

Demir Hisar

Në bazë të nenit 35 paragrafi 1 alineja 7 të Ligjit për Arsim Profesional dhe Trajnim (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/06, 117/08, 148/09, 17/11, 24/13, 137/13, 41/14, 145/15 dhe 55/16) dhe nenit 16 të Statutit të Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim - Shkup, Këshilli Drejtues i Qendrës për Arsimin Profesional dhe Trajnim, shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

Për emërimin e zëvendës drejtorit të Qendrës për Arsimin Profesional dhe Trajnim

Kandidati duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit nuk i është shqiptuar dënim ose kundërvajtje për kryerjen e një profesioni, veprimtarie ose detyre;
- 3) të ketë së paku 240 kredi sipas ECTS ose të ketë përfunduar shkallën VII/1;
- 4) të jetë mësimdhënës me së paku pesë vjet përvojë pune në arsimin profesional ose të jetë i punësuar së paku pesë vjet në një organ administrativ kompetent për çështjet e arsimit ose decentralizimit;
- 5) të ketë një nga certifikatat ose vërtetimet e mëposhtme të njohura ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFL iBT së paku 74 pikë,
 - IELTS së paku 6 pikë,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) së paku niveli B2,
 - FCE (Cambridge English: First) e dhënë,
 - BULATS së paku 60 pikë, ose
 - APTIS së paku niveli B2, dhe
 - 6) të ketë dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet.

Të gjithë aplikantët që do të aplikojnë, vërtetimet e nevojshme dhe dokumentet e tjera me të cilat e vërtetojnë përmbushjen e kushteve të lartpërmendura, në origjinal ose fotokopje të vërtetuara nga noteri, së bashku me letër shoqëruese: një biografi të shkurtër, duhet t'i dorëzojnë në arkivin e Qendrës ose me postë në adresën: Bul. Goce Delcev Nr. 18 Shkup p.fax 290, Qendra për Arsimin Profesional dhe Trajnim, e detyrueshme me një shënim: „për shpallje publike” dhe „mos hap”.

Dokumentet (vërtetimet / certifikatat) që vërtetojnë plotësimin e kërkesave të pikës 1 dhe 2 nuk duhet të jenë më të vjetra se gjashtë muaj.

Shpallja publike zgjatë tetë (8) ditë nga dita e shpalljes në shtypin ditor.

Nuk do të shqyrtohen fletëparaqitjet që do të jenë të pakompletuara dhe të cilat nuk do të shënohen në mënyrë të duhur dhe të dorëzuara në kohë.

Kandidatët që plotësojnë kushtet nga shpallja do të thirren për një intervistë brenda një periudhe prej pesë ditësh pas mbylljes së shpalljes.

Kandidatët të cilët nuk do të përzgjidhen do të njoftohen me shkrim për përzgjedhjen.

Qendra për Arsimin Profesional dhe Trajnim
Kryetari i Këshillit Drejtues

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7, nenit 128 paragrafi 3 të Ligjit për arsim fillor (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 103/2008), nenit 72 dhe 73 të Statutit të SHF “Blazhe Koneski” – Skudrinje, Vendimit nr. 09-164/1 të datës 11.05.2018 të sjellë nga kryetari i Komunës Mavrovë dhe Rostushë, këshilli i shkollës së SHF “Blazhe Koneski” – Skudrinje, Komuna Mavrovë dhe Rostushë, publikon:

SHPALLJE

Për zgjedhje të drejtorit të shkollës

1. Kandidati për drejtor të shkollës krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për arsim fillor të RM duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim:
 - Të ketë të mbaruar arsimin sipëror dhe të përmbushin kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore;
 - Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në institucion edukativo-arsimor;
 - Të ketë të dhënë provimin për drejtor të shkollës;
 - Të mos i jetë shqiptuar dënim gjyqësor ose sanksion kundërvajtës – ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë.
2. Kandidatët duhet t'i parashtrijnë dokumentet në vijim:
 - Certifikatë të shtetësisë,
 - Certifikatë për provim të dhënë për drejtor të arsimit fillor;
 - Certifikatë se nuk është i dënuar për veprë penale kundër dinjitetit dhe moralit dhe se nuk është nën hetime;
 - Certifikatë të mjekut për gjendjen shëndetësore fizike dhe psikike;
 - Program për punë të kandidatit si drejtor për periudhë prej 4 vjet.,

3. Lutjet të cilat të bashkëngjitur nuk do të kenë dokumentacionin e kompletuar të theksuar në Shpallje nuk do të shqyrtohen.
4. Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.
5. Lutja me markë të paguar tatimore prej 50,00 denarë me dokumentacionin e kompletuar në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter të parashtrihet përmes postës në adresën SHF “Blazhe Koneski” 1257 f. Skudrinje.

Këshilli i shkollës

ANULIMI I SHPALLJES PUBLIKE

Këshilli i shkollës pranë SHFKM “Ordan Mihajloski-Ocka” Prilep, publikon anulim të Shpalljes publike për zgjedhje të Drejtorit të SHFK “Ordan Mihajloski-Ocka” Prilep me mandat prej 4 vjet. Me Vendim të Këshillit të shkollës nr. 02-208/1 të datës 16. 05. 2018 dhe anulimit të Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 02-192/2 të datës 09.05.2018 dhe Shpalljes publike të shënuar në nr. 02-192/1 të datës 09.05.2018 të publikuar më datë 15.05.2018.

Data 16.05.2018.

Kryetar i Këshillit të shkollës

Keti Petreska

I nr. 177/2015
Përmbareusi Vanço Markovski nga Tetova, në rr. Ilindenska nr. 64, në bazë të kërkesës për realizimin e përbarimit nga kreditori STOPANSKA BANKA SHA SHKUP përmes Shoqërisë së avokatëve ÇAKMAKOVA ADVOKATI nga Shkupi me NVT 4030996116744 dhe NVPS 4065549 dhe seli në rr. 11 Oktomvri nr. 7, bazuar në dokumentin përbarues UPDR nr. 3918/14 të datës 30.12.2014 të Noterit Naxhi Zeqiri, kundër borxhliut Xhevaib Ibraimi nga Tetova me seli në f. Neproshen, për realizim të përbarimit me vlerë prej 299.160,00 denarë më datë 14.05.2018 në vijim sjellë:

KONKLUZION PËR SHITJE PUBLIKE ME GOJË

(në bazë të nenit 167 paragrafi 1, nenit 169 paragrafi 1 dhe nenit 170 paragrafi 1 – Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/2005, 50/2006, 129/2006, 08/2008, 83/2009, 50/2010, 83/2010, 88/2010, 171/2010, 148/2011 dhe 187/2013, në pajtim me nenin 265 nga LP, Gazeta zyrtare e RM nr. 72/2016)

PËRCAKTOHET shitja përmes ankandit publik me gojë të patundshmërisë së borxhliut Xhevaib Ibraimi nga Tetova me banim në f. Neproshen e përcaktuar si arë, të shënuar në listën pronësore LP. 1317 për KK Neproshen që udhëhiqet në Agjencinë për kadastrë të patundshmërië – departamenti për kadastrë të patundshmërië Tetovë me indikacionet kadastrale në vijim:

LISTA B

- PK nr. 1104, pjesa 3, vendi i quajtur: Livadhë e vjetra, plani 2, skica 5, kultura: Arë, klasa 4 me sipërfaqe prej 1246 m²;

Shitja do të bëhet më datë 04.06.2018 në ora 12 në lokale të përbaruesit Vanço Markovski nga Tetova, rr. Ilindenska nr. 64 në Tetovë.

Vlera fillestare e patundshmërisë, e përcaktuar me konkluzion të përbaruesit I. nr. 177/2015 të datës 14.05.2018, është 1.619.800,00 denarë, nën të cilën vlerë nuk mund të shitet në ankandin e parë publik.

Patundshmëria është e ngarkuar me ngarkesat dhe autorizimet në vijim: /.

Borxhliu i cili si pronar banon në ndërtesën e shitur banesore familjare ose banesë nuk e ka të drejtën që të banon aty dhe është i obliguar ndërtesën gjegjësisht banesën ta zbrazë në afat prej 60 ditëve nga dita e sjelljes së Konkluzionit për shitje ndërsa nëse nuk e bën atë, përbaruesi me propozim të blerësit me dhunë do të bëjë zbrazjen e ndërtesës gjegjësisht banesës.

Në ankandin publik mund të marrin pjesë vetëm personat të cilët më parë e kanë dorëzuar garancinë në lartësi prej 1/10 (një e dhjeta) nga vlera e vërtetuar e patundshmërisë, gjegjësisht shumë prej 161.980,00 denarë, si dhe personat të cilët në pajtim me LP janë të liruar nga dhënia e garancisë.

Pagesa e mjeteve në të holla në emër garanci bëhet në xhiro llogarinë e përbaruesit me nr. 210061160430277 e cila është në NLB Tutunska Banka SH A Shkup.

Obligimet tatimore në bazë të shitjes bien në barrë të blerësit.

Ofertuesve oferta e të cilëve nuk pranohet, garancia u kthehet menjëherë pas mbylljes së ankandit publik. Ofertuesi më i volitshëm – blerësi i patundshmërisë është i obliguar ta japë shumën e tërësishtme të patundshmërisë në afat prej 15 ditëve nga dita e shitjes, në të kundërtën do të caktohet shitje e re, ndërsa me garancinë e dorëzuar do të paguhet harxhimet e shitjes së re dhe do të kompensohet dallimi mes çmimit të arritur dhe të së kaluarës dhe shitjes së re.

Ky konkluzion do të publikohet në mjete të informimit publik Nova Makedonja dhe gazeta e përditshme në gjuhën shqipe Koha.

Konkluzioni do të dorëzohet palëve, kreditorëve peng, pjesëmarrësve në procedurë, personave të cilët kanë të regjistruar apo të drejtë ligjore të përparësisë së blerjes dhe organit zyrtar të drejtorisë.

PËRMBARUES

Vanço Markovski

Ajo që dukej si një fatkeqësi në dhjetor, kur u eliminua nga Liga e Kampionëve, ka përfunduar në festë. Atletiko Madrid e shihte "Europa League" si një mundësi për të ngjallur shfaqjet e tij. Në finalen e Lionit, skuadra spanjolle ishte favorite e qartë në baste dhe nuk ka dështuar. Ajo që arriti mbrëmë në Lyon është titulli i gjashtë i epokës "Simeone"

Atletiko Madrid ka triumfuar në finalen e "Europa League" duke mposhtur Marsejin me rezultatin 3-0. Ishte një atmosferë e mrekullueshme në "Parc Olympique Lyonnais", gjithashtu edhe ndeshja ishte e fortë dhe e luftuar. Por, në fund fitoi eksperiencia e spanjollëve. Grizmann shënoi golin e parë të ndeshjes ndaj bashkëkombësve të tij, ndërsa i njëjti shënoi edhe për 2-0, ndërsa në fund të takimit Gabi vulosi gjithçka duke shënuar për 3-0. Grizmann tani është lojtari i parë francez, që shënon dy gola në finalen e Ligës së Kampionëve, ose në Ligën e Evropës, duke përfshirë Kupën Evropiane, ose të parathënë Kupa UEFA. Me 29 gola në të gjitha garat, këtë sezon, Grizmann ka qenë vital për sezonin e Atletiko Madrid, pasi "Colchoneros" rrinin në vendin e dytë në La Liga. Oportunitizmi i tij ishte edhe një herë në shfaqje në Lyon, duke dëshmuar një forcë vdekjeprurëse për skuadrën e Ligue 1. "Ishte një ëndërr për ta fituar një titull tashmë me Atletiko Madridin. I thashë vetes se ishte radha ime", – deklaroi Grizmann. Ndryshe, pas finales ka folur edhe trajneri i Atletiko Madridit, Diego Simeone. "Nuk më pëlqen të

ATLETIKO MADRIDIT FITOI TROFEUN E LIGA EVROPËS

GRIZMANN DHE SIMEONE BËJNË HISTORI



flas për "cholismo", – thotë trajneri argjentinas, pas fitores 3-0 ndaj Marsej. Por, nuk dyshoj se kjo fitore është një ftesë për njerëzit, që të përipien gjithmonë të ecin përpara dhe kurrë të mos dorëzohen. Unë jam i lumtur për lojtarët. Është shumë më tepër se një Ligë Evropë, trofe të cilin e kemi fituar dy herë. Humbëm dy finale të Ligës së Kampionëve, një nga penalltitë dhe tjetren për dy minuta. Kjo rrugë është mënyra më e mirë për të fituar përsëri. Isha i skualifikuar dhe e kam parë finalen nga tribunat. Kjo ishte diçka e trishtueshme, kam pasur një ndjenjë vetmie", tha pas nde-

shjes Simeone.

Ndryshe, në rast se dikush kishte ndonjë dyshim, "Cholismo" është ende shumë e gjallë. Pas tri sezoneve, në të cilat, pavarësisht se konkurronte me më të mirët, nuk kishte fituar ndonjë titull, por Atletiko Madrid shijon sërish ëmbëlsinë e fitores në Lyon. Ajo që dukej si një fatkeqësi në dhjetor, kur u eliminua nga Liga e Kampionëve, ka përfunduar në festë. Atletiko Madrid e shihte "Europa League" si një mundësi për të ngjallur shfaqjet e tij. Në finalen e Lionit, skuadra spanjolle ishte favorite e qartë në baste dhe nuk ka dështuar. Ajo që

arriti mbrëmë në Lyon është titulli i gjashtë i epokës "Simeone". "El Cholo" ka fituar tre tituj kombëtarë (një La Liga, një Kupë Mbreti dhe një Superkupë Spanjolle) dhe tre tituj evropianë (dy "Europa League" dhe një Superkupë Evropiane). Ai do të luftojë në gusht për të fituar titullin e shtatë, përmes Superkupës Evropiane. Nuk është asgjë për të fituar gjashtë tituj si trajner i Atletiko Madrid. Por, kjo supozon asgjë më pak se të qenit trajneri me më shumë tituj në historinë e klubit "rojiblanco", barazuar me Luis Aragones, që fitoi një La Liga, tri Kupa Mbreti, një Superkupë Spanjolle dhe një Kupë In-

terkontinentale. Gjashtë sezone e gjysmë ka Simeone në krye të Atletiko Madrid dhe historia e "Cholo" me skuadrën "rojiblanco" do të vazhdojë të shkruajë së paku edhe një sezon tjetër. Përveç gjashtë titujve të fituar, Atletiko Madrid ka arritur dy finalen e Ligës së Kampionëve, të humbura ndaj Real Madridit, si dhe ra në një Superkupë Spanjolle kundër Barcelonës. Atletiko Madrid është jashtëzakonisht konkurrues, i cili qëndron gjithmonë aty, me më të mirët. "Cholismo" vazhdon të bëjë rrugën e vet. Për ata që kanë kërkuar "gradë", është i gjashti.



Skudra e Realit ka 46 Çampions, Liverpool vetëm një

Real Madridi dominon në Ligën e Kampionëve, siç e tregojnë edhe tre titujt e fituar në katër edicionet e fundit të këtij kompeticioni, që mund të jenë katër në pesë sezonin e fundit, nëse triumfon ndaj Liverpoolit në Kiev, më 26 maj. Ekziston, gjithashtu, një dominim i qartë në titujt e Kupës Evropiane (Çampions), të grumbulluara nga grupi aktual i "Los Blancos". Kjo shifër është jo më pak se 46 Çampions, të shpërndarë në mesin e 17 lojtarëve, me Kristiano Ronaldon që kryeson: me katër trofe të tillë (një me Manchester Junajtedin, tre me Real Madridin) dhe mbyllet me Asensio. Ky i fundit ka shijuar Çampionsin e 12-të, të arritur në Cardiff, kundër Juventusit (në atë finale, që përfundoi 4-1). Deri në 15 nga 17 loj-



tarët aktualë të Real Madridit i kanë fituar të gjithë titujt e tyre evropianë me fanellën e bardhë. Vetëm Kristiano Ronaldo dhe Kroos (gjermani ka tre tituj, një me Bajernin dhe dy me Real Madridin) e dinë se çfarë është të fitosh Ligën e Kam-

pionëve me një fanellë tjetër. Nëse Real Madridi fiton në kryeqytetin e Ukrainës, totali i lojtarëve me këtë medalje mund të rritet në 23, nga një për secilin anëtar të skuadrës (Luka Zidan nuk ka hyrë në asnjë thirrje përfundimtare në Çampions,

vetëm nëse e bën këtë finale. Nuk ka gjasa për prani të Kasillas), duke numëruar gjithsej 69 tituj. Një kontrast i skajshëm me grupin aktual të Liverpoolit në këtë drejtim: vetëm një titull. Ky është arritur nga Emre Xhan me Bajern Munihi në sezonin

2012-2013, në një edicion në të cilin ai nuk luajti asnjë minutë, por qëndroi në stol në një ndeshje të fazës së grupeve. Nëse fiton 12 + 1, Real Madridi do të krijojë një hendek edhe më të madh me pjesën tjetër të ekipeve evropiane, mbi të cilat tashmë dominon në këtë aspekt. E dyta në listë është Barcelona, lojtarët aktualë të së cilës kanë fituar në total 22 Çampions, më pak se gjysma e "Los Blancos". I treti në listë është Bajern Munihi, me 12 tituj në Ligën e Kampionëve. Bavarezët janë ekipi i fundit jo-spanjoll, që ka fituar një Ligë të Kampionëve, në sezonin 2012-2013, kundër Borussia Dortmundit në finale. Nga ai triumfi, Bajern Munihi ka ruajtur disa lojtarë si Nojer, Boateng, Alaba, Riberi, Robben...

JETËGJATËSIA IME, NDËSHKIM NGA ZOTI



Një grua nga Çeçenia, e cila thotë se është personi më i vjetër në botë, është shprehur se ditëlindja e saj e 129 nuk është gjë tjetër veçse një ndëshkim nga Zoti. Koku Istambulova deklaron se nuk ka parë një ditë të lumtur në jetën e saj dhe nuk e kupton dot se si ka arritur që të jetojë kaq gjatë. Pasaporta e saj shkruan

se ajo ka lindur në 1 qershor 1889. Vetë Koku shpjegon se nuk ka asnjë sekret për këtë jetëgjatësi. "Është vullneti i Zotit, unë nuk kam bërë asgjë. Kam dëgjuar që njerëzit që jetojnë gjatë janë marrë me sport dhe kanë ngrënë ushqime të veçanta, por unë nuk kam bërë asgjë nga këto. Unë thjesht kam bërë punë të rënda, jam

lodhur nga jeta. Jetëgjatësia nuk është dhuratë e Zotit për mua, është ndëshkim", shprehet 129-vjeçarja, e cila ka nisur të ketë shumë probleme me shikimin. Gjatë jetës së saj, Koku ka humbur shumë fëmijë, përfshirë një djalë 6-vjeçar. Vajza e fundit që i kishte mbetur vdiq 5 vite më parë, në moshën 104-vjeçare.

Furra në Zvicër që pranon pagesat vetëm me Bitcoin

Zvicra për shumë kënd mund t'i ketë monedhat më të bukura në botë, mirëpo një furrë e re në Zurich nuk dëshiron që t'i përdorë paratë e gatshme. Furra e re Buchman është diçka e rrallë në Zvicër: biznes me pakicë që pranon pagesa vetëm me Bitcoin. "Rrethanat ishin të mira sepse në këtë zonë ka shumë të rinj dhe studentë që kanë passion teknologjinë", ka thënë menaxheri i furrës, Daniel Wehrli për portalin zviceran 20 Minuten. Ai ka thënë se puna pa përdorimin e parave ka disa anë pozitive, duke rezultuar në një ambient më të pastër dhe me më pak lodhje për punëtorët. "Por, ne gjithashtu dëshirojmë që të japim një porosi. Për ne, pagesat pa para janë e ardhmja", ka vazhduar ai. Shumica e njerëzve e kanë mirëpritur këtë gjë, mirëpo nuk kanë munguar as reagimet negative.



Shakatë që nuk duhen bërë kurrë me fëmijët tuaj

Pediatria Lira Gjika këshillon prindërit për shakatë që duhet të evitohen me fëmijët dhe bebet e tyre. Komentin e saj pediatria e njohur e ka bërë në profilin e saj në Facebook. Ja çfarë shkruan ajo: "Shpesh, të rriturit i ngacmojnë fëmijët e vegjël, për kënaqësi. I ngacmojnë derisa fëmija i vogël nervozohet, apo inatoset. Dhe në këtë çast, i rrituri ndjen kënaqësi të madhe dhe qesh në sy të fëmijës. Ndërsa fëmija i vogël i dëshpëruar dhe i inatosur, kërkon me sy nënën apo zëvendë-

suesin e saj, por më kot, sepse nëna apo gjyshja apo dadoja, qesh së bashku me atë tjetrin që e ngacmon pa e përfillur. Nëna nuk e ndalon këtë ngacmim, madje e shijon. Të rriturit qeshin dhe kënaqen, ndërsa fëmija i trembur, qan dhe bërtet. Kjo lojë është shumë e rrezikshme, pasi krijon modelin, që kur tjetri është në vështirësi, mund të qeshet me gjendjen e tij, në vend që të ndërhyhet për të qetësuar. Kjo do të thotë që padashur, ne i rrisim fëmijët me anestezi emocionale".

Treni në Japoni sërish niset 25 sekonda më herët, kompania kërkon falje

Një kompani hekurudhore në Japoni ka kërkuar falje pasi një tren është nisur nga stacioni 25 sekonda më herët, duke shënuar rastin e dytë të këtij lloji brenda një muaji. Operatori ka thënë se "është i pafalshëm shqetësimi i madh që u kemi shkaktuar klientëve tanë". Sipas Japan Today, drejtuesi i trenit ka menduar se është dashur të largohet nga stacioni Notogawa në orën 7:11 në vend të terminit 7:12. Pasi drejtuesi i trenit ka mbyllur dyert një minutë më herët ai ka kuptuar gabimin e tij duke u nisur drejt stacionit tjetër. Meqë ai nuk ka parë udhëtarë të tjerë duke pritur është nisur duke arritur në stacionin e radhës 25 sekonda më herët. Trenat japonezë njihen për një saktësi ekstreme prandaj disa persona kanë pritur ende trenin në fjalë. Të njëjtit më pas janë ankuar te kompania e cila ka shfaqur shumë shpejt keqardhje për këtë lëshim.



1642 - Themelohet Montreali në Kanada.

1756 - Anglia i shpall luftë Francës.

1803 - Britania i shpall luftë Francës pasi Napoleon Bonaparta vazhdon ndërhyrjen e tij në Itali dhe Zvicër.

1804 - Napoleon Bonaparta shpallet Perandor i Francës.

1828 - Beteja e Las Piedras i jep fund konfliktit mes Uruguait dhe Brazilit.

1940 - Trupat gjermane pushojnë Brukselin.

1956 - Mbretëresha Juliana hapë Panairin e Rembrantit në Amsterdam.

1973 - Brezhjevi viziton Gjermaninë Perëndimore.

1978 - Italia legalizon abortin.

1986 - Ushtria e Republikës Jugoafrrikane okupon Bostuanën, Zimbabvenë dhe Zambinë.

Hulumtuesit në Universitetin e Ohios kanë zbuluar se një substancë që përmban kamomil, apigenina, mund ta ketë një efekt toksik mbi qelizat e kancerit. Testet e kryera tek minjtë kanë treguar se apigenina ka aftësinë për ta shkaktuar vdekjen e qelizave të kancerit dhe i bën ato më të ndjeshme për kimioterapi. Ajo i bllokoi qelizat e kancerit, e ndalon përhapjen e tyre. Një gotë çaj kamomili në ditë ndihmon në mbrojtjen nga kanceri, theksojnë studiuesit. Apigenini përveç në çajin e kamomilit gjendet edhe tek majdanozi dhe tek selinoja. Prandaj ekspertët sugjerojnë që t'i kombinoni të gjitha këto në dietën tuaj të përditshme me qëllim të parandalimit të kancerit apo eliminimit të qelizave tashmë të krijuara. Por ata thonë se nuk duhet tepruar me pirjen e çajit të kamomilit pasi mjaftojnë dy filxhanë në ditë për ta arritur efektin e dëshiruar.



POLITIKANI SHQIPTAR

Një politikan shqiptar po bisedonte me një mikun e tij:

- E keqja ime është që kur të vdes, do shkoj fishek e në ferr!

- Ndërsa e mira është, që do kem të gjithë shokët e mi aty!



Është mirë që në jetë, ashtu si në një banket, mos çohesh nga tavolina as i etur dhe as i dehur.
(MARGARET THATCHER)